



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada - Government*  
*Ministria e Zhvillimit Ekonomik*  
*Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development*

# **RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS**

## **SË NDËRMARRJEVE PUBLIKE**

### **2012**



**2013**

## **Përmbajtja**

Lista e Shkurtesave.....	4
1. Fjala hyrëse e Ministrit.....	6
2. Objektivat dhe kuadri rregullativ i pronësisë së ndërmarrjeve publike.....	8
3. Zhvillimet e qeverisjes korporative të ndërmarrjeve publike dhe monitorimi i tyre.....	8
3.1. Kuadri ligjor.....	9
3.2. Politikat e pronësisë së ndërmarrjeve publike.....	10
3.2.1. Objektivat e korporatës dhe aktivitetet e biznesit.....	10
3.2.2. Konflikti i interesit.....	10
3.2.3. Mbledhjet vjetore.....	11
3.2.4. Struktura e kapitalit.....	11
3.2.5. Performanca e ndërmarrjeve publike.....	12
3.2.6. Dividenta.....	16
3.2.7. Subvencionet shtetërore.....	16
3.2.8. Përfshirja e sektorit privat.....	17
3.3 Auditori i Jashtëm.....	18
4. Performanca individuale e ndërmarrjeve publike qendrore.....	20
4.1. KEK.....	20
4.2. KOSTT.....	24
4.3. PK.....	29
4.4. PTK.....	33
4.5. ANP “Adem Jashari”.....	38
4.6. Infracos.....	41
4.7. Trainkos.....	44
4.8. KRU Radoniqi.....	47
4.9. KRU Hidrodrini.....	51
4.10. KRU Hidromorava.....	54
4.11. KRU Hidroregjioni Jugor.....	57
4.12. KRU Prishtina.....	61
4.13. KRU Mitrovica.....	65
4.14. NH Ibër – Lepenci.....	68
4.15. KU Radoniqi – Dukagjini.....	72
4.16. KU Drini i Bardhë.....	75
4.17. KMDK.....	78
Përmbledhje dhe Rekomandime.....	81
Referencat:.....	83

## Përmbledhja e Tabelave

Tabela 1 - Performanca Financiare e NP bazuar në raportet e auditorit të jashtëm.....	12
Tabela 2 - Performanca Operative e Sektorit të Energjisë.....	13
Tabela 3- Performanca Operative e Sektorit të Telekomunikacionit-PTK.....	14
Tabela 4 - Performanca Operative e Sektorit të Ujit.....	15
Tabela 5 - Numri i Punëtorëve në NP .....	15
Tabela 6 - Financimet e Qeverise për Ndermarrje Publike.....	17
Tabela 7 - Performanca Operative e KEK-ut.....	22
Tabela 8 - Performanca Financiare e KEK-ut.....	22
Tabela 9 - Performanca Operative e KOSTT-it.....	27
Tabela 10 - Performanca Financiare e KOSTT-it.....	27
Tabela 11 - Performanca Operative e PK .....	31
Tabela 12 - Performanca Financiare e PK .....	31
Tabela 13 - Performanca Operative e PTK.....	35
Tabela 14 - Performanca Financiare e PTK.....	35
Tabela 15 - Performanca Financiare e ANP “Adem Jashari” .....	39
Tabela 16 - Performanca Financiare e INFRAKOS .....	42
Tabela 17 - Performanca Operative e TRAINKOS .....	45
Tabela 18 - Performanca Financiare e TRAINKOS .....	45
Tabela 19 - Performanca Operative e KRU Radoniqi .....	49
Tabela 20 - Performanca Financiare e KRU Radoniqi .....	49
Tabela 21 - Performanca Operative e KRU Hidrodrini .....	52
Tabela 22 - Performanca Financiare e KRU Hidrodrini .....	52
Tabela 23 - Performanca Operative e KRU Hidromorava.....	55
Tabela 24 - Performanca Financiare e KRU Hidromorava .....	56
Tabela 25 - Performanca Operative e KRU Hidroregjioni Jugor .....	58
Tabela 26 - Performanca Financiare e KRUHidroregjioni Jugor .....	59
Tabela 27 - Performanca Operative e KRU Prishtina.....	63
Tabela 28 - Performanca Financiare e KRU Prishtina.....	63
Tabela 29 - Performanca Operative e KRU Mitrovica .....	66
Tabela 30 - Performanca Financiare e KRU Mitrovica .....	67
Tabela 31 - Performanca Operative e NH Ibër- Lepenc .....	70
Tabela 32 - Performanca Financiare e NH Ibër - Lepenc .....	70
Tabela 33 - Performanca Operative e KU Radoniqi - Dukagjini.....	73
Tabela 34 - Performanca Financiare e KU Radoniqi - Dukagjini .....	73
Tabela 35 - Performanca Operative e KU Drini i Bardhë .....	76
Tabela 36 - Performanca Financiare e KU Drini i Bardhë .....	76
Tabela 37 - Performanca Operative e KMDK .....	79
Tabela 38 - Performanca Financiare e KMDK .....	80

## Lista e Shkurtesave

AB	Auditori i Brendshëm
AACK	Agjensioni i Aviacionit Civil të Kosovës
AJ	Auditori i Jashtëm
AKM	Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit
ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës – Kulla Ajrore
ARKEP	Autoriteti Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare
BB	Banka Botërore
BD	Bordi i Drejtorëve
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
CAO	Coordinated Auction Office, Zyrës për Alokim të Kordinuar të Kapaciteteve Interkonjektive
DOSHNA	Divizioni i Operimeve dhe Shërbimeve të Navigimit Ajror
ENTSO-E	Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrikë
EIC	kodi me shenjën “Y”
EMS dhe EPS	Rrjeti Elektrik i Serbisë
HK	Hekurudhat e Kosovës
HS	Hidro Sistemi (Ibër-Lepenc)
ICAO	Zyra Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
IFC	International Finance Corporation
IPS	Web Tracking - International Postal System Web Tracking, Sistemi Internacional Postar
IPTV	Internet Protocol Television, ofrim i shërbimeve të telefonisë, internetit dhe televizionit përmes protokollit të internetit
KA	Komisioni i Auditimit
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KE	Komisioni Evropian
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës
KKDFE	Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizimi të Energjisë
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave
KRU	Kompania Regjionale e Ujësjetësimit
KU	Kompania e Ujitjes
LNP	Ligji mbi Ndërmarrjet Publike
MF	Ministria e Financave
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NGN	Next Generation Network, gjenerata e ardhshme e rrjetit
NP	Ndërmarrje Publike
NS	Nënstacioni
NJB	Njësi Biznesi
NJPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike
NJO	Njësia Operative
OST (KOSTT)	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut
PB	Plani i Biznesit
PK	Posta e Kosovës
PF	Pasqyrat Financiare
PPP	Partneriteti Publiko-Privat
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SCADA/EMS	Sistemi i kontrollit dhe grumbullimit të të dhënave/Sistemi i menaxhimit të energjisë
SMI	Sistemit të Menaxhimit të Informatave
SWOT	Fortësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet/Rreziqet

TiK	Telekomi i Kosovës
UD	Ushtrues Detyre
UPU	Universal Postal Union
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
ZRrE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
ZRrUK	Zyra e Rregullatorit për Ujesjellës dhe Kanalizim
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZP	Zyra Postare

## 1. Fjala hyrëse e Ministrit

Kam nderin që në emër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, të paraqes për shqyrtim propozim Raportin mbi Performancën e Ndërmarrjeve Publike Qendrore në vitin 2012.

Sipas Nenit 8 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, kërkohet të raportohet në baza vjetore në Kuvend, për performancën në sektorin e Ndërmarrjeve Publike dhe ky është raporti për Kuvend, që do të shqyrtohet pas miratimit të tij në Qeveri.

Ky raport në vete përmban edhe të dhënat krahasuese ndërmjet vitit 2011 dhe 2012, e që konkretisht tregojnë për performancën e Ndërmarrjeve Publike në vitin 2012.

Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, ka përgjegjësi ligjore të monitorojë dhe raportojë për performancën e Ndërmarrjeve Publike në mënyrë individuale dhe kolektive. Andaj kjo Njësi ka përgatitur këtë raport i cili fokusohet në:

- Performancën operative (rezultatet e arritura, efikasiteti, kualiteti i shërbimeve),
- Performancën financiare (qarkullimi i arritur, efikasiteti i shpenzimeve, profitabiliteti),
- Qeverisjen korporative (Monitorimet e punës së bordeve, llogaridhënia, planifikimi i biznesit),
- Perspektivën në të ardhmen (ndryshimet e tregut, investimet, rreziqet).

Ky raport përmbledh rezultatet operative dhe financiare të Ndërmarrjeve Publike për vitin 2012, i analizon ato rezultate duke bërë krahasime me vitin paraprak. Gjithashtu ky raport paraqet Objektivat dhe Projektet për vitin 2013 dhe bën rekomandime për ndryshim të politikave dhe veprimeve të tjera të kërkuara për të përmirësuar performancën.

Raporti është shqyrtuar në korrik nga Komisioni i Ministrave për Ndërmarrje Publike, është dërguar për komente në Ministrinë të cilat e përbejnë këtë Komision, dhe tani kërkohet për shqyrtim dhe miratim në Qeveri.

Raporti është përpiluar për të paraqitur një pikëpamje të qartë të performancës dhe perspektivës në sektorin e Ndërmarrjeve Publike dhe për të paraqitur para deputetëve dhe publikut çështjet me të cilat përballet niveli i tanishëm i shërbimeve, si dhe zhvillimet që pasojnë për të përmirësuar qeverisjen korporative në këtë sektor.

Raporti nuk merret me çështjet teknike të cilat janë me rëndësi vetëm për Ndërmarrjet Publike individuale por informatat më të hollësishme mund të merren nga raporti vjetor i bërë nga vet Ndërmarrjet Publike, i cili mund të gjendet edhe në faqen e tyre zyrtare në internet. Për të mirën e deputetëve dhe të publikut, ky raport e paraqet performancën e sektorit të Ndërmarrjeve Publike nga perspektiva e aksionarëve.

Nga Raporti shihet se në krahasim me vitin paraprak ka progres në performancën financiare në krahasim me vitin paraprak, ndonëse jo ai i prituri nga aksionari.

Kur i shikojmë individualisht Ndërmarrjet Publike, shihet qartë që tri kompani: KOSTT, KRU Mitrovica dhe KU Radoniqi-Dukagjini kanë rritur ndjeshëm fitimet financiare; një kompani: KRU Prishtina ka arritur ta kthejë kompaninë nga humbja në kompani fitimprurëse, ndërsa gjatë nga to KRU HidroMorava, KRU HidroDrini, KRU Hidroregjioni jugor, KRU Radoniqi, Infrakos dhe KMDMK kanë arritur t'i zvogëlojnë humbjet e tyre nga viti paraprak.

Një performancë edhe më e mirë do të ishte e mirëseardhur edhe nga kompanitë si: ANP “Adem Jashari”- Kontrolli Ajror edhe TrainKos, pasi edhe në vitin 2012 janë në humbje financiare, sikurse edhe Ibër-Lepenci që i ka rritur humbjet.

Arsyet e humbjeve shpjegohen nga kompanitë si vështirësi në afarizëm, pasi ANP “Adem Jashari”- Kontrolli Ajror ka barrë të pagesave të tokës së eksproprijuar para koncesionimit; Ibër-Lepenci si rritje e kostove të zhvlerësimit nga asetet e vjetruara dhe kushteve jo të favorshme hidrologjike për gjenerim energjie.

Raporti i këtij viti dallon nga vitet paraprake, ngase këtë vit hartimi i raporti është mbështetur nga këshilltarët ndërkombëtarë të sponsoruar nga SDC (Zyra Zvicëse për Bashkëpunim Ekonomik). Raporti paraqet një përmbledhje të kujdesshme të të dhënave të verifikuara nga raportet e Ndërmarrjeve Publike, e rregullatorëve të pavarur, dhe auditorëve të jashtëm financiarë dhe të njëjtat janë analizuar, prej nga në fund janë dhënë rekomandimet për avansim të performancës së Ndërmarrjeve Publike.

## 2. Objektivat dhe kuadri rregullativ i pronësisë së ndërmarrjeve publike

Ndërmarrjet Publike në Kosovë janë pronësi e publikut. Në këtë kontekst, Qeveria e Republikës së Kosovës ka kompetencat ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në Ndërmarrjet Publike Qendrore<sup>1</sup>. Qeveria garanton publikun e Republikës së Kosovës që Ndërmarrjet Publike vepronë në treg në përputhje me parimin e neutralitetit konkurrues, por nga ana tjetër ato fokusohen në përmbushjen e funksionit të tyre të përdorimit të fondeve publike me efikasitet, ekonomi dhe efektivitet, si dhe të maksimizimit të performancës financiare. Publiku, si pronari i vërtetë i Ndërmarrjeve Publike ushtron të drejtat e veta për kontrollin e pasurive të tyre nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe më konkretisht nëpërmjet Njësisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike.

Rritja e cilësisë së shërbimeve publike ndaj qytetarëve të Kosovës, rritja e vlerës së asetëve të NP-ve si pasuri e shtetit të Kosovës, renditen në prioritetet strategjike afatgjata të MZHE-së dhe Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike.

Si pjesë e detyrave funksionale të monitorimit dhe raportimit të performancës sektoriale dhe individuale të NP-ve është edhe përgatitja e Raportit Vjetor të Ndërmarrjeve Publike Qendrore nga ana e NJPMNP. Raporti Vjetor 2012 i performancës të NP-ve fokusohet në analizën e tre shtyllave kryesore:

- Funksionimin e Qeverisjes Korporative;
- Performancën operative sipas sektorëve dhe sipas Ndërmarrjeve Publike Qendrore;
- Performancën financiare sipas sektorëve dhe sipas Ndërmarrjeve Publike Qendrore;

## 3. Zhvillimet e qeverisjes korporative të ndërmarrjeve publike dhe monitorimi i tyre

Që nga viti 2006, të gjitha Ndërmarrjet Publike janë korporatizuar dhe funksionojnë sipas qeverisjes korporative, të bazuar në parimet e OECD (Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim) të Qeverisjes Korporative.

Sipas këtyre parimeve Ndërmarrjet Publike në Kosovë qeverisen nga një bord efektiv i zgjedhur nga aksionari - Qeveria, bord i cili është përgjegjës në mënyrë kolektive për suksesin e ndërmarrjes. Në këtë kontekst, Qeveria lejon bordin të ushtrorë përgjegjësitë e veta mbikëqyrëse dhe respekton pavarësinë e tij konform infrastrukturës ligjore duke ia lejuar Drejtimin e Ndërmarrjeve Publike, autonomi të plotë operative për të implementuar strategjitë e vendosura nga Bordi i Drejtoreve, si dhe për të arritur objektivat e përcaktuara. Nga ana tjetër, Qeveria nëpërmjet raporteve vjetore sigurohet nëse ndërmarrjet publike kanë kënaqur interesat e të gjithë grupeve të interesit për të arritur një rritje të qëndrueshme, jo në vetëm aspektin financiar, por edhe në aspektin social meqenëse, qëllimi kryesor i Ndërmarrjeve Publike është të vepronë në interesin më të mirë të përgjithshëm të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

---

<sup>1</sup>Ndërmarrjet Publike në Kosovë, nga aspekti i pronësisë, ndahen në Ndërmarrje Qendrore me aksionar Qeverinë e Kosovës, në emër të Republikës së Kosovës dhe Ndërmarrjet Publike Lokale, nën pronësinë e komunave. Subjekt i këtij Raporti Vjetor janë Ndërmarrjet Publike Qendrore.



Gjatë vitit 2012, me qëllim të plotësimit të përgjegjësive që i përcakton ligji Nr. 03/L-087 dhe Nr. 04/L-111, NJPMNP ka përmbushur detyrat si vijojnë:

- Është monitoruar puna e bordeve të drejtorëve përmes shqyrtimit të procesverbaleve të mbledhjeve të bordeve të drejtorëve, komiteteve të auditimit dhe komiteteve të tjera, më konkretisht, gjatë vitit 2012, për shtatëmbëdhjetë Ndërmarrje Publike Qendrore që janë monitoruar nga NJPMNP, janë mbajtur 17 mbledhje të përgjithshme vjetore me Aksionarin, 138 mbledhje të bordeve të drejtorëve, 115 mbledhje të komisioneve të auditimit dhe 31 mbledhje të komiteteve të tjera të përkohshme;
- Në cilësinë e vëzhguesit në emër të aksionarit, analistët e NJPMNP kanë marrë pjesë në 43 mbledhje të bordeve të drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore gjatë vitit 2012;
- Janë pranuar, përpunuar dhe janë ekzekutuar pagesat nga 55 kërkesa të Ndërmarrjeve Publike Qendrore për realizimin e 27 projekteve investive të financuara nga Qeveria, duke realizuar kështu buxhetin në 87%, buxhet ky i ndarë sipas Ligjit mbi Ndarjen Buxhetore të viti 2012 të aprovuar;
- Janë pranuar, përpunuar dhe janë ekzekutuar pagesat për 41 kërkesa të Ndërmarrjeve Publike Qendrore për subvencione të importit të energjisë, mbulimit të rasteve sociale nga energjia, blerjes së mazutit për ngrohje, shërbimeve të ujit dhe mbeturinave për pjesën përtej Ibrit dhe mbulimit të kostove operative të lëvizjes së trenit të lirë për qytetarët, buxhet ky i realizuar kështu 100% nga buxheti i aprovuar;
- Janë organizuar dhe përgatitur pesë mbledhje të Komisionit të Ministrave për NP, në të cilat janë diskutuar shumë çështje që kanë të bëjnë me funksionimin e NP;
- Është ushqyer me të dhëna të NP faqja elektronike e NJPMNP për NP Qendrore;
- Janë pranuar dhe përpunuar raporte tremujore dhe vjetore të NP Qendrore;
- Është vlerësuar efektshmëria e punës së bordeve të drejtorëve të NP qendrore për vitin 2012;
- Është hartuar Raportit Vjetor mbi performancën e NP qendrore për vitin 2011 dhe është dorëzuar në Qeveri dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- Janë përgatitur përgjigjet nga pyetjet e arritura parlamentare dhe të mediave mbi çështjet e NP qendrore;
- Janë kthyer për rishikim tre vendime të Bordeve të Drejtorëve mbi përputhshmërinë e të njëjtave me ligjin;

### **3.1 Kuadri ligjor**

Pas miratimit të Kushtetutës së Kosovës, në Qershor 2008, është miratuar korniza bazë mbi rregullimin pronësor dhe funksionimin e qeverisjes korporative të Ndërmarrjeve Publike Qendrore, siç është: Ligji Nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike. Gjithashtu, është bërë edhe amandamentimi i këtij ligji me Nr. 04/L-111, me të cilin është rregulluar auditimi i NP, komunikimi më i mirë i NP me nivelin lokal, themelimi i NP-ve të reja, si dhe plotësimi i listës së Ndërmarrjeve Publike me ndërmarrje të reja, të cilat më parë ishin nën menaxhimin e AKP.

Me qëllim të mirëfunksionimit të qeverisjes korporative në Ndërmarrjet Publike si mbështetje për implementim sa më efikas të ligjit mbi NP, janë miratuar edhe aktet e tjera nënligjore, të tilla si:

- Politikat Pronësore për Ndërmarrje Publike në vitin 2008;
- Udhëzimi Administrativ mbi Pjesëmarrjen e Komunave në Bordet e Kompanive Rajonale të Mbeturinave në vitin 2009;
- Model-Statuti i Ndërmarrjeve Publike Qendrore në vitin 2009;
- Model-Kodi i Etikës dhe Qeverisjes së Korporatave në vitin 2010;
- Rregullorja mbi Punën e Komisionit të Ministrave për Ndërmarrje Publike etj., në vitin 2011.

Ndërsa, gjatë vitit 2012 janë hartuar edhe draft-rregulloret relevante për Ndërmarrjet Publike, të tilla si:

- Hartimi i draft rregullores mbi emërimin e pjesëmarrësve të Komunave në Bordet e Drejtorëve të ujësjellësve dhe mbi kriteret për krijimin e NP lokale, miratuar në Qeveri gjatë vitit 2013;
- Hartimi i draft model të Rregullores për Udhëtime Zyrtare të NP;
- Hartimi i draft model të Rregullores për Përdorimin e Veturave Zyrtare të NP;
- Hartimi i draft vendimit për Kompensimin e Bordeve të Drejtorëve, i miratuar në Qeveri gjatë vitit 2013.

### **3.2 Politikat e pronësisë të Ndërmarrjeve Publike**

Politika e përgjithshme e Qeverisë që i mundëson asaj t'i përcaktojë objektivat e përgjithshme të pronësisë shtetërore, rolin e shtetit në qeverisjen korporatave të Ndërmarrjeve Publike dhe mënyrën se Qeveria do t'i implementojë politikat e saj për pronësinë e ndërmarrjeve përbëhet nga tetë komponente, si vijojnë:

1. Objektivat e korporatës dhe aktivitetet e biznesit;
2. Përzgjedhja dhe emërimi i drejtorëve;
3. Mbledhje vjetore;
4. Struktura e kapitalit;
5. Performanca e ndërmarrjeve;
6. Dividentat;
7. Ente të tjera shtetërore;
8. Përfshirja e sektorit privat.

#### **3.2.1. Objektivat e korporatës dhe aktivitetet e biznesit**

Drejtimi Ekzekutiv është përgjegjës për menaxhimin efektiv të Ndërmarrjeve Publike, i cili përfshinë përgjegjësi ekzekutive, krijim vlerash, përdorim me efikasitet, ekonomi dhe efektivitet të fondeve publike, vendosjen e objektivave, taktikave operacionale, menaxhimin e rreziqeve dhe kontrolleve dhe matjen e performancës. Ndërsa, Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për të vendosur rregulla dhe standarde që sigurojnë përmbushjen e rolit monitorues të Bordit të Drejtorëve ndaj NP-ve.

Për ta mundësuar përmbushjen e objektivave të vendosura gjatë vitit 2012 ka pasur emërimet e reja të zyrtarëve të lartë, kryesisht në NP të reja të lindura pas ristrukturimit, siç janë: InfraKos, TrainKos dhe Postë e Kosovës dhe KKDFE.

#### **3.2.2. Konflikti i interesit**

Mënjanimi i çdo lloji konflikti i interesit është përcaktuar me ligj dhe, po ashtu në Kod të Etikës, kështu që çdo drejtor Jo-Ekzekutiv dhe zyrtar i lartë i NP kanë nënshkruar një zotim me shkrim mbi respektimin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative dhe shmangies së konflikteve të interesit.

Në fund të vitit 2012, dhe pas bashkëpunimit të NJPMNP me Agjencinë kundër Korrupsionit dhe Bordeve të Drejtorëve kanë ndodhur disa dorëheqje me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit në lidhje me pozitën e tyre në funksionet e rregullta publike. Më konkretisht, gjatë vitit 2012 kanë dhënë dorëheqjen për të shmangur konfliktin e interesit në përputhje me Ligjin mbi NP, gjashtë (6) Drejtorë Jo-ekzekutivë, anëtarë të Bordit të Drejtorëve të HS Ibër-Lepenc, InfraKos dhe Ndërmarrjet të Menaxhimit të deponive të Mbeturinave të Kosovës.

### **3.2.3. Mbledhjet vjetore**

Ashtu siç është parashikuar me nenit 189 të Ligjit mbi shoqëri tregtare, pas finalizimit të raporteve të Auditorit të Jashtëm mbi pasqyrat e konsoliduara financiare në muajin qershor janë mbajtur mbledhjet e përgjithshme vjetore me Aksionarin me pikat e parapara të rendit të ditës si: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Auditorit të Jashtëm; Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetor të punës, si dhe Shqyrtimi i Performancës së menaxhmentit.

Me autorizimin e Kryesuesit të Komisionit të Ministrave për Ndërmarrje Publike në emër të Aksionarit NJPMNP ka marrë pjesë aktivisht në të gjitha mbledhjet e mbajtura vjetore, duke shtjelluar të dhënat nga raporti në veçanti mbi vlerën e aseteve, gjendjen financiare të NP dhe nivelin e shërbimeve publike.

### **3.2.4. Struktura e kapitalit**

Struktura e kapitalit të biznesit duhet të jetë adekuate për nevojat e biznesit dhe konsistente me normat ndërkombëtare për industri. Andaj duhet të rishikohet në baza të rregullta nga Qeveria, Bordi i Ndërmarrjes dhe Njësia e NP-ve.

Kur në mënyrë objektive duket e nevojshme, kontributet e reja për kapitalin e aksioneve të Ndërmarrjes do të jenë të mundshme nga Qeveria përmes procesit normal të buxhetit të shtetit, siç ceket në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

Dhe kështu Aksionari, bazuar në Ligjin mbi ndarjet buxhetore ka shtuar në kapital përmes financimit të aseteve, duke financuar projektet kapitale në 17 Ndërmarrje Publike në vlerë të financuar prej 7.1 mil euro.

Ndryshime në strukturën e kapitalit kishte edhe në Kompaninë Kosovare për Distribucion dhe Furnizim të Energjisë-KKDFE, e cila me investimet nga transaksioni-privatizimi tanimë ka kaluar nën pronësi private.

### 3.2.5. Performanca e ndërmarrjeve

Ndërmarrjet Publike Qendrore	2011			2012		
	Të hyrat <sup>2</sup> (000€)	Kostot <sup>3</sup> (000€)	Profiti/Humbj <sup>4</sup> (000€)	Të hyrat (000€)	Kostot (000€)	Profiti/Humbj a (000€)
ANP "Adem Jashari"	8,958	(8,562)	396	2,593	(4,533)	(1,940)
KEK	257,496	(240,979)	16,517	269,976	254,616	15,360
KOSTT	18,249	(16,966)	1,283	21,524	(18,735)	2,789
PTK	164,297	(118,181)	46,116	149,617	(111,279)	38,338
PK	-	-	-	4,402	(5,571)	(1,169)
Infrakos	1,337	(1,420)	(83)	3,163	(3,215)	(52)
Trainkos	2,364	(2,016)	348	5,053	(5,523)	(470)
KMDK	1,187	(2,098)	(911)	1,293	(1,913)	(620)
Ibër-Lepenc	3,791	(7,781)	(3,990)	3,808	(7,978)	(4,170)
KRU Drini i Bardhë	227	(244)	(17)	303	(337)	(34)
KRU Radoniqi-Dukagjini	887	(885)	2	891	(880)	11
KRU Prishtina	12,941	(13,265)	(324)	13,514	(13,341)	173
KRU Mitrovica	3,775	(3,713)	62	3,875	(3,282)	593
KRU Hidromorava	1,716	(2,068)	(352)	1,882	(1,915)	(33)
KRU Hidrodrini	3,067	(3,220)	(153)	3,578	(3,592)	(14)
KRU Radoniqi	2,924	3,601	(677)	3,233	(3,790)	(557)
KRU Hidroregjioni Jugor	3,579	(4,075)	(496)	4,069	(4,417)	(348)

Tabela 1. Performanca Financiare e NP-ve bazuar ne raportet e Auditorit të Jashtëm

<sup>2</sup> Tek të hyrat përfshihen të hyrat edhe nga grantet

<sup>3</sup> Përfshihet edhe amortizimi, borxhet e këqija, etj.

<sup>4</sup> Profiti/ Humbja pas tatimit

### 1) Performanca Financiare

Gjatë vitit 2012, sipas tabelës më lart, ka një progres në krahasim me vitin paraprak, ndonëse jo ai i prituri nga aksionari. Kur i shikojmë individualisht shihet qartë që tri kompani kanë rritur ndjeshëm fitimet financiare; një kompani ka arritur ta kthejë kompaninë nga humbja në kompani fitimprurëse, ndërsa gjashtë nga to kanë arritur t'i zvogëlojnë humbjet e tyre nga viti paraprak.

Një performancë edhe më e mirë do të ishte e mirëseardhur edhe nga kompanitë si: ANP edhe TrainKos, pasi edhe në vitin 2012 janë në humbje financiare, sikurse edhe Ibër-Lepenci që i ka rritur humbjet.

Arsyet e humbjeve shpjegohen nga kompanitë si vështirësi në afarizëm, pasi ANP ka barrë të pagesave të tokës së eksproprijuar para koncesionimit; Ibër-Lepenc si rritje e kostove të zhvlerësimit nga asetet e vjetruara dhe kushteve jo të favorshme hidrologjike për gjenerim energjie.

### 2) Performanca Operative e NP sipas sektorëve

#### • Sektori i Energjisë

Dihet se në sektorin e energjisë elektrike rezultatet e angazhimit nuk vërehen menjëherë. Në këtë aspekt kemi kënaqësinë që t'i prezantojmë të arriturat e realizuara gjatë kësaj periudhe. Kështu që ky raport ofron një retrospektivë të qartë të punës së kaluar që nxjerrë në pah rezultatet e punës dhe planifikimit të bërë gjatë periudhës së kaluar.

Indikatorët Operativë	Prodhimi i Qymyrit në ton (000)	Prodhimi i Energjisë (GWh)	Humbjet teknike (%)	Humbjet komerciale (%)	Faturimi i Energjisë në dispozicion për shitje (%)	Inkasimi si (%) e faturimit	Humbjet në Transmision		Kapaciteti i Transformatorëve (MVA)
							MWh	%	
2012	8,028	5,314	16.32	20.37	82.1	90.00	109	1.99	1,800
2011	8,212	5,167	16.78	21.37	74.35	89.98	115	2.06	1,800

Tabela 2. Performanca Operative e Sektorit të Energjisë<sup>5</sup>

Nga tabela 2 vërehet se sektori i energjetikës ka progres gjatë operimeve në krahasim me vitin paraprak.

Siç shihet, këtë vit në krahasim me vitin paraprak, është gjeneruar më shumë energji për 2.8%, është faturuar më shumë për 7.75%, ndërsa janë zvogëluar humbjet e përgjithshme të energjisë (teknike dhe komerciale) në KEK për vetëm 1.46% por është prodhuar më pak edhe thëngjill për 2.2%.

Gjithashtu, në KOSTT kanë rënë humbjet në transmision nga 2.0 në 1.99% dhe është mbajtur kapaciteti i njëjtë i transformatorëve prej 1800 MVA.

#### • Sektori i Telekomunikimit

Tregu i përgjithshëm i telekomunikacionit në Kosovë kap vlerën e 250 milion eurove, pjesën më të madhe të të cilit, apo 80%, e përfshin telefonia mobile, pjesa tjetër mbulohet nga telefonia fikse dhe interneti.

Në Kosovë, PTK me të hyra mbulon 70% të telefonisë mobile, 95% të telefonisë fikse dhe vetëm 25% të Internetit.

<sup>5</sup> Të dhënat janë marrë nga Raporti Vjetor 2012 i ZRRF

Indikatorët Operativë	Telefonia Fikse (Telekomi) Numri i konsumatorëve	Telefonia Mobile (Vala) Numri i konsumatorëve	Interneti Numri i konsumatorëve
2012	75,634	1,064,860	37,560
2011	82,238	992,963	36,427

Tabela 3. Performanca Operative e Sektorit të Telekomunikacionit<sup>6</sup>-PTK

Nga tabela 3 vërehet se ka progres tek Interneti dhe mobile-Vala në rritjen e konsumatorëve, përderisa tek telefonia fikse numri i konsumatorëve ka rënë nga viti paraprak për afro 1000 konsumatorë.

Kjo rënie mund të ketë ndodhur si pasojë e konkurrencës nga operatorët e tjerë në treg, sidomos atyre privatë e të licencuar.

- **Sektor i ujit**

Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizim, të ofruar nga kompanitë publike, paraqesin ofruarin kryesorë të këtyre shërbimeve në Kosovë. Aktualisht në vitin 2012 numri i popullatës së shërbyer nga KRU është rreth 1.443.000 banorë. Gjatë vitit 2012, shkallën më të lartë të **mbulueshmërisë me shërbimet e ujit** e ka KRU ‘Radoniqi-Gjakovë me 96%, ndërsa shkallën më të ulët të mbulueshmërisë me shërbimet e ujit, gjatë vitit 2012, e ka shënuar KRU ‘Hidromorava-Gjilan’ me 57%, mirëpo krahasuar me vitin 2011, mbulueshmëria nga ana e kësaj kompanie ka shënuar rritje.

**Mbulueshmëria tek ujërat e zeza** me shërbimet e kanalizimit gjatë vitit 2012, është në nivelin 56%. Në raport me vitin 2011 është më e lartë për 5%. Mbulueshmërinë më të lartë me shërbime të ujërave të zeza në zonën e saj të shërbimit e ka realizuar KRU ‘Prishtina’, dhe në vitin 2012 ka arritur nivelin me 71%, duke e rritur mbulueshmërinë e popullatës me këtë shërbim edhe për 7%, në raport me vitin 2011. Në përgjithësi, niveli i mbulueshmërisë me shërbime të ujërave të zeza në vendin tonë është ende shumë i ulët dhe nevojat për investime në këtë drejtim janë të mëdha.

Në vitin 2012 u rrit numri i konsumatorëve të rinj të kyçur në shërbimet e furnizimit me ujë nga KRU për 10,413 sish, si rezultat i zgjerimit të shërbimeve të ujësjellësit nëpër zonat rurale. Gjithashtu, numri i konsumatorëve të cilëve u ofrohen shërbime të ujërave të zeza, është më i lartë në vitin 2012, mbi 20,000 konsumatorë në raport me vitin 2011.

Në nivel të sektorit, **mbulimi me ujëmatës për kategorinë e konsumatorëve** shtëpiak është rritur dhe në vitin 2012 dhe ka arritur nivelin në 89%. KRU ‘Prishtina’ me 96%, është kompania me proporcionin më të lartë të konsumatorëve me ujëmatës, përderisa KRU ‘Mitrovica’, ngelet në nivel jo të kënaqshëm, ku vetëm 57% e konsumatorëve shtëpiakë janë të pajisur me ujëmatës, edhe pse ka shënuar rritje krahasuar me vitin 2011.

Indikatorët operativë	2012	2011
Prodhimi i ujit (m <sup>3</sup> )	134,952	139,424
Faturimi i ujit (%)	40	39
Inkasimi i ujit (%)	71	68
Uji i pafaturuar (%)	60	61
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	89	79
Numri i konsumatorëve	249,265	238,852

Tabela 4. Performanca Operative e Sektorit të Ujit<sup>7</sup>

Nga të dhënat e tabelës 4 vërehet se tek sektori i ujit të pijshëm kemi një progres, pasi është rritur inkasimi nga faturimi për 3%, sikurse që është rritur numri i konsumatorëve për 10.418

<sup>6</sup> Të dhënat janë marrë nga Raporti Vjetor 2012 i ARKEP

<sup>7</sup> Të dhënat janë marrë nga Raporti Vjetor 2012 i ZRRUK

konsumatorë të rinj. Pas fillimit të zbatimit të strategjisë mbi reduktimet e humbjeve kemi një progres të i vogël për zvogëlimin e humbjeve nga 61% të vitit paraprak në 60% në 2012, sikurse që kemi rritje të faturimit për 1%. Kjo përqindje e madhe e humbjeve të ujit, e përbërë nga humbjet komerciale dhe teknike, është pothuajse e ngjashme edhe në vendet rajonit të Ballkanit, sado që nuk do të duhej t'i marrim pikë referente krahasuese të njëjtit, por shpresojmë që me konsolidimin e plotë të shtetit, përmes angazhimit të organeve të inspektorateve do të zvogëlohet keqpërdorimi i ujit të pijshëm dhe humbjet komerciale, ndërsa me investime në rrjet nga Qeveria dhe donatorët do të zvogëlohen edhe humbjet teknike.

Mirëpo, duhet të punohet akoma për të arritur një progres më të madh, pasi që në vitin 2012 kishte edhe indikatorë në rënie, siç ishte prodhimi i ujit.

Ndërmarrjet Publike Qendrore	Numri i punëtorëve	
	2011	2012
ANP "Adem Jashari"	159	151
KEK	7,714	7,630
KOSTT	242	374
PTK	3,349	2,394
PK		928
Infrakos	291	302
Trainkos	203	225
KMDK	52	55
Ibër Lepenc <sup>8</sup>	273	248
KRU Drini i Bardhë <sup>9</sup>	56	45
KRU Radoniqi-Dukagjini	64	65
KRU Prishtina	536	539
KRU Mitrovica	229	226
KRU Hidromorava	153	152
KRU Hidrodrini	180	183
KRU Radoniqi	228	231
KRU Hidroregjioni Jugor	237	275
<b>Totali</b>	<b>13,966</b>	<b>14,023</b>

*Tabela 5. Numri i punëtorëve në NP*

Nga të dhënat e tabelës 5 mund të konstatojmë se numri total i të punësuarve ka rritje për 57 të punësuar, e cila është paraqitur si rezultat i ristrukturimit të NP, si ndarja e PTK-s dhe themelimi i Postës së Kosovës, d.m.th. ndarjes së NP dhe themelimit të NP-ve si etnitete të pavarura, si dhe rezultat i implementimit të planeve të biznesit dhe finalizimit të projekteve të reja.

Rritja e të punësuarve ka ardhur edhe si rezultat i hapjes së vendeve të reja të punës përmes investimeve të reja, marrjes së sistemeve rurale të ujësjellësve nën menaxhim dhe rritjes së numrit të konsumatorëve, sikurse që rritja e numrit të të punësuarve në KOSTT është rezultat i kalimit të aseteve dhe të të punësuarve të stacioneve elektrike 110KW nga KEK në KOSTT, sipas vendimit të Qeverisë.

Te kompanitë ku kemi zvogëlim të numrit të të punësuarve ka ardhur si rrjedhojë e pensionimit të një pjese të të punësuarve, sikurse edhe mosvazhdimi të kontratave të punës për shkak të performancës, si bie fjala tek KEK.

Sido që të jetë, gjatë pranimit të të punësuarve përmes konkurseve publike janë thirrur dhe inkurajuar për aplikim profesionistët nga gjinia femërore dhe popullata joshumicë, normalisht në

<sup>8</sup> Nr. i punëtorëve është rritur, pasi që kjo kompani punëson punëtorë sezonal.

<sup>9</sup> Nr. i punëtorëve është rritur, pasi që kjo kompani punëson punëtorë sezonal.

përputhje me kërkesat për profesionalitet nga kushtet e konkurseve, me qëllim të përmirësimit të strukturës së të punësuarve.

### **3.2.6. Dividenda**

Dividendat janë pjesë e fitimit, e cila shpërndahet nga kompanitë. Duke marrë parasysh këshillat e menaxhimit, Bordi i Drejtoreve, është organi që përcakton se sa mjete nga fitim vjetor duhet të mbeten në Ndërmarrje për ri-investime dhe sa mund të shpërndahen në formën e dividendës.

Gjatë vitit 2012, PTK ka qenë Ndërmarrja Publike qendrore që ka deklaruar dhe ka shpërndarë dividendë për aksionarin, në shumën 45 milionë euro.

### **3.2.7. Subvencione shtetërore**

Qeveria duhet të ketë parasysh sigurimin e subvencioneve në ndërmarrje, në rrethana të caktuara nëse kjo është e përcaktuar me Ligjin për Ndarje Buxhetore. Ja disa shembuj:

Gjatë vitit 2012, bazuar në Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore, Qeveria përmes MZHE ka mbështetur me mjete financiare Ndërmarrjet Publike Qendrore e Lokale me buxhet të përgjithshëm prej 31,09 milionë euro.

#### ***Më konkretisht:***

- Qeveria ka subvencionuar Ndërmarrjet Publike, siç janë KEK, Trainkos, Ndërmarrjet e Ujërave dhe Mbeturinave, si dhe Ngrohjet Qendrore, me një shumë rreth **23,9 milionë euro**. Kjo ka qenë një ndihmë financiare e dhënë nga Qeveria me qëllim të sigurimit të mjaftueshëm të energjisë elektrike, mbulimin e rasteve sociale për konsumatorët e energjisë, mbulimit të kostove operative për qarkullimin e trenit të lirë për qytetarët, sigurimit të ngrohjes qendrore, si dhe mbulimit të kostove për shërbime të ujit dhe mbeturinave.
- Qeveria, me qëllim të rritjes së mundësisë për sigurimin e shërbimeve më kualitative për qytetarët e saj në saje të zhvillimit të projekteve të reja kapitale, ka investuar 7,1 milionë euro në ndërmarrjet publike si KOSTT, Hekurudha dhe NP të Ujërave dhe Mbeturinave. Me investimet në asetet që fitohen përmes implementimit të projekteve të reja rritet vlera e aseteve si pasuri e shtetit të Kosovës.

Në përputhje me KASH-in dhe në koordinim me FMN, edhe pse reduktimet e subvencioneve në 2011 kishin shkallë 26.5%, Qeveria ka bërë reduktimin e subvencioneve edhe në vitin 2012 për 35%, në krahasim me vitin paraprak siç vërehet edhe në Tabelën 6. të mëposhtme:

Reduktimi i subvencioneve ka rezultuar si harmonizim i politikave buxhetore të Qeverisë me Fondin Monetar Ndërkombëtar, por edhe si rritje e aftësisë së Ndërmarrjeve Publike për operim sa më funksional përmes forcave të tyre vetanake.



Ndërmarrjet Publike Qendrore dhe Lokale	2011		2012	
	Investime Kapitale (000)	Subvencione (000)	Investime Kapitale (000)	Subvencione (000)
PTK	0	0	0	0
KEK <sup>10</sup>	0	31,833	0	18,050
KOSTT	7,385	0	2,609	0
ANP	0	0	0	0
Infrakos	603	0	1,533	0
Trainkos	1,198	500	1,065	500
Ibër-Lepenc	0	0	0	0
Ndërmarrjet e Ujërave dhe Hedhurinave	2,667	1,266	1,917	1,019
Ngrohja Qendrore	474	1,948	0	4,400
Gjithsej sipas Kategorive	12,327	35,547	7,124	23,969
<b>Gjithsej NP-të Qendrore dhe Lokale</b>	<b>47,874</b>		<b>31,093</b>	

Tabela 6. Financimet e Qeverisë për Ndërmarrje Publike

### 3.2.8 Përfshirja e sektorit privat

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 10, Qeveria është përcaktuar për ekonomi të lirë të tregut dhe si rezultat i kësaj inkurajohet përfshirja e sektorit privat në mënyrë aktive në ndërmarrje publike. Një përfshirje e tillë do të sigurojë përfitim të përgjithshëm për popullin e Kosovës, duke pasur parasysh:

- efikasitetin dhe kualitetin e shërbimeve të shpërndara nga ndërmarrja;
- ndikimin e përgjithshëm ekonomik të strukturave alternative të pronësisë;
- kapaciteti i buxhetit të Qeverisë për të bërë investime në ndërmarrje që janë të nevojshme për të shpërndarë shërbime në të ardhmen; dhe
- natyra e konkurrencës brenda sektorit, në të cilin ndërmarrja operon.

Baza ligjore për privatizimin e ndërmarrjeve publike dhe futja e kapitalit privat përmes PPP, është e garantuar me nenin 160 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe është e përcaktuar me nenin 9 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin Nr. 03/L-090 mbi Partneritetin Publiko- Privat.

Si rezultat i ristrukturimit të Ndërmarrjeve Publike dhe të implementimit të politikave pronësore ndaj ndërmarrjeve publike shtetërore, me qëllimin të ngritjes së kualitetit të shërbimeve publike ndaj qytetarëve të Kosovës, ka filluar ristrukturimi në vitet e mëparshme dhe ky ende vijon:

- Hekurudhat e Kosovës sh.a. mbështetur në Ligjin mbi Hekurudhat e Kosovës nr. 03/L-076 dhe Vendimit të Qeverisë 05/110, është ndarë në dy kompani, njëra për operime (Trainkos sh.a.) dhe tjetra për infrastrukturë (Infrakos sh.a.) në vitin 2011, dhe kanë funksionuar gjatë vitit 2012 normalisht, duke kaluar vështirësitë që ndesh çdo biznes në fillimet e veta;

<sup>10</sup> Në shumën e subvencioneve për vitin 2010 dhe 2011 është përfshirë edhe subvencioni i energjisë elektrike për raste sociale me vlerë 4,500,000 (2010) dhe 4,483,493 (2011).

- Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (Adem Jashari) është ndarë në dy kompani, njëra që merret me operimin e fluturimeve ajrore dhe ofrimin të shërbimeve për udhëtarë, e cila është marrëveshje koncesionare me LimakLyon për 20 vjet, mbështetur në ligjin për PPP nr. 04/L-045 dhe kompania tjetër që merret me kontrollin ajror dhe që ka mbetur në pronësi shtetërore, e cila natyrisht është ndeshur me vështirësi që kryesisht rrjedhin prej Akt-vendimeve gjyqësore mbi ekspropojimin e tokave para koncesionimit, e që janë barrë për afarizmin e saj.
- Nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) është themeluar si kompani e pavarur Distribucioni dhe Furnizimi (KKDFE). KKDFE në fund të vitit 2012 ka përfunduar procesin e privatizimit dhe operatori privat zyrtarisht është transferuar në fillim të muajit Maj 2013.
- Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK), sipas Vendimit të Qeverisë, bazuar në Strategjinë e Privatizimit të PTK-së, në fund të vitit 2011 ka filluar ndarjen me qëllim të themelimit të Postës së Kosovës. Posta e Kosovës ka mbetur pronë shtetërore dhe nga 01 Gushti 2012 ka filluar së funksionuari si e pavarur, ndërsa 75% e aksioneve të PTK-së, që përmban shërbimin e telefonisë fikse, telefonisë mobile dhe internetit, i janë nënshtruar procesit të privatizimit, proces që pritet të finalizohet gjatë vitit 2013.
- Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës është në fazën e studimit nga Këshilltari i Transaksionit-IFC, të mundësive të futjes së kapitalit privat mbi mënyrën e ristrukturimit të saj. Komiteti ndërministror i PPP i ka dhënë dritën e gjelbër Njesisë së PPP në kuadër të MF që të rinisë procesin e PPP, ndërsa Komiteti ndërministror i PPP ka autorizuar MMPH si Autoritet Kontraktues të angazhojë Këshilltarë të Transaksionit mbi këtë proces.

### 3.3 Auditimi i Jashtëm

Pas përfundimit të çdo viti, të gjitha ndërmarrjet publike i nënshtrohen një auditimi të jashtëm nga një auditor i jashtëm, i pavarur dhe i kualifikuar. Auditimi i jashtëm kryhet nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, apo zgjidhet nga ndërmarrja publike me anë të një procesi përzgjedhës në bazë të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në Ligjin për Prokurim Publik. Ky auditor ka për detyrë ta përgatisë një vlerësim sa më real dhe profesional të pasqyrave financiare të ndërmarrjes, si dhe të performancës së saj në çdo aspekt. Raporti i Auditorit të Jashtëm duhet të paraqitet tek Bordi i Drejtorëve për informim dhe miratim, si dhe të dërgohet tek Njësia për Politika dhe Monitorim të NP-ve.

Pasi ZAP ka konfirmuar se nuk do të bëjë auditim të rregullsisë së pasqyrave financiare tek NP, ato janë audituar nga Auditorët e jashtëm të licencuar si kontraktor i NP.

Tek të gjitha ndërmarrjet ka përfunduar auditimi i jashtëm për vitin 2012 . Afati ligjor mbi auditimin e pasqyrave financiare ishte 30 maj, por derisa PTK dhe PK nuk kanë arrit të auditojnë Pasqyrat financiare deri në fund të qershorit.

Raportet rezultojnë me opinione mbi përputhshmërinë dhe rregullsinë e pasqyrave financiare dhe proceseve të kontrollit të brendshëm me standardet dhe kërkesat ligjore, ku kemi opinionet si: tetë nga to kanë opinion të pakualifikuar, një ka opinion të kualifikuar dhe shtatë si të kualifikuar me theksim çështjeje. Në krahasim me vitin paraprak, ky është një progres në opinionet e auditorëve të jashtëm.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka filluar auditimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe performancës tek dy entitetet e reja të dalura nga Hekurushat e Kosovës: TrainKos dhe InfraKos dhe në vijim është edhe auditimi i kompensimeve të bordeve të NP nga 2009-2012.


NJPMNP-MZHE ka bashkëpunuar ngushtë me ZAP mbi nje auditim sa me objektiv ndërsa aktualisht deri në fund të shtatorit është finalizuar vetem Raporti i auditimit nga ZAP për InfraKos-in.

Nga raportet e auditimit për InfraKos kanë dalë disa gjashtë të gjetura për të cilat janë dhënë rekomandime nga ZAP. Deri tani është punuar Plani i Implementimit të rekomandimeve për evitimin e të gjeturave me aktivitet, afate dhe përgjegjes adekuat dhe i njejt i është derguar ZAP, nga i cili plan vërehët së shumica nga të gjeturat tani janë evituar.

ZAP ka kryer edhe Auditimin tek Kompanite rajonale te Mbeturinave te cilat jane nen pronesin komunale, dhe ky raport nuk perfshin performance e NP locale per te cilat pergjegjesite i kane Komunat.

## 4. Performanca individuale e Ndërmarrjeve Publike Qendrore

### 4.1 Korporata Energjetike e Kosovës, sh.a. (KEK)

	<p><b>Misioni</b> Ofrimi i shërbimeve energjetike të besueshme dhe të bazuara në kosto për të gjithë konsumatorët që paguajnë, duke zbatuar rregulloret për siguri dhe shëndet dhe duke zbatuar standardet mjedisore, duke i tërhequr investimet, me qëllim të mbajtjes së realizueshmërisë financiare dhe zhvillimit. Të gjitha këto gjithmonë në ruajtje të aseteve të kompanisë përmes mirëmbajtjes së duhur dhe përkrahjes së vlerave thelbësore të kompanisë, si transparencja dhe sjellja etike.</p> <p><b>Visioni</b> Të ofrojë shërbime të furnizimit me energji elektrike të mjaftueshme për shfrytëzuesit finalë me çmime sa më të favorshme, duke respektuar standardet mjedisore.</p>
---	---

Profili i ndërmarrjes	
Emri i Kompanisë	Korporata Energjetike e Kosovës, sh.a. (KEK)
Numri i Regjistrimit	70325399
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Kryesuesi i Bordit	Fadil Çitaku
Kryeshefi Ekzekutiv	Arben Gjukaj
Auditori i Jashtëm	Ernst & Young Certified Auditors Sh.p.k.

#### Fushë - veprimtaria

Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. (KEK), është ndërmarrja e vetme energjetike në Republikën e Kosovës. Ajo është korporatizuar në fund të vitit 2005. KEK-u operon me dy mihje sipërfaqësore (mihja e Mirashit dhe mihja e Bardhit), dy termocentrale (Kosova A dhe Kosova B), Po ashtu në 2012, ka pasur edhe sektorin e furnizimit, ku përfshihet edhe sektori i shitjes së energjisë elektrike.

Ndër funksionet parësore të KEK-ut në vitin 2012 ishin: prodhimi i qymyrit, prodhimi i energjisë elektrike dhe shpërndarja e saj, shitja e energjisë, si dhe përkujdesja ndaj konsumatorëve. Për t'i arritur të gjitha funksionet e saj, kjo ndërmarrje është e ndarë në 4 divizione kryesore. Ato janë:

- Divizioni i mihjes (prodhimi i qymyrit);
- Divizioni i gjenerimit (prodhimi i energjisë elektrike);
- Divizioni i shpërndarjes (shpërndarja e energjisë); si dhe
- Divizioni i furnizimit (furnizimi me energji elektrike).

Funksionet e Korporatës rregullohen përmes politikave të Zyrës së Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës.

#### Objektivat e së ardhmes

Objektivat e kësaj ndërmarrjeje kanë të bëjnë me sigurimin e saj si një organizatë efektive dhe e gatshme për t'u përballur me çdo sfidë të së ardhmes. Disa nga objektivat janë të radhitura më poshtë:

- Përmirësimi i performancës financiare të KEK-ut përmes inkasimit 100% të energjisë në dispozicion për shitje;
- Menaxhimi dhe operimi efikas i aseteve;

- Rritja e investimeve në mbrojtjen e ambientit;
- Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare;
- Rritja e përgjegjësisë ndaj konsumatorëve dhe shoqërisë;
- Rritje e produktivitetit;
- Aftësimi i fuqisë punëtore;
- Ruajtja e marrëdhënieve me publikun dhe Qeverinë

### **Sfidat e së ardhmes**

Gjatë vitit kalendarik 2012, KEK u ballafaqua me sfida, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rezultatet e funksionimit të saj në të ardhmen. Këto sfida kanë qenë:

- Mosfunksionimi efikas i gjykatave, e cila ka sjellë deri te mosrealizimi i kërkesave për padi të bëra ndaj 8115 paditësve, shuma e të cilave në kompensim demi për KEK arrin vlerën prej 11.3 mil euro;
- Vendimi i ZRrE-se për tarifën e vitit 2013 ka sjellë pasoja në të hyrat e KEK-ut;
- Kushtet atmosferike të ftohta, të cilat vështirësojnë gjenerimin e rregullt të energjisë, por edhe furnizimin përmes rrjetit të vjetruar;
- Përdorimi i energjisë elektrike për ngrohje që rritë kërkesën totale për energji dhe në pamundësi të gjenerimit të energjisë jashtë kapaciteteve, KEK është i detyruar të importojë energji nga shtetet tjera.

### **Ngjarjet kryesore – 2012**

Viti 2012 karakterizohet me vazhdimin e procesit për privatizimin e sektorit të rrjetit dhe të furnizimit. Pas finalizimit të dokumentacionit dhe analizave të ofertuesve, komisioni ndërministror qeveritar ka përzgjedhur fituese ofertën nga konsorciumi Calik&Limak. Nënshkrimi i kontratës për shitblerjen e aksioneve nga ky konsorcium është bërë në muajin tetor 2012.

Gjithashtu, gjatë vitit 2012 kanë filluar të vijnë kërkesa të shumta për ofrim të dokumentacioneve dhe shënime të tjera nga ana e KEK-ut në lidhje me projektin e ndërtimit të termocentralit Kosova e Re. Në këtë proces është rikonfiguruar projekti, ku nga pakoja tenderuese është larguar termocentrali ‘Kosova B’.

Vështirësitë dhe parregullsitë në leximin e njehsorëve elektrikë për konsumin e energjisë në muajin dhjetor, gjë që ka shkaktuar pakënaqësi të konsumatorëve të paraqitura ndaj faturimit të muajit janar për dhjetor, e kjo pakënaqësi e shprehur përmes protestave publike dhe paraqitjes së ankesave me shkrim në KEK të paraqitura në shkurt të 2013.

### **Investimet dhe projektet – 2012**

Projektet kryesore gjatë vitit 2012 të financuara nga dy burime (vetanake dhe të huaja) janë të ndara sipas divizioneve të paraqitura më poshtë:

#### **Divizioni i Mihjeve**

- Hapja dhe operimi i minierës Sibovci Jugperëndim, burimi i financimit i huaj nga Ministria e Financave;
- Renovimi i shiritave transportues dhe pjesëve elektronike për TC Kosova B;
- Shpronësimi në fshatin Hade;

#### **Divizioni i Gjenerimit**

- Zëvendësimi i kondensatorit elektrostatik për njësinë A5&A3 në TC A;
- Riparimi kapital i Turbinës B te TCB;
- Riparimi kapital i kaldajës te TCA-Njësia A3;
- Dizajnimi, furnizimi dhe instalimi i sistemit transportues hidraulik të hirit;
- Riparimi kapital i Kazanit në njësinë A5.

**Indikatorët operativë – krahasimi me vitin paraprak**

Indikatorët operativë	Prodhimi i qymyrit në ton (000)	Prodhimi i energjisë (GWh)	Humbjet teknike (%)	Humbjet komerciale (%)	Inkasimi si (%) e faturimit
<b>2012</b>	8,028	5,314	16.32	20.37	90
<b>2011</b>	8,212	5,167	16.78	21.37	89.98

*Tabela 7. Performanca Operative e KEK*

Siç shihet në tabelë, pothuajse në të gjithë indikatorët kyç të performancës (IKP), divizionet kanë shënuar progres të dukshëm. Në krahasim me vitin 2011, performanca e vitit 2012 ka rezultuar në rritje të prodhimit dhe në rritje të inkasimit. Prodhimi i energjisë elektrike gjatë viteve ka pasur rritje në saje të mirëmbajtjes më të mirë të njërive gjeneruese dhe mundësisë së prodhimit të mjaftueshëm të thëngjillit. Prodhimi i përgjithshëm i energjisë elektrike në vitin 2012 ka qenë 5,314 GWh, ndërsa në vitin 2011 prodhimi ishte 5,167 GWh.

Ndërsa, kemi rënie të lehtë në prodhim të qymyrit. Po ashtu, humbjet teknike dhe komerciale kanë shënuar rënie, ku një rënie me e theksuar vërehet tek humbjet komerciale, ndërsa tek humbjet teknike rënia është e një niveli më të ulët, për shkak të mungesës së investimeve në modernizimin e rrjetit të shpërndarjes.

**Indikatorët financiarë– krahasimi me vitin paraprak**

	<b>2012 (000€)</b>	<b>2011 (000€)</b>
<b>Të hyrat</b>	269,976	257,496
<b>Shpenzimet</b>	(197,950)	(184,910)
<b>Fitimi/Humbja operative</b>	72,026	72,586
<b>Zhvlerësimi dhe amortizimi</b>	(43,210)	(37,711)
<b>Borxhet e këqija</b>	(13,456)	(18,358)
<b>Fitimi/Humbja financiare</b>	15,360	16,517
<b>Paraja në fund të vitit</b>	18,196	49,561
<b>Asetet fikse</b>	366,678	408,988

*Tabela 8. Performanca Financiare e KEK*

Tabela tregon se të hyrat në vitin 2012 në KEK kanë një rritje në krahasim me vitin paraprak, sikurse qe edhe borxhet e këqija, të cilat janë zvogëluar. Ndërsa, kemi rritje tek shpenzimet operative dhe të zhvlerësimit dhe si rezultat ka fitimin financiar prej 15.3 mil euro.

Vendimi i ZRRE mbi kthimin e 17.9 milionë eurove, ngase të hyrat e lejuara nga ZRRE nuk janë përmbushur, në bazë të të cilave edhe është lejuar rritja e tarifave, e ka sjellë KEK-un në situatë të vështirë financiare dhe ngushtime të mëdha buxhetore. Si pasojë e këtij vendimi, KEK-u është detyruar të paguajë tek konsumatorët, përmes KEDS-it, shumën prej 17.9 milionë eurosh.

**Auditimi i Jashtëm**

Auditimi i jashtëm për KEK-un është bërë nga Ernst & Young Certified Auditors Sh.p.k. Kjo kompani audituese pas auditimit të pasqyrave financiare, ka dhënë një opinion pa kualifikime për kompaninë me theksim çështjeje. Sipas mendimit tyre, përveç për efektet pozitive të çështjes së përshkruar në Bazën e Mendimeve të Kualifikuara, pozita e pasqyrave financiare të kompanisë me 31 dhjetor 2012 dhe performancës financiare dhe rrjedhjes së parasë së gatshme për vitin e përfunduar është në pajtim me Standardet e Raportimit Financiar.

### **Funksionimi i Qeverisjes Korporative - Bordi i Drejtorëve**

Bordi i Drejtorëve ka mbajtur takime të shumta gjatë viti 2012, (16 takime) nga të cilat 11 të rregullta dhe 5 të jashtëzakonshme, ku kanë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndryshme të ndërmarrjes. Pothuajse para çdo mbledhjeje të rregullt të bordit janë mbajtur dhe mbledhje të Komisionit të Auditimit, përkatësisht 9 mbledhje.

Duke u bazuar në nevojat që kjo ndërmarrje ka paraqitur, Bordi i Drejtorëve ka formuar dhe disa komitete të tjera, të cilët kanë mbajtur mbledhje sa herë që është parë e nevojshme. Këto komisione janë: Komisioni për Minierën e Sibovcit Jugperëndimor, i cili ka funksionuar deri në korrik të 2012 dhe Komiteti për Përcjelljen e Projekteve Mjedisore, i cili ka funksionuar deri në tetor 2012.

Njësia ka përcjellë punën e këtij bordi dhe ka bërë vlerësimin e efektshmërisë së tij. Shih vlerësimin e NJPMNP në raportin që është e publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

### **Përmbushja e kërkesave ligjore**


Raportet tremujore, vjetore dhe Plani i Biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të KEK-ut.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë dhe ka paraqitur nivelin korporativ dhe divizional të korporatës për vitin 2012. Aty janë identifikuar synimet që korporata dëshiron të arrijë në çdo njësi të biznesit të saj, si dhe treguesit kyç që do të arrijnë ta realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raportet tremujore janë shqyrtuar nga komisioni i auditimit dhe aprovuar me kohë nga bordi i drejtorëve. Menaxhmenti ka përfshirë elemente të ndryshme në përpilimin e këtyre raporteve siç janë: strukturën organizative, aktivitetet e ndryshme, projektet e përfunduara, ose të pezulluara, arritjet e divizioneve, performancën financiare dhe operative, duke e krahasuar me tremujorin përkatës të vitit të kaluar.

Raporti vjetor 2012 është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë. Ky raport ka përdorur formën narrative dhe tabelat për të paraqitur të dhënat operative dhe financiare të divizioneve, duke i krahasuar me të dhënat e një viti paraprak, si dhe me Planin e Biznesit.

## 4.2 Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu, sh.a. (KOSTT)

	<p><b>Misioni:</b> Të sigurojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shërbime kualitative duke implementuar arritjet tekniko-teknologjike në zhvillimin e sistemit të transmisionit;</li> <li>• Transparencë dhe jodiskriminim për shfrytëzuesit e sistemit të transmisionit në tregun konkurrues të energjisë elektrike;</li> <li>• Avancimi i pozitës së kompanisë në nivel ndërkombëtar përmes aktiviteteve të shtuara në këtë drejtim.</li> </ul>
	<p><b>Visioni:</b> Të ofrojë shërbime të sigurta dhe të besueshme për shfrytëzuesit e sistemit të transmisionit, e përgjegjshme në aspektin social dhe mjedisor, e integruar në mekanizmat evropianë të transmisionit të energjisë elektrike, duke qenë njëkohësisht edhe fitimprurëse.</p>

Profili i ndërmarrjes	
Emri i Kompanisë	Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu, sh.a. (KOSTT)
Numri i Regjistrimit	70325350
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Kryesuesi i Bordit	Ramadan Paçarada (U.D Kryesues)
Kryeshefi Ekzekutiv	Fadil Ismajli
Auditor i Jashtëm	BDO Kosova L.L.C

### Fushë - veprimtaria

KOSTT është krijuar si rrjedhojë e procesit të ristrukturimit të sektorit të energjisë në Kosovë, në bazë të detyrimeve që rrjedhin nga Traktati për Komunitetin e Energjisë për Evropën Juglindore, ku Kosova është anëtare me të drejta të barabarta.

I emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe i licencuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në bazë të dispozitave të legjisllacionit parësor dhe dytësor të Kosovës, KOSTT sh.a në tetor të vitit 2006 u licencua si: Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Operator i Tregut të energjisë elektrike. Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut në Kosovë, KOSTT ka një pozicion strategjik në tregun rajonal ndërkombëtar të energjisë elektrike pasi që ndërlidhet me katër sisteme të tjera siç janë, ai i Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë.

KOSTT, si Operator i Sistemit të Transmisionit për Kosovë (OST), është përgjegjës për operim efikas, ekonomik dhe të koordinuar të sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë, si dhe është përgjegjës për menaxhimin e rrjedhave të energjisë në linjat interkonjektive.

Gjithashtu, KOSTT, si Operator i Tregut të energjisë elektrike, është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tregut të energjisë elektrike, si dhe për menaxhimin e procesit të barazimit përfundimtar.

Si edhe në vitet e mëparshme, arritjet e KOSTT-it janë rezultat i angazhimit të mirëfilltë të të gjithë punëtorëve dhe ekipit menaxherial, por që u kurorëzuan me sukses falë mbështetjes institucionale dhe financiare nga aksionari, palët e interesit, si dhe qasjes profesionale të Bordit të Drejtorëve në qeverisjen korporative.



## Objektivat e së ardhmes

Objektivat e kësaj ndërmarrjeje kanë të bëjnë me sigurimin e saj si një organizatë efektive dhe e gatshme për t'u përballur me çdo sfidë të së ardhmes. Disa nga objektivat kyçe janë të radhitura si më poshtë:

- Të sigurojë zhvillimin efektiv të rrjetit të transmisionit;
- Të rris performancën e sistemit të transmisionit;
- Të avancojë planifikimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të sistemit;
- Të sigurojë qëndrueshmëri financiare;
- Të jetë punëdhënësi atraktiv, ambient për investim në zhvillimin profesional të punonjësve;
- Të vendosë marrëdhënie efektive me palët e interesit;
- Të anëtarësohet në ENTSO-e dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë;
- Të ketë pjesëmarrje aktive në proceset e zhvillimit të tregut rajonal;
- Të sigurojë ambient të sigurt pune;
- Të jetë e përgjegjshme në aspektin social dhe mjedisor.

## Sfidat e së ardhmes

Disa nga rreziqet e identifikuara si sfidë e së ardhmes janë:

- Pengesat e integritit të KOSTT-it në proceset rajonale të motivuara politikisht dhe si pasojë mosdhënia e EIC kodit me shenjen "Y", si zonë tregtare, apo zonë rregulluese nga ana e ENTSO-E, gjë që pamundëson nominimet e programeve ndërkufitare të energjisë elektrike;
- Tregu financiar për sigurimin e mjeteve për investime kapitale;
- Risku rregullator në miratimin e tarifave që nuk reflektojnë koston reale;
- Pamundësia e operimit, mirëmbajtjes dhe zhvillimit të një pjese të rrjetit transmetues të Kosovës, për shkak të ndërhyrjes ilegale të operatoreve serbë EMS dhe EPS;
- Pamundësia e qasjes për mirëmbajtës në NS Vallaq, si NS që paraqet një nyje shumë të rëndësishme elektroenergjetike, mund të shkaktojë rënie të padëshiruara dhe në këtë mënyrë zvogëlohet siguria e furnizimit me energji elektrike në disa nga NS e kësaj unaze;
- Vështirësitë financiare nga mosinkasimi i të hyrave;
- Gjendja e aseteve të transferuara të KEK-ut;
- Kriza globale.

## Ngjarjet kryesore - 2012

### • Transferimi i aseteve 110kV nga KEK ne KOSTT

Pas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për transferin e aseteve 110kV në KOSTT, dhe themelimit të grupit punues nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik për koordinimin e aktiviteteve për bartjen e aseteve, palët e përfshira kanë vazhduar punën në identifikimin fizik dhe transferin e aseteve dhe ky proces pas nënshkrimit të Marrëveshjes ka përfunduar, do të thotë se që nga 1 Prill 2012, KOSTT ka marrë përsipër mirëmbajtjen, planifikimin, zhvillimin dhe operimin e nënstacioneve 110 kV, sipas Vendimit të Qeverisë.

Në bazë të vendimit të Qeverisë gjatë periudhës raportuese është finalizuar transferi i aseteve 110kV nga KEK në KOSTT. Megjithatë, KOSTT në bashkëpunim me KEK duhet ende të punoj në transferin e paluajtshmërive. KOSTT ne regjistrat kadastral, këtu ka hasur në probleme për shkak të mungesës së dokumentacionit të cilat do të mundohemi t'i zgjidhim në baza individuale, rast për rast.

Në të njëjtën kohë KOSTT ka filluar me inspektimin e hollësishëm në teren dhe në bazë të këtij inspektimi do të hartojë prioritetet e investimeve në bazë të urgjencës, në mënyrë që të evitohen problemet eventuale gjatë periudhës së dimrit të ardhshëm.

---

- **Projekti i linjës 400kV Kosovë – Shqipëri**

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2012 janë paraqitur disa pengesa në kuadër të implementimit të projektit të linjës 400kV Kosovë-Shqipëri. Përkatesisht, OST nga Shqipëria ka kontestuar rezultatin e vlerësimit të ofertave nga komisioni vlerësues i përbashkët. Jemi të informuar se edhe kjo çështje është zgjidhur mes KfW dhe OST nga Shqipëria dhe tani pritet që KOSTT dhe OST në bashkëpunim me KfW të përcaktojnë hapat e ardhshëm për vazhdimin sa më të shpejtë të projektit. KOSTT ka angazhuar një kompani konsulente për ta kryer një analizë të tregut dhe arsyeshmërisë për zhvillimin e negociatave me ofertuesin e parë, apo përsëritjes të tenderit.

- **Nënshkrimi i marrëveshje për themelimin e CAO**

Në qershor, përfaqësuesit e dhjetë OST-ve (Kosova, Shqipëria, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Greqia, Mali i Zi, Rumania, Sllovenia dhe Turqia), të rajonit nënshkruan Marrëveshjen për Kompaninë e Ekipit të Projektit për themelimin e Zyrës për Alokim të Koordinuar të Kapaciteteve Interkonjektive (ang. CAO – Coordinated Auction Office). Selia e zyrës për Alokim të Koordinuar do të jetë në Mal të Zi.

Qëllimi i themelimit të Zyrës për Alokim të Koordinuar të Kapaciteteve të Evropës Juglindore është harmonizimi i metodave të menaxhimit të kongestionit (fytëve të ngushta) dhe optimizimin e alokimeve të kapaciteteve në kufijtë e zonës tregtuese, si dhe rritja e transparencës në procesin e alokimit të kapaciteteve interkonjektive.

- **Ricertifikimi me ISO 9001:2008**

KOSTT ka vazhduar të dëshmojë përpikëri në zbatimin e standardeve më të larta profesionale në menaxhimin e cilësisë, dhe si rezultat i kësaj KOSTT në muajin Shtator përsëri është certifikuar për herë të tretë, me standardin ISO 9001:2008. Duke marrë parasysh këtë KOSTT është duke e zhvilluar një proces të zhvillimit dhe menaxhimit të cilësisë sipas kërkesave të këtij standardi brenda të gjitha departamenteve dhe zyrave.

- **Zhvillimi i modelit financiar**

Në përgatitje për periudhën e ardhshme tarifore pesëvjeçare dhe dorëzimin e aplikimit për tarifa KOSTT ka porositur dhe zhvilluar një model financiar, i cili do të shërbejë për qëllime të simulimit të afarizmit dhe planeve zhvillimore.

## **Investimet dhe Projektet - 2012**

Duke u bazuar në planin e tij zhvillimor, KOSTT ka bërë investime të shumta, të cilat kanë bërë të mundur përmirësimin e rrjetit të transmisionit. Financimi i këtyre projekteve ka qenë bashkëpunim i KOSTT me Qeverinë e Kosovës, me donatorë të ndryshëm si KfW, KE apo me investime vetanake.

Gjatë vitit 2012 disa projekte janë përfunduar, disa të tjera kanë filluar implementimin, ndërsa disa të tjera janë në proces e sipër, të cilat do të përfundojnë në vitet në vazhdim.

Disa nga projektet më të rëndësishme gjatë vitit 2012 janë të paraqitura më poshtë:

- Paket Projekti Ferizaj-2, LOT-1: NS 400/110 kV Ferizaj 2 (vazhdim);
- Paket Projekti Ferizaj-2 LOT-2: LP ndërlidhëse 400kV dhe 110 kV(vazhdim);
- Paket Projekti SCADA/EMS dhe Telekomit LOT-1 dhe LOT 2(vazhdim);
- Ndërrimi i Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 dhe Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT);
- TI për Operimin e Tregut (LOT2) (vazhdim);
- Ndërrimi i përçuesit, izolatorëve dhe pajisjeve lidhëse në LP 125/2 dhe 125/3;
- Kçja e NS Lipjanit në linjën LP 212 (Kosova A - Ferizaj 2);
- Ndërrimi i Mbrojtjeve Rele në NS 110/35kV Prishtina 2 dhe Prishtina 3;
- Rehabilitimi në linjat 110kV, 126/4 (pjesa e vjetër), 179/1, 1801 (ndërrimi i izolatorëve dhe urave përçuese);
- Ndarja e zbarrave në dy seksione, në NS Gjilani 1 dhe NS Therandë;
- Paket Projekti NS 110 /10(20) kV Gjilani 5;

- Rialokimi i linjës 110kV, nr.1806 NS Gjakova 1-Gjakova 2 dhe rehabilitimi i pajisjeve të TL në NS Gjakova 1;
- Rehabilitimi i pajisjeve të tensionit të lartë 110 kV në NS Gjilani 1 dhe NS Ferizaj 1;
- Instalimi i dy fushave të reja të linjave 110 kV në NS Prizreni 2;
- Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Gjakova 2 dhe Prizreni 3;
- Instalimi i grupeve matëse sipas kufirit të ri KOSTT/KEK (OSSH).

#### Indikatorët operativë – krahasimi me vitin paraprak

Indikatorët operativë	Humbjet në Transmision		Kapaciteti i Transformatorëve (MVA)	Kapaciteti i Linjës (MVA)	Numri i ankesave
	MWh	%			
<b>2012</b>	109.028	1.99	1800	1350	1
<b>2011</b>	115.315	2.06	1800	1350	2

**Tabela 9. Performanca Operative e KOSTT**

Siç shihet në tabelë, humbjet në rrjetin e transmisionit janë zvogëluar nga viti në vit, falë investimeve të ndërmarra, matjeve të sakta dhe menaxhimit të mirë. Këto humbje të energjisë elektrike në transmision kanë vazhduar me trendin e zvogëlimit edhe në vitin 2012, ku humbjet kane qenë për 0.07% më të vogla nga viti paraprak. Këto humbje janë dhënë në raport me konsumin e Kosovës, ndërsa në raport me energjinë e tërë që hyn në transmision ku përfshihet edhe tranziti do të ishte 0.05% më të vogla se viti paraprak, përkatësisht 1,37% për vitin 2011, ndërsa 1,32% për vitin 2012.

Gjatë këtij viti (2012), në KOSTT janë transferuar një pjesë e aseteve të sistemit të shpërndarjes së KEK-ut, përkatësisht transformatorët 220/35/10, 110/35, 110/10(20) me kapacitet 1868,5 MVA. Ndërsa, kapacitetet e transformatorëve 400/220 kV, 400/110 kV, si dhe 220/110kV, nuk kanë ndryshuar nga viti 2011 në vitin 2012.

Për sa i përket ankesave në tension, numri i tyre është zvogëluar nga 2 që kanë qenë në vitin 2011, në 1 ankesë gjatë vitit 2012.

#### Indikatorët financiarë– krahasimi me vitin paraprak

	<b>2012 (000€)</b>	<b>2011 (000€)</b>
<b>Të hyrat</b>	21,524	18,792
<b>Shpenzimet</b>	(9,966)	(8,770)
<b>Fitimi/Humbja operative</b>	11,558	10,022
<b>Zhvlerësimi dhe amortizimi</b>	(8,769)	(6,349)
<b>Borxhet e këqija</b>	0	(2,390)
<b>Fitimi/Humbja financiare</b>	2,789	1,283
<b>Paraja në fund të vitit</b>	18,062	18,605
<b>Asetet fikse</b>	114,693	95,559

**Tabela 10. Performanca Financiare e KOSTT**

Siç shihet edhe në tabelë, KOSTT ka performuar me një afarizëm pozitiv gjatë vitit 2012, ku ka arritur një rritje në fitim nga 1.2 milion euro në 2.7 milionë euro. Për më shumë, kryerja e obligimeve me kohë ndaj klientëve dhe institucioneve të shtetit të Kosovës, e bën këtë kompani që të jetë një kompani financiarisht e qëndrueshme.

Vazhdimi i investimeve kapitale edhe gjatë vitit 2012 ka ranguar sistemin elektroenergjetik në një nivel të kënaqshëm të sigurisë dhe performancës dhe në këtë mënyrë ka arritur edhe rritja e vlerës së aseteve të KOSTT-it.

Si rezultat i një afarizmi të vitit 2012, Bordi i Drejtorëve pas auditimit të pasqyrave financiare në korrik të vitit 2013 ka deklaruar dividendë për Aksionarin prej 3.0 milionë euro.

## **Auditimi i jashtëm**

Auditimi i jashtëm për KOSTT është bërë nga BDO Kosova L.L.C. Kjo kompani, pas auditimit të pasqyrave financiare, ka dhënë një opinion pa kualifikime për kompaninë. Sipas tyre, pasqyrat financiare të kompanisë paraqiten drejt, në të gjitha çështjet materiale, pozicionin financiar të kompanisë me 31 dhjetor 2012 dhe performancën e saj financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë së saj për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

## **Funksionimi i Qeverisjes Korporative - Bordi i Drejtorëve**

Gjatë vitit 2012 Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje të rregullta dhe 2 mbledhje të jashtëzakonshme, ndërsa Komisioni i Auditimit ka mbajtur 11 mbledhje. Gjatë këtyre mbledhjeve janë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndërmarrjes.

Ndër shumë detyra të tjera, Bordi i Drejtorëve ka për detyrë edhe të formojë komisione të tjera duke u bazuar në nevojat që kompania paraqet. Bordi i KOSTT-it e ka parë të arsyeshme të funksionalizojnë edhe komisionet e përkohshme të bordit si: Komisioni për Projekte Kapitale, Komisioni për Ndarjen e Aseteve KEK-KOSTT dhe Komisioni për Linjën 400kv Kosovë – Shqipëri. Këto komisione kanë mbajtur mbledhje varësisht nga nevoja që është paraqitur për t'i mbajtur ato.

Njësia ka përcjellë punën e bordit dhe ka bërë vlerësimin e efektshmërisë së tij. Për këtë shih vlerësimin e NJPMNP, në raportin e publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

## **Përmbushja e kërkesave ligjore**

Raportet tremujore, vjetore dhe Plani i Biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it dhe janë përpunuar në bazë të kërkesave që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike.

Plani i Biznesit është një plan i përgatitur me përpikëri. Ky plan ka shtjelluar çështjen e strukturës organizative, e zhvillimit të tregut të energjisë në vend dhe rajon, e kornizës ligjore dhe rregullative, e aspekteve sociale dhe mjedisore, e sfidave duke përfshirë përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet (analiza SWOT), e planeve të investimeve, si dhe parashikimet e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Raportet tremujore kanë pasur një format standard që fillon me përshkrimin e strukturës organizative, përshkrimin e indikatorëve kryesorë financiarë dhe operacionale duke i krahasuar me vitin paraprak 2011 dhe buxhetin përkatës të vitit 2012. Po ashtu, pjesë e raporteve ka qenë edhe përshkrimi i projekteve kapitale dhe zbatimi i tyre, çështjet ligjore dhe rregullative, pasqyrat financiare dhe analizat financiare dhe operacionale.

Raporti Vjetor është dorëzuar dhe punuar sipas Udhezuesit të NJPMNP duke përfshirë edhe një paraqitje të funksionimit të qeverisjes korporative në ndërmarrje.

### 4.3 Posta e Kosovës-PK, sh.a. (PK)



#### Misioni

“Misioni i Postës së Kosovës është të tejkalojë të priturat e konsumatorëve në cilësinë e shërbimeve të veta. Tejkalmimi i qasjes ndaj tregut dhe zëvendësimi i saj me qasjen ndaj konsumatorit. PK. SH.A., gjithmonë duhet të jetë prijëse e preferuar në ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë dhe kohë optimale, me siguri të shtuar dhe besim të plotë të konsumatorëve”.

#### Vizioni

“Vizioni i Postës së Kosovës është të jetë lider i ofrimit të shërbimeve postare kualitative, të shpejta, të sigurta, konkurruese sipas trendeve bashkëkohore për konsumatorët e saj në territorin e Republikës së Kosovës”

Profili i ndërmarrjes	
Emri i Kompanisë	Posta e Kosovës-PK, sh.a. (PK)
Numri i Regjistrimit	70847701
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	525,000 €
Kryesuesi i Bordit	Halit Isufi
Kryeshefi Ekzekutiv	Sejdi Hoxha
Auditor i Jashtëm	BDO Kosova L.L.C

#### Fushë-veprimtaria

Më 1 korrik 2005, PTK-ja shndërrohet në korporatë – PTK Shoqëri Aksionare (sh.a.), ku Posta e Kosovës vepronte si një njësi biznesi brenda saj deri me 30 gusht 2013.

Gjatë vitit 2012, me vendim të Qeverisë së Kosovës, gjegjësisht Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Posta e Kosovës iu nënshtrua procesit të konsolidimit. Prandaj, me 21.05.2012 ajo u regjistrua si Shoqëri Aksionare, kurse veprimtarinë e plotë si NPQ e filloi me 01 gusht 2012.

Posta e Kosovës, si operator i vetëm publik postar, aktivitetin e vet e zhvillon në mbarë territorin e Kosovës. E organizuar në 7 regjione, e bën shpërndarjen e të gjitha dërgesave që arrijnë nga bota në Kosovë dhe anasjelltas, si dhe të atyre që grumbullohen në Kosovë dhe kanë për destinim qendrat e ndryshme të Kosovës.

Nga ana tjetër, shërbimet e Postës së Kosovës kryhen në mbi 155 Zyra Postare, ku mblidhen edhe dërgesat postare, të cilat pas përpunimit në Qendrën Transite Postare (QTP) rrugëtojnë nëpër shtete të ndryshme të botës (dërgesat me destinim ndërkombëtar), ndërsa ato që janë me destinim vendor shpërndahen në regjione.

Biznesi i PK-sh.a. aktualisht është i përqendruar në ofrimin e produkteve/shërbimeve postare, shitjen e produkteve/shërbimeve të PTK-së, shërbimet komerciale për biznese, si dhe shitjen e organizuar për konsumatorë të mëdhenj dhe për konsumatorë spontanë nëpër ZP. Por, synimi ynë është që PK-sh.a. ta zgjerojë rrjetin e shitjes (ZP) për ofrimin e shërbimeve aktuale, si dhe ta zgjerojë gamën e produkteve/shërbimeve duke zhvilluar shërbime të reja, si p.sh. zgjedhja logjistike si transporti që lidhet ngushtë me këto veprimtari, si dhe me objektivin parësor që PK-sh.a. të ofrojë pako shërbimesh sa më efektive, kualitative dhe efikase për konsumatorë.

Gjatë periudhës raportuese për pesë mujorin Gusht – Dhjetor 2012, PK-sh.a., si një ndërmarrje e re, e posa lindur pas ndarjes nga PTK-sh.a., kishte disa detyra me përgjegjësi dhe që kërkonin një angazhim të madh në shumë drejtime. Grupet e formuara punuese, me të gjitha forcat profesionale dhe teknike, arritën ta përmbyllin këtë vit si një vit i sukseseve në realizimin e planeve operative, investimeve kapitale dhe në tejkalmimin e realizimit të planit të të hyrave për 12% më shumë, krahasuar me periudhën Gusht - Dhjetor 2011.

PK - sh.a. si një ndërmarrje e re, që e filloi punën e vet si e pavarur, me një skemë organizative të papërfunduar dhe me një staf të pakompletuar, arriti t'i përmbushë pritjet më optimiste për këtë pesë mujor. Angazhimi maksimal i tërë stafit, Bordit të Drejtorëve dhe të tërë punonjësve e bëri të mundur realizimin e objektivave dhe synimeve tona në përmbylljen e sukseseve të periudhës raportuese për vitin 2012.

Gjatë kësaj periudhe që shënon ndarjen, aktivitetet kryesore kanë qenë të fokusuara dhe të orientuara në përgatitjen, konsolidimin dhe funksionalizimin e ndërmarrjes.

### **Objektivat e së ardhmes**

PK sh.a, synon që në të ardhmen të angazhohet në realizimin e objektivave bazuar në Planin e Biznesit për vitin 2013.

Disa nga objektivat kryesore për vitin 2013 janë:

- Hulumtimi i tregut dhe kuptimi më i mirë i kërkesave në treg;
- Rritja e trendit në shtrirjen e tregut vendor dhe ndërkombëtar;
- Rritja e shitjeve të produkteve/shërbimeve postare;
- Shitja e produkteve të PTK-së sipas marrëveshjes komerciale me PTK-në;
- Shitja për biznese dhe shitje komerciale;
- Rritja e numrit të konsumatorëve;
- Përmirësimi i nivelit të ofrimit të shërbimeve;
- Rritje të numrit të dërgesave vendore e ndërkombëtare;
- Rritje të nivelit të arkëtimit të borxheve të këqija;
- Rritje të nivelit të inkasimit të faturave rrjedhëse;
- Mirëmbajtja e stabilimenteve të teknologjisë informative;
- Si dhe një varg objektivash, të cilat janë të përcaktuara qartë në Planin e Biznesit - periudha afatmesme 2013 - 2015.

Për t'i realizuar këto objektiva, Posta e Kosovës synon të fokusohet në disa pika kyçe, siç janë:

- Kontrollin e kualitetit të punëve karshi rregulloreve, ligjeve dhe standardeve adekuate;
- Trajnimin e stafit për zhvillimin e fushave përkatëse;
- Aplikimin dhe avancimin e teknologjisë informative dhe digjitalizimin e proceseve të punës;
- Aplikimi i sistemit të shpërblimit dhe ndëshkimit bazuar në realizimin e performancës së treguar.

### **Sfidat e së ardhmes**

Disa nga faktorët kryesorë, të cilët mund të pengojnë Postën e Kosovës në realizimin e objektivave të saj janë:

- Mos anëtarësimi në UPU (Universal Postal Union);
- Mungesa e Sistemit të Menaxhimit të Informatave (SMI);
- Çmimet e produkteve konkurruese në treg;
- Konkurrenca legale dhe ilegale;
- Vonesa e Licencës për shërbime financiare jobankare.
- Mungesa e IPS Web Tracking – gjurmimi i dërgesës nga ana e konsumatorit për të parë destinacionin e dërgesave të kryera; etj.

### **Ngjarjet kryesore - 2012**

Një ndër ngjarjet me rëndësi në Postën e Kosovës gjatë vitit 2012 ishin:

- Marrëveshja e partneritetit në biznes me Postën Shqiptare, që përfshin edhe nënshkrimin e marrëveshjes për EMS-in ndërkombëtar. Sot, PK-sh.a. kryen shërbimet e EMS-it ndërkombëtar, përmes Postës Shqiptare.
- PK-sh.a. si ngjarje me karakter postar filatelik ka realizuar emisionin e pullave postare për vitin 2012, ku veçanërisht duhet përmendur linçimin e pullës postare "100 Vjet Shtet" për nder të 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë.



Viti 2012, po ashtu është edhe viti që e ndryshoi konceptin e funksionalizimit me fushë-veprimtarinë e saj të re, që solli risi në organizimin dhe funksionimin e PK-sh.a, përkatësisht është periudha e cila karakterizohet me ndarjen e saj nga PTK-sh.a.

### Investimet dhe Projektet- 2012

Pas ndarjes nga PTK, Posta e Kosovës ka trashëguar mjete financiare për disa projekte, ku një pjesë e tyre është realizuar gjatë periudhës Gusht –Dhjetor 2012, ndërsa pjesa tjetër ka projekte në faza të ndryshme të realizimit si:

- Renovimi dhe digjitalizimi i ZP;
- Monitorimi i procesit të punës me kamera;
- Furnizimi me kasaforta dhe vetura për transport;
- Sigurimi dhe mirëmbajta e objekteve;
- Posta Hibride;
- Automatizimi i Sporteleve;

Shërbimet Financiare Jobankare – ky është një projekt që pritet të fillojë të funksionojë gjatë vitit 2013 etj.

### Indikatorët operativë (Gusht – Dhjetor 2012) – krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit paraprak

Indikatorët operativë	Vëllimi Fizik i Dërgesave		Totali i vëllimit fizik
	Dërgesat në shkuarje	Dërgesat në ardhje	
Gusht – Dhjetor 2012	81,847	136,151	217,998
Gusht – Dhjetor 2011	77,510	152,146	229,656

Tabela 11. Performanca Operative e PK

Të dhënat në tabelën e mësipërme paraqesin një raport mbi trendin e vëllimit fizik të dërgesave postare në praninë dhe dërgim. Siç shihet, kemi një rritje në numrin e dërgesave në shkuarje dhe një rënie në dërgesat në ardhje. Në total të vëllimit fizik, kemi një rënie të vogël prej 5%.

### Indikatorët financiarë (Gusht – Dhjetor 2012) –nga Raporti i Auditorit të Jashtëm

	2012 (000€)
Të hyrat	4,402
Shpenzimet	(4,904)
Fitimi/Humbja operative	(502)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(667)
Borxhet e këqija	0
Fitimi/Humbja financiare	(1,169)
Paraja në fund të vitit	7,799
Asetet fikse	20,791

Tabela 12. Performanca Financiare e PK

Tabela e mësipërme tregon gjendjen financiare të PK gjatë periudhës Gusht – Dhjetor 2012 me një humbje financiare prej 1.1 mil eu, me asete fikse prej 20.8 mil eu, që përfshijnë 98% të aseteve të ish PTK-së dhe që në fund të vitit 2012 në llogari bankare mjete prej 7.8 mil eu, mjete këto të transferuara nga ish PTK me rastin e ndarjes, me qëllim të implementimit të projekteve kapitale që ishin pjesë e Planit të Biznesit të tërësishëm të PTK-së të parandajës.

### **Auditimi i Jashtëm**

Auditimi i Jashtëm për Postën e Kosovës është bërë nga BDO Kosova L.L.C. Kjo kompani audituese pas auditimit të pasqyrave financiare, ka dhënë një opinion pa kualifikime për kompaninë. Sipas tyre, pasqyrat financiare të kompanisë prezantojnë në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të kompanisë me 31 Dhjetor 2012, si dhe performancën financiare të saj, me ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë së saj për vitin që përfundon në këtë datë në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

### **Funksionimi i Qeverisjes Korporative - Bordi i Drejtorëve**

Bordi i Drejtorëve i emëruar nga Aksionari mban përgjegjësinë e drejtimit të kompanisë në përputhje me politikat e Aksionarit dhe në përputhje me ligjin. Gjatë vitit 2012, për periudhën katër – mujore (Gusht – Dhjetor) që ka operuar si Postë e Kosovës me vete, Bordi ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme, ku kanë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndryshme të ndërmarrjes. Ndërsa, Komisioni i Auditimit ka mbajtur 5 mbledhje. Duke u bazuar në nevojat që kjo ndërmarrje ka paraqitur, Bordi i Drejtorëve ka formuar dhe disa komisione, siç janë: Komiteti për Financa, Komiteti për Staf e Shpërblime dhe Komiteti për Hulumtime Teknologjike.


Duke marrë për bazë të lartpërmendurat, Njësia ka bërë vlerësim e efektshmërisë së bordit dhe ky raport është publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

### **Përmbushja e kërkesave ligjore**

Posta e Kosovës ka përmbushur kërkesat ligjore ndaj aksionarit. Kjo kompani ka përgatitur Planin e Biznesit 2013 me kohë dhe ka paraqitur nivelin korporativ për 2013. Aty janë identifikuar synimet që korporata dëshiron të arrijë në biznesin e saj, si dhe treguesit kyç që do të arrijnë të realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë. Po ashtu, Raporti Vjetor 2012 (01.08 – 31.12.2012) është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë. Ky raport ka përdorur formën narrative dhe tabelat për të paraqitur të dhënat operative dhe financiare, si dhe ka përmbushur kërkesat e NJPMNP sipas udhëzuesit të dërguar.



#### 4.4 Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, sh.a. (PTK)

	<b>Misioni</b> Misioni i PTK-së është të jetë gjithmonë prijëse në ofrimin e shërbimeve superiore të komunikimit, që ua përmirësojnë jetën të gjithë kosovarëve, përmes pasionit të njerëzve tanë dhe përmes përdorimit të teknologjisë më bashkëkohore të sprovuar.
	<b>Vizioni</b> Vizioni i PTK-së është të jetë forcë shtytëse në rritjen e prosperitetit të kombit dhe pasurimit të jetës së të gjithë kosovarëve.

Profili i ndërmarrjes	
Emri i Kompanisë	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, sh.a. (PTK)
Numri i Regjistrimit	70280741
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	4,475,000 €
Kryesuesi i Bordit	Rexhë Gjonbalaj
Kryeshefi Ekzekutiv	Ejup Qerimi
Auditor i Jashtëm	BDO Kosova L.L.C

#### Fushë - veprimtaria

Më 29 qershor të vitit 2005, PTK është korporatizuar dhe shndërruar në shoqëri aksionare, me emrin e ri PTK sh.a, e cila është e organizuar në tri njësi biznesi: Posta e Kosovës, Telekomu i Kosovës dhe operatori i telefonisë mobile Vala. Të tri njësitë e biznesit të PTK-së janë të licencuara nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit të Kosovës.

Operatori i telefonisë mobile Vala, ka shtrirë rrjetin e saj pothuajse në tërë territorin e Kosovës, dhe që një kohë të gjatë ofron për të gjithë konsumatorët e saj shërbimet më të avancuara të telefonisë mobile, brenda dhe jashtë operatorit Vala.

Telekomi i Kosovës ka shndërruar rrjetin e vet analog në atë të gjeneratës së ardhshme (NGN), duke mundur ofrimin e shërbimeve të telefonisë, internetit dhe televizionit përmes protokollit të internetit (IPTV).

Posta e Kosovës ishte në përbërje të PTK deri me 30 Korrik dhe nga 01 Gusht 2012 ajo tanimë është e ndarë si etnitet i veçantë biznesor.

Viti 2012 është mbyllur me një mbulueshmëri gjeografike prej 84% nga ana e shërbimeve të telekomunikacionit. VALA ka përmirësuar roamingun me 350 rrjete në mbarë botën, në mbi 130 shtete. Por, objektiv mbetet shtrirja me GPRS në shtetet që vizitohen më shpesh nga konsumatorët tanë.

Fillimi i vitit 2012 karakterizohet me implementimin e shërbimit IPTV, duke krijuar mundësi që konsumatorëve t'u ofrojmë shërbimet triple-play respektivisht zërin, internetin dhe videon. Orientimi i Telekomit ka qenë ofrimi i pakove të përshtatshme për ambiente familjare. Në pajtim me këtë koncept janë përpiluar edhe paketat e reja më të volitshme për konsumatorët.

Përkundër vështirësive me furnizime, janë ndërmarrë veprime në shtrirjen e kabllos optike për ndërlidhjen e pikave të prezencës me fije. Vitin 2012 e karakterizon edhe rritja e kërkesave për shërbime të internetit, sidomos në modifikimin e pakove, duke ua shtuar pakove të zërit edhe internetin.

## Objektivat e së ardhmes

PTK në vazhdimësi para vetes ka përcaktuar objektivat e punës të fokusuar në zhvillimin dhe avancimin e produkteve, ose shërbimeve në përputhje me vizionin dhe misionin e saj, në mënyrë që planet për të ardhmen të jenë të suksesshme dhe të rezultojë pozitive.

Mirëpo, objektivi parësor i PTK-së, vazhdon të mbetet konsumatori dhe përmbushja e kërkesave të tyre përmes ofrimit të produkteve dhe shërbimeve të reja, ndërkohë që mbetet ende në fuqi plani i synuar për zgjerimin e kapaciteteve për konsumatorë të tjerë.

Rritja e neto fitimit të PTK-së, zvogëlimi i shpenzimeve operative, si dhe shtimi i numrit të konsumatorëve, ka qenë dhe është orientim strategjik i menaxhmentit ekzekutiv të kompanisë.

## Sfidat e së ardhmes

Disa nga sfidat që PTK mund të ballafaqojë në të ardhmen janë:

- Privatizimi - Proces i filluar nga viti 2009 dhe mjaft i gjatë për kompaninë, e cila sjellë kufizimet e ndërlydhura me këtë proces;
- Shitja e produkteve - Aktualisht PTK shet produktet e saj kryesisht vetëm përmes pikave të shitjes të PK-së. Kjo gjë sjellë një mungesë të kontaktit të mjaftueshëm me konsumatorin fundor;
- Posta e Kosovës – Një ndër sfidat është dhe zbatimi i kontratave të nënshkruara me PK-në, shitja e produkteve të PTK-së dhe kujdesi me konsumatorë;
- Procesi i Prokurimit dhe Planifikimi - Procesi i planifikimit të prokurimit dhe realizimit me sukses të kontratave sipas menaxhmentit mbetet një sfidë për PTK-në, pasi që nganjëherë afatet e kërkuara me ligj paraqiten si pengesë për zhvillimin e kompanisë, veçanërisht duke marrë për bazë kushtet e konkurrencës;
- Angazhimi i ekspertëve – Duke marrë për bazë kufizimet në punësime të reja për PTK-në është vështirësi angazhimi i ekspertëve të duhur për kompaninë.

## Ngjarjet kryesore - 2012

Disa nga ngjarjet kryesore në PTK gjatë vitit 2012 janë të paraqitura më poshtë:

- Në gusht të 2012, pas një procesi të gjatë dhe shumë intensiv, Posta u nda nga PTK dhe u themelua si një entitet i pavarur;
- Për herë të parë, është futur në përdorim një plan marketingu pilot dhe harta e detajuar e produkteve për vitin 2012.
- Procesi i tribunalit mbi ndërprerjen e kontratës së projektit të faturimit;
- Anulimi i Vendimit të Bordit mbi Bonuset nga ana e aksionarit.

## Investimet dhe Projektet - 2012

Në vitin 2012, risi në PTK ishte themelimi i Zyrës për Menaxhimin e Projekteve në muajin për të ndihmuar në procesin e zhvillimit të metodologjisë për menaxhim të projekteve.

Në aspekt të projekteve kapitale, në proces ishte ndarja PK sh.a nga PTK sh.a, e që nënkuptoi edhe transferimin e projekteve kapitale të PK sh.a.

Në vijim është një përmbledhje e shkurtër e projekteve sipas njësive për vitin 2012:

### Vala

18 projekte të VALA (16 të aprovuar më herët + 2 në rishikim)

- 3 projekte të përmyllura:
  - Faza 6 – blerja e pajisjeve për zgjerim të rrjetës;
  - Hardware & Software Upgrade për brezin e ri DCS1800; dhe
  - Pjesë rezervë për gjeneratorë dhe bateri.
- Në implementim:
  - BTS – 102 të përfunduar;
  - Zgjerimi i platformës ekzistuese të faturimit për PostPaid është në implementim;
  - Zgjerimi i platformës ekzistuese të faturimit për PrePaid – kontrata është

- përmbyllur;
- Projekti për pajisje të IT është në implementim;
- 9 projekte në proces të prokurimit.

### Telekomi i Kosovës

Nga 76 projekte/ kërkesa:

- 16 projekte/ kërkesa në proces të prokurimit, të cilat kanë mbetur të realizohen në 2013 (përfshirë një kërkesë të pezulluar për makinë zarfimi. Në këtë numër janë përfshirë edhe dy raste, të cilat pjesërisht janë realizuar dhe pjesërisht mbesin në prokurim);
- 23 kërkesa të realizuara nga projektet e bartura (kontrata të nënshkruara para vitit 2012);
- 37 projekte/ kërkesa të realizuara nga projektet e vitit 2012.

### Posta – deri me 30 Korrik 2012 (në ndarje)

Nga 34 projekte/ kërkesa:

Projekte këto që pas ndarjes së PK sh.a. nga PTK sh.a. kanë kaluar në menaxhim të PK sh.a. dhe i është transferuar një shumë mjetesh PK sh.a. për projektet e mbetura kapitale. Shumë nga projektet nuk janë përmbyllur, por janë bartur në 2013.

Indikatorët operativë – krahasimi me vitin paraprak			
Indikatorët operativë	Telefonia Fikse (Telekomi) Numri i konsumatorëve	Telefonia Mobile (Vala) Numri i konsumatorëve	Interneti Numri i konsumatorëve
2012	75,634	1,064,860	37,560
2011	82,238	992,963	36,427

Tabela 13. Performanca Operative e PTK

Siç shihet në tabelë, telefonia mobile (Vala) ka shënuar një rritje në numrin e konsumatorëve, pavarësisht ekzistencës së një ambienti konkurrues. Kjo ka arritur falë investimeve të bëra në teknologjinë e re, e cila arrin të tërheqë konsumatorë të rinj. E njëjta gjë ka ndodhur edhe tek interneti dhe numri në rritje nga viti në vit i konsumatorëve.

Për sa i përket telefonisë fikse, këtu kemi një rënie të numrit të konsumatorëve dhe kjo gjë është duke ndodhur tek numri i konsumatorëve të telefonisë fikse në përgjithësi. Konsumatorët i janë drejtuar më shumë telefonisë mobile, duke mos e përdorur më në masë të madhe telefoninë fikse.

Indikatorët financiarë– krahasimi me vitin paraprak		
	2012 (000€)	2011 (000€)
Të hyrat	149,617	164,297
Shpenzimet	(90,649)	(94,156)
Fitimi/Humbja operative	58,968	70,141
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(20,630)	(24,025)
Borxhet e këqija	0	0
Fitimi/Humbja financiare	38,338	46,116
Paraja në fund të vitit	47,780	32,804
Asetet fikse	99,450	128,013

Tabela 14. Performanca Financiare e PTK

Tabela tregon se PTK edhe këtë vit ka operuar me një afarizëm pozitiv edhe pse më pak se viti paraprak, ngase ka rënie të të hyrave prej afro 25 milionë euro. Mirëpo, kjo ka ndodhur si pasojë e rikonstruktimit të PTK, përkatësisht ndarja e njësisë së biznesit, Posta e Kosovës, nga PTK.

Siç shihet në tabelë, tek asetet kemi një rënie të dukshme dhe kjo ka ndodhur për arsye të ndarjes së postës nga PTK, ku me 31.07.2012 janë transferuar në Postën e Kosovës asete fikse në vlerë prej 18,039 milionë euro, ndërsa deri në fund të korrikut vetëm shpenzime të zhvlerësimit nga asetet, të cilat në gusht kanë kaluar në Postë të Kosovës, PTK kishte 20.6 milionë euro.

#### **Auditimi i Jashtëm**

Auditimi i Jashtëm për PTK është bërë nga BDO Kosova L.L.C. Kjo kompani audituese pas auditimit të pasqyrave financiare, ka dhënë një opinion pa kualifikime për kompaninë me theksim çështjeje. Sipas tyre, pasqyrat financiare të kompanisë prezantojnë në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të kompanisë me 31 Dhjetor 2012, si dhe performancën financiare të saj, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë së saj për vitin që përfundon në këtë datë, në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

Vlen të theksohet së përbushja e kërkesës ligjore mbi auditimin e pasqyrave financiare deri më 30 maj, përkundër kërkesës dhe vërejtjeve të NJPMNP nuk u plotësua pasi i njëjti u finalizua tek në fund të qershorit. Vonimi i auditimit të pasqyrave e shtyjnë NJPNP dhe MZHE që pa dëshirë ta vonojë raportimin para publikut.

#### **Funksionimi i Qeverisjes Korporative - Bordi i Drejtorëve**

Bordi i Drejtorëve i emëruar nga Aksionari mban përgjegjësinë e drejtimit të kompanisë në përputhje me politikat e Aksionarit dhe në përputhje me Ligjin. Gjatë vitit 2012, Bordi ka mbajtur 18 takime, ku kanë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndryshme të ndërmarrjes. Ndërsa, Komisioni i Auditimit ka mbajtur 16 mbledhje. Duke u bazuar në nevojat që kjo ndërmarrje ka paraqitur, Bordi i Drejtorëve ka formuar edhe disa komisione, siç janë: Komiteti për Përcjellje të Zhvillimit të Shërbimeve të reja të Marketingut dhe Kënaqësisë së Konsumatorëve; Komiteti për Përcjelljen e Zbatimit të Planeve Kapitale dhe Ekzekutimit të Planeve të Biznesit; Komisioni për përcjellje të Qeverisjes Korporative dhe Pajtueshmërisë me Ligjin; dhe Komiteti për Resurse Njerëzore dhe Kompensime. Këto komitete kishin një aktivitet jo të mjaftueshëm të funksionimit dhe NJPMNP në 2012 ka kërkuar që të rishikohet nevoja e funksionimit të tyre, pasi këto komitete nuk kishin një aktivitet të dendur, për aq më shumë komitetet e tilla kanë karakter të përkohshëm, mirëpo edhe pas disa kërkesave të NJPMNP për bord, këto nuk u përfillën nga bordi, i cili tek në 2013 ka shuar disa nga komitetet.

Vlen të përmendet se po ky bord në fund të dhjetorit 2012 mori vendim kundërligjor, pa përfunduar viti dhe pa u ditur performanca, mbi ndarjen e bonuseve. Aksionari përmes Komisionit të Ministrave për NP, anuloi vendimin e kundërligjshëm të bordit, mirëpo ekzekutimin e vendimit mbi kthimin e bonuseve, bordi dhe menaxhmenti e ekzekutoi tek pas qershorit, apo me 6 muaj vonesë, ndërsa bordi nuk ishte në gjendje ta mbikëqyrë menaxhmentin mbi ekzekutimin e vendimit të aksionarit.

Duke marrë për bazë të lartpërmendurat, Njësia ka bërë vlerësimin e efektshmërisë së bordit dhe ky raport është publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

#### **Përbushja e kërkesave ligjore**


Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të PTK-së.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë dhe ka paraqitur nivelin korporativ gjatë 2012. Aty janë identifikuar synimet që korporata dëshiron të arrijë në çdo njësi të biznesit të saj, si dhe treguesit kyç që do të arrijnë të realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raportet tremujore janë aprovuar me kohë nga bordi i drejtorëve. Menaxhmenti ka përfshirë elemente të ndryshme në përpilimin e këtyre raporteve, siç janë: strukturën organizative, aktivitetet e ndryshme, projektet e përfunduara, ose të pezulluara, arritjet e divizioneve, performancën financiare dhe operative, duke e krahasuar me tremujorin përkatës të vitit të kaluar.

Raporti Vjetor 2012 është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë. Ky raport ka përdorur formën narrative dhe tabelat për të paraqitur të dhënat operative dhe financiare, si dhe ky raport përmbush kërkesat e NJPMNP, sipas udhëzuesit të dërguar.

#### 4.5 Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” – Kontrolli Ajror, sh.a. (ANP)

	<p><b>Misioni</b> i ANP “Adem Jashari” është të sigurojë shërbime cilësore në përputhje me standardet ndërkombëtare të trafikut ajror dhe sigurimin e fluturimeve në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës me cilësi të lartë, që nuk cenojnë mjedisin, si dhe të kontribuojë në kërkesën e sigurisë së lartë në hapësirën ajrore të Kosovës.</p> <p><b>Vizioni</b> i ANP “Adem Jashari” është që të bëhet një ofrues i certifikuar i shërbimeve të navigimit ajror, sipas kërkesave të paraqitura nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, konform standardeve ndërkombëtare të Eurocontrol dhe ICAO.</p>
---	---

<b>Profili i ndërmarrjes</b>	
Emri i Kompanisë	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” – Kontrolli Ajror, sh.a. (ANP)
Numri i Regjistrimit	70280980
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Kryesuesi i Bordit	Bekim Jashari
Kryeshefi Ekzekutiv	Bahri Nuredini
Auditor i Jashtëm	BDO Kosova L.L.C

#### **Fushë - veprimtaria**

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”- Kontrolli Ajror, është aset strategjik publik me rëndësi shumë të madhe për qytetarët e Kosovës dhe për zhvillimin e shtetit, i cili mundëson fluturimet prej Kosovës në shumë vende të botës dhe anasjelltas për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe shteteve tjera.

ANP “Adem Jashari” - Kontrolli Ajror është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve si:

- Shërbimeve të Kontrollit të Trafikut Ajror;
- Shërbimit të vëzhgimit, Komunikimit, Navigimit;
- Shërbimit të Informacionit Aeronautik;
- Shërbimit të Meteorologjisë; dhe
- Shërbime tjera ndihmëse.

#### **Objektivat e së ardhmes**

Objektivat e së ardhmes për ANP “Adem Jashari” – Kontrolli Ajror janë:

- Certifikimi si Agjenci e Shërbimeve të Navigimit Ajror;
- Koordinimi i komponentëve të ofrimit të shërbimeve të navigacionit ajror, për të ofruar shërbim efektiv të Kontrollit të Trafikut Ajror, Shërbimeve të Survejimit, Komunikimit, Navigimit, Informacionit Aeronautik dhe Meteorologjisë;
- Menaxhimi efektiv i faktorëve të përfshirë në ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror;
- Hapja e hapësirës së lartë ajrore të Republikës së Kosovës;
- Krijimi i një stabiliteti në burimet njerëzore me fokus në numrin dhe cilësinë e kontrollorëve të trafikut ajror;
- Kontrolli financiar mbi ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror, për të siguruar që kostoja të përdoret në mënyrë eficiente dhe efektive.

## Sfidat e së ardhmes

Si sfidat për të ardhmen e ANP “Adem Jashari” – Kontrolli Ajror, janë paraparë siç vijon:

- Përfundimi i shumë proceseve gjyqësore në lidhje me ankesat e palëve, të cilave u është ekspropriuar prona e tyre, do të shkaktojë probleme serioze kompanisë në aspektin financiar, si dhe disa procese të tjera gjyqësore që janë duke u zhvilluar;
- Përfundimi i proceseve gjyqësore në lidhje me ankesat e punëtorëve të larguar nga ANP “Adem Jashari” - Kontrolli Ajror, në periudha të mëhershme kohore.

Nuk parashihet ndonjë rrezik tjetër për kompaninë, përderisa të vazhdohet me trendin e investimeve në aparaturë.

## Ngjarjet kryesore -2012

Në përgjithësi, ANP “Adem Jashari” - Kontrolli Ajror ka qenë e fokusuar në jetësimin e projektit madhor të lëshimit në funksion të mbiflurimeve në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës, si dhe në implementimin e kërkesave të AACK-së dhe autoriteteve tjera përkatëse, e që kanë të bëjnë me eliminimin e nënkonformiteteve të konstatuara nga Auditorët e AACK-së dhe të gjeturat e konstatuara nga Auditori i Jashtëm, krejt kjo me qëllim që të jetë e përgatitur për çertifikim si ofrues i shërbimeve të navigimit ajror.

ANP “Adem Jashari” – Kontrolli Ajror, ka aplikuar për çertifikim për ofrim të shërbimeve të navigimit ajror. Si rezultat i këtij aplikimi do të ketë shumë procese që do të shfaqen në mënyrë që të arrihen kriteret e përcaktuara në rregulloret e AACK-së rreth çertifikimit të ANP “Adem Jashari” Kontrolli Ajror.

## Investimet dhe Projektet– 2012

Në përgjithësi, ANP “Adem Jashari” Kontrolli Ajror, ka qenë e fokusuar në jetësimin e projektit madhor të lëshimit në funksion të mbiflurimeve në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës si dhe në implementimin e kërkesave të AACK-së dhe autoriteteve tjera përkatëse, e që kanë të bëjnë me eliminimin e nënkonformiteteve të konstatuara nga Auditorët e AACK-së dhe të gjeturat e konstatuara nga Auditori i Jashtëm, krejt kjo me qëllim që të jemi të përgatitur për certifikim si ofrues i shërbimeve të navigimit ajror.

Ndër projektet që janë iniciuar, apo janë konkretizuar në vitin 2012 mund të veçojmë:

- Trajnimi i gjeneratës së tretë të Kontrollorëve të Trafikut Ajror;
- Rilokimi nga lokacioni ekzistues në kullën e re;
- Avancimi i AFTN “Aeronautical Fixed Telecommunication Network”;
- EUMETCAST DVB;
- Implementimi i Sistemit ATIS;
- Projekti i radiove tokë-tokë;
- Projekti “Plani i fluturimeve 2012”;
- Përgatitjet për “area control center”.

## Indikatorët financiarë– krahasimi me vitin paraprak

	2012 (000)	2011 (000)
<b>Të hyrat</b>	2,593	8,958
<b>Shpenzimet</b>	(3,775)	(6,874)
<b>Fitimi/Humbja operative</b>	(1,182)	(2,084)
<b>Zhvlerësimi dhe amortizimi</b>	(758)	(109)
<b>Borxhet e këqija</b>	0	0
<b>Fitimi/Humbja financiare</b>	(1,940)	396
<b>Paraja në fund të vitit</b>	1,021	6,015
<b>Asetet fikse</b>	7,938	4,109

Tabela 15. Performanca Financiare e ANP “Adem Jashari”

Nga tabela e mësipërme shihet se asetet e ANP “Adem Jashari” – Kontrolli Ajror, kanë rritje krahasuar me vitin 2011, si rrjedhojë e investimeve kapitale të bëra në vitin 2012.

Humbjet e kompanisë për vitin 2012, afër gjysmën e kësaj shume e përbën shpenzimi i



amortizimit, kurse pjesa tjetër nga shpenzimet operacionale të ANP “Adem Jashari” – Kontrolli Ajror.

Asetet e ANP “Adem Jashari” – Kontrolli Ajror për vitin 2012, krahasuar me vitin 2011 kanë shënuar një rritje, e cila vijën si rezultat i investimeve kapitale. Këto investime janë duke u bërë në pajisje të sistemeve të navigimit, investim në resurset njerëzore, përkatësisht shkollimi i kontrolloreve të rinj dhe pagesa e tokave të ekspropriuara nga vitet e kaluara.

Si rrjedhojë e këtyre proceseve gjendja e parasë së gatshme dhe parasë në llogari bankare të ANP-së, krahasuar me vitin 2011, ka pësuar një zvogëlim.

Gjithashtu, te ky zvogëlim ka ndikuar koncesionimi i ANP “Adem Jashari” – Kontrolli Ajror dhe njëkohësisht zvogëlim i të hyrave dhe pagesat për investimet kapitale.

### **Auditimi i Jashtëm**

Auditimi i Jashtëm për kompaninë “Adem Jashari” – Kontrolli Ajror, është bërë nga BDO Kosova L.L.C. Kjo kompani, pas auditimit të pasqyrave financiare, ka dhënë një opinion të drejtë për kompaninë, në të gjitha çështjet materiale, pozicionin financiar të kompanisë dhe performancën e saj financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë për vitin 2012, në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, me opinionin si i pakualifikuar.

### **Funksionimi i Qeverisjes Korporative - Bordi i Drejtorëve**

Bordi i Drejtorëve i ANP “Adem Jashari” – Kontrolli Ajror, i emëruar nga Aksionari, mban përgjegjësinë e drejtimit të kompanisë në përputhje me politikën e Aksionarit dhe në përputhje me ligjin. Gjatë vitit 2012, Bordi ka mbajtur 10 takime, ku kanë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndryshme të ndërmarrjes. Duke u bazuar në nevojat që kjo ndërmarrje ka paraqitur, Bordi i Drejtorëve ka formuar edhe disa komitete të tjera, të cilat nuk kanë pasur aktivitet të dendur. Këto komitete janë: Komisioni për Burime Njerëzore, Komisioni për Përgatitjen dhe Ndarjen e DOSHNA-së dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Projekteve Kapitale.

### **Përmbushja e kërkesave ligjore**

Raportet tremujore, vjetore dhe Plani i Biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të ANP “Adem Jashari” – Kontrolli Ajror, dhe janë përpunuar në bazë të kërkesave që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike.

Plani i Biznesit është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë. Ky plan ka shtjelluar çështjen e strukturës organizative, e zhvillimit të tregut të energjisë në vend dhe rajon, e kornizës ligjore dhe rregullative, e aspekteve sociale dhe mjedisore, e sfidave, duke përfshirë përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet (analiza SWOT), e planeve të investimeve, si dhe parashikimet e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Raportet tremujore kanë pasur një format standard që fillon me përshkrimin e strukturës organizative, përshkrimin e indikatorëve kryesorë financiarë dhe operacional, duke i krahasuar me vitin paraprak 2011 dhe buxhetin përkatës të vitit 2012. Po ashtu, pjesë e raporteve ka qenë edhe përshkrimi i projekteve kapitale dhe zbatimi i tyre, çështjet ligjore dhe rregullative, pasqyrat financiare dhe analizat financiare dhe operacionale.

Raporti Vjetor është dorëzuar dhe punuar sipas Udhëzuesit të NJPMNP, duke përfshirë edhe një paraqitje të funksionimit të qeverisjes korporative në ndërmarrje.



#### 4.6 Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës, sh.a. (Infrakos)



##### **Misioni i Infrakos-it është që të sigurojë:**

Një infrastrukturë hekurudhore konkurruese, të qëndrueshme dhe të suksesshme në përputhje me nevojat e shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës dhe më gjerë, duke i plotësuar kërkesat e sigurisë, të ambientit dhe ato ekonomike.

**Visioni** është ofrimi i shërbimeve të infrastrukturës hekurudhore sa më cilësore, me siguri të lartë dhe çmime konkurrencte, duke shfrytëzuar dhe i duke mundësuar operatorit realizim të transportit të mallrave dhe udhëtarëve sipas standardeve evropiane.

##### **Profili i ndërmarrjes**

Emri i Kompanisë	Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës, sh.a. (Infrakos)
Numri i Regjistrimit	70325327
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Kryesuesi i Bordit	Hysen Fazliu
Kryeshefi Ekzekutiv	Agron Thaqi
Auditor i Jashtëm	ETIKA

##### **Fushë - veprimtaria**

INFRAKOS, si kompani e cila veprimtari kryesore e ka ofrimin e shërbimeve të infrastrukturës për ndërmarrjet transportuese hekurudhore, ka filluar të veprojë si kompani në vete që nga data 01.09.2011, në përputhje me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 05/110 të datës 26.02.2010 mbi ndarjen e Hekurudhave të Kosovës sh.a.

INFRAKOS si njëra ndër pasueset e Hekurudhave të Kosovës sh.a, në tërësi është një kompani publike në pronësi të shtetit dhe si e tillë ofron shërbime infrastrukturore hekurudhore.

INFRAKOS menaxhon 333,451 km të linjave të hapura ekzistuese hekurudhore, 105,784 km linja nëpër stacione dhe 103,4 km linja industriale. Të gjitha këto linja hekurudhore janë njëbinarëshe dhe të paelektifikuara. INFRAKOS, mirëmban binarët, sistemet sinjalizuese, sistemet komunikuese, si dhe 34 stacione, 115 ura, 23 tunele dhe ndërtesat e tjera.

##### **Objektivat e së ardhmes**

Që të arrihet niveli i dëshiruar i mirëmbajtjes së infrastrukturës hekurudhore, në vijim janë paraqitur objektivat për vitet në vijim:

- Ofrimi me kohë dhe korrekt i të gjitha shërbimeve ndaj operatorëve të transportit për qasje në rrjetin hekurudhor;
- Menaxhimi me sukses i patundshmërisë dhe ngritja e inkasimit të të hyrave për min. 5%;
- Ngritja e nivelit të mirëmbajtjes së linjave hekurudhore dhe binarëve industrialë, si dhe ngritja e sigurisë së përgjithshme në komunikacionin hekurudhor;
- Përmirësimi i nivelit të shërbimeve dhe përmirësimi i proceseve të brendshme;
- Përmirësimi i komunikimit brenda kompanisë dhe me klientët tonë;
- Ndryshimi i kulturës biznesore të punonjësve të kompanisë bazuar në të arriturat e reja teknologjike përmes ngritjes profesionale dhe ripërtëritjes së stafit;
- Përmirësimi i strukturës gjinore; dhe
- Përmirësimi i kushteve të punës për stafin.

##### **Sfidat e së ardhmës**

Si sfida që paraqiten për kompaninë në të ardhmen janë:

- Mirefunksionimi i plotë i operatorit - Trainkos;

- Financimi jo i mjaftueshëm i projekteve zhvillimore të infrastrukturës;
- Obstruksionet e vazhdueshme nga Hekurudhat Serbe dhe bllokim i daljes veriore për në Serbi;
- Kostoja e lartë e investimeve në mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e linjave jashtë funksionimit;
- Pamundësia e përtëritjes së mekanizmit për mirëmbajtjen e linjave hekurudhore.

### Ngjarjet kryesore - 2012

Infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës sh.a – INFRAKOS, në vitin 2012, përveç ngjarjeve të përditshme, të cilat janë aktivitete ditore të kompanisë, po ashtu e kanë karakterizuar edhe disa ngjarje shumë të rëndësishme, të cilat janë të ndërlidhura shumë ngushtë me zhvillimin e kompanisë dhe të cilat janë faktorë kyç në ecejaket e mëtejme, qoftë në zhvillim dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore, qoftë në zhvillimin e biznesit, apo ofrimin e shërbimeve korrekte, të sigurta dhe jodiskriminuese për të gjithë shfrytëzuesit e kësaj infrastrukture. Ndër ngjarjet më të rëndësishme mund të ceket Miratimi i Deklaratës së Rrjetit për vitin 2013, si dhe Licencimi i Infrakosit për kryerjen e Shërbimeve të Infrastrukturës Hekurudhore në Republikën e Kosovës.

### Investimet dhe Projektet - 2012

Sikurse edhe vitet e kaluara, edhe në vitin 2012 InfraKos, sh.a. ka realizuar një numër të caktuar të projekteve zhvillimore të financuara nga Buxheti i Kosovës. Në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës bëjnë pjesë këto projekte:

- 1.Rehabilitimi i tunelit Gajre;
- 2.Furnizimi me shina S-49;
- 3.Furnizimi me traversa nga druri ahu dhe bingu;
- 4.Furnizimi me balast;
- 5.Furnizimi me material të imët të infrastrukturës;
- 6.Furnizimi me makina të imta për binarë; dhe
- 7.Furnizimi me makinë për rregullimin e gjeometrisë së binarit.

Projekti kryesor ka qenë për rehabilitimin e tunelit Gajre në Grykën e Kaçanikut, i cili është realizuar me sukses dhe furnizimi me pjesë të infrastrukturës që, po ashtu është realizuar me sukses.

### Indikatorët financiarë – krahasimi me vitin paraprak

	2012 (000€)	1 Shtator 2011 – 31 Dhjetor 2011 (000€)
<b>Të hyrat</b>	3,163	1,337
<b>Shpenzimet</b>	(2,215)	(1,056)
<b>Fitimi/Humbja operative</b>	948	281
<b>Zhvierësimi dhe amortizimi</b>	(990)	(364)
<b>Borxhet e këqija</b>	(10)	0
<b>Fitimi/Humbja financiare</b>	(52)	(83)
<b>Paraja në fund të vitit</b>	133	423
<b>Asetet fikse</b>	19,804	19,682

*Tabela 16. Performanca Financiare e INFRAKOS*

Duhet të kemi parasysh se të dhënat në tabelë nuk janë për periudha të njëjta krahasues, megjithatë Infrakos ka arritur ta zbresë humbjen për 30 mijë euro, ngase të dhenat e 2011 janë për periudhën katërmujore.

### Auditimi i Jashtëm

Auditimi i Jashtëm për Infrakos është bërë nga “ETIKA”, kompani e licencuar për auditim. Kjo kompani audituese pas auditimit të pasqyrave financiare, ka dhënë një opinion pa kualifikime për kompaninë. Sipas tyre, pasqyrat financiare të Kompanisë NP “INFRAKOS” prezantojnë drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicioni financiar me 31 Dhjetor 2012 dhe performancën financiare të saj, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë së saj, që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

### **Funksionimi i Qeverisjes Korporative - Bordi i Drejtorëve**

Bordin e Drejtorëve e ka emëruar Qeveria e Kosovës. Gjatë vitit 2012 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur 19 takime, ndërsa Komiteti i Auditimit ka mbajtur 14 mbledhje. Bordi i Drejtorëve ka formuar edhe komitete tjera gjatë viti 2012, këto komitete janë: Komiteti për Hulumtime dhe Teknologji; Komiteti për Siguri dhe Financa; dhe Komiteti për Staf dhe Kompensime.

### **Përmbushja e kërkesave ligjore**

Raportet tremujore, vjetore dhe Plani i Biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të InfraKos sh.a.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë, aty janë identifikuar synimet, si dhe treguesit kyç që do arrijnë të realizojnë, apo ta përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raporti i tremujorit të katërt, së bashku me Raportin Vjetor janë shqyrtuar paraprakisht nga Komisioni i Auditimit dhe janë aprovuar me kohë nga Bordi i Drejtorëve. Është miratuar dhe dorëzuar me kohë edhe Raporti i Auditorit të Jashtëm dhe Raporti mbi kënaqshmërinë e konsumatorit.

#### 4.7 Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës, sh.a. (Trainkos)



##### **Misioni i Trainkos-it është që të sigurojë:**

Shërbime të transportit të mallrave dhe udhëtarëve sa më cilësorë, me siguri të lartë dhe çmime konkurrense, duke shfrytëzuar infrastrukturën hekurudhore, sipas standardeve evropiane.

**Visioni është:** të ofrojë shërbime të transportit sa më cilësore të mallrave dhe udhëtarëve, me siguri të lartë dhe çmime konkurrense, duke shfrytëzuar infrastrukturën hekurudhore sipas standardeve evropiane.

##### **Profili i ndërmarrjes**

Emri i Kompanisë	Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës, sh.a. (Trainkos)
Numri i Regjistrimit	70773120
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Kryesuesi i Bordit	Hasan Ibraj
Kryeshefi Ekzekutiv	Betim Gjoshi
Auditor i Jashtëm	N.SH. "Eco&Conto"

##### **Fushë - veprimtaria**

TRAINKOS, sh.a, është duke operuar si kompani e re, e themeluar në shtator të viti 2011 në përputhje me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 05/110 të datës 26.02.2010 mbi ndarjen e Hekurudhave të Kosovës sh.a.

Kompletimi i stafit dhe realizimi i parashikimeve për vitin 2012 ishin sfidë për vazhdimin e punës me sukses dhe arritjes së qëllimit për një performancë pozitive.

##### **Objektivat e së ardhmes**

Objektivat kryesore të kompanisë janë:

- Ngritja e një bashkëpunimi të qëndrueshëm me operatorët rajonalë dhe atyre nga vendet e BE-së në transportin hekurudhor me qëllim të shkëmbimit të përvojave të suksesshme.
- Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve teknike dhe resurseve njerëzore.
- Të rris shërbimet dhe cilësinë e tyre në transportin hekurudhor, për një zhvillim të vazhdueshëm të ndërmarrjes.
- Objektivi në tregun e transportit të udhëtarëve është që të kemi një nivel të njëjtë apo të përafërt me vitin 2012.

##### **Sfidat e së ardhmës**

Sfidat me të cilat do të ballafaqohet kompania Trainkos në të ardhmen janë:

- Gjendja jo e mirë e infrastrukturës hekurudhore dhe kufizimet që shkaktohen në operim, qoftë në aspektin e shpejtësisë, ashtu edhe në operimin 24/7;
- Politika komerciale që do ta shkaktojë INFRAKOS-i në caktimin e kushteve për shfrytëzimin e rrjetit, si dhe në shfrytëzimin e shërbimeve të terminalit;
- Fleksibiliteti i konkurrentëve në sektorin e transportit dhe lejimi i konkurrencës jolojale;
- Kostoja e lartë e investimeve në mjetet lëvizëse.

##### **Ngjarjet kryesore – 2012**

Njëra prej ngjarjeve më të veçanta me të cilën është ballafaquar qysh në fillim të viti 2012, kanë qenë kushtet klimatike, të cilat kanë ndikuar dukshëm në realizimin operativ të kësaj periudhe. Përveç kësaj, një ndikim të madh ka pasur edhe operimi me kapacitete të përgjysmuara të prodhimit nga partneri kryesor – New Co Ferronikel.

Çështje tjetër me rëndësi për vitin 2012 ishte edhe miratimi i Deklaratës së Rrjetit për vitin 2013. Ngjarje e veçantë në vitin 2012 është edhe Licencimi i Trainkos për Kryerjen e Shërbimeve të Transportit Hekurudhor në Republikën e Kosovës nga ARH. Po ashtu, edhe arritja e marrëveshjes me MI për Shërbimet Publike është e një rëndësie të veçantë.

### Investimet dhe Projektet– 2012

Trainkos gjatë viti 2012 ka realizuar një numër të madh projektesh, por me kryesore janë projektet e financuara nga buxheti i Kosovës të cilat janë:

- Projekte kapitale për mjete lëvizëse;
- Riparimi i mesëm i trenave motorikë.

### Indikatorët operativë – krahasimi me vitin paraprak

Indikatorët operativë	1 Shtator 2011 – 31 Dhjetor 2011	2012
Transporti i mallrave (ton)	358,170	747,416
Numri i udhëtarëve	108,692	366,537

Tabela 17. Performanca Operative e TRAINKOS

Treguesit në tabelën e mësipërme nuk korrespondojnë me periudha të njëjta kohore krahasuese, por siç mund të shihet në tabelën, gjatë viti 2012 TrainKos ka pasur rënie në transportin e mallrave, ndërsa ka pasur rritje në numrin e udhëtarëve.

### Indikatorët financiarë– krahasimi me vitin paraprak

	2012 (000€)	1 Shtator 2011 31 Dhjetor 2011 (000€)
Të hyrat	5,053	2,364
Shpenzimet	(4,803)	(1,588)
Fitimi/Humbja operative	250	776
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(720)	(428)
Borxhet e këqija	0	0
Fitimi/Humbja financiare	(470)	348
Paraja në fund të vitit	458	420
Asetet Fikse	6,962	7,511

Tabela 18. Performanca Financiare e TRAINKOS

Vitin 2012, kjo kompani ka arritur ta përmbyllë me humbje prej 470 mijë euro. Kjo vjen si rezultat i rritjes së shpenzimeve dhe rritjes së zhvlerësimit.

### Auditori i Jashtëm

Auditimi i Jashtëm për Trainkos është bërë nga N.SH. “Eco-Conto”, kompani e licencuar për auditim. Kjo kompani audituese pas auditimit të pasqyrave financiare, ka dhënë një opinion pa kualifikime për kompaninë. Sipas tyre, pasqyrat financiare të kompanisë NP “TRAINKOS” prezantojnë drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicioni financiar me 31 Dhjetor 2012 dhe performancën financiare të saj, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë së saj, që janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

### Funksionimi i Qeverisjes Korporative – Bordi i Drejtorëve

Bordin e Drejtorëve e ka emëruar Qeveria e Kosovës me Vendim. Bordi gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 15 mbledhje, ndërsa Komisioni i Auditimit ka mbajtur 16 takime.

Bordi i Drejtorëve ka formuar dhe disa komitete të tjera, të cilat kanë mbajtur mbledhje sa herë që është parë e nevojshme. Këto komitete janë: Komiteti për Staf dhe Shpërblime, Komiteti për Asete,

Komiteti për të Arkëtueshmet dhe të Pagueshmet, Komiteti për Projekte Kapitale, Komiteti i Financave dhe Komiteti për Hulumtime dhe Teknologji.

### **Përmbushja e kërkesave ligjore**

Raportet tremujore, vjetore dhe Plani i Biznesit, janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të TrainKos sh.a.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë dhe ka paraqitur nivelin korporativ gjatë 2012. Aty janë identifikuar synimet, si dhe treguesit kyç që do arrijnë t'i realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raporti i tremujorit të katërt, së bashku me raportin vjetor, janë shqyrtuar paraprakisht nga komisioni i auditimit dhe janë aprovuar me kohë nga Bordi i Drejtorëve. Është miratuar dhe dorëzuar më kohë Raporti i Kënaqmërisë së Konsumatorit edhe Raporti i Auditorit të Jashtëm.

---

**Misioni i RADONIQI –it është që të:**

Furnizojë me ujë të pijshëm të gjithë konsumatorët e vet, pa dallim race, religjioni, apo kombësie në rajonin e tyre furnizues, për të siguruar një kompani financiarisht të vetëqëndrueshme dhe afatgjatë;

**Vizioni është:** të ofrojë shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm për konsumatorët tanë, sipas normativave dhe standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, si dhe ta rrisë vlerën e aseteve publike si pronë e shtetit të Kosovës në rajon.

**Profili i ndërmarrjes**

Emri i Kompanisë	KRU Radoniqi, Sh. A.
Numri i Regjistrimit	70433554
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Kryesuesi i Bordit	Leonard Shehu (U.D Kryesues)
Kryeshefi Ekzekutiv	Ismet Ahmeti
Auditori i Jashtëm	Kanuni i Auditorit

**Fushë - veprimtaria**

Ndërmarrja KRU 'Radoniqi', sh.a. merret me prodhimin dhe distribuimin e ujit të pijshëm dhe për largimin e ujërave të zeza për regjionin Gjakovë, Rahovec dhe një pjesë të komunës së Prizrenit dhe kështu mbulon territorin me rreth 220.000 banorë, të cilët përfshihen në këto shërbime.

Furnizimi me ujë bëhet nga liqeni i Radoniqit. Kapaciteti për fazën e parë është projektuar për 500 l/sec, ndërsa aktualisht prodhimi arrin edhe deri në 730 l/sec.

KRU 'Radoniqi' sh.a. rrjetin e vet e shtrinë prej fshatit Skivjan deri në fshatin Zym, me rreth 220.000 banorë, që përfshin Komunën e Gjakovës me 41 fshatra, dhe Komunën e Rahovecit me 8 fshatra, si dhe 13 fshatra të Komunës së Prizrenit. Kurse, aktivitetin për ujërat e zeza që janë inkorporuar gjatë vitit 2006, zhvillohet në qytetin e Gjakovës dhe qytetin e Rahovecit. Furnizimi i liqenit bëhet nga lumi Lumbardhë i Deçanit, përmes kanalit derivues nga Lluka e Epërme deri në Lajthijat, pastaj nëpërmjet kanalit natyral-kanjonit derdhet në liqenin akumulues. Kapaciteti i liqenit është 119.000.000 m<sup>3</sup>. Kompania ka fabrikën për përpunimin e ujit në fshatin Zhdrellë, me kapacitet prodhues deri 600 litra për sekond.

Qasja e afarizmit të kompanisë është transparente dhe etike, e bazuar në dispozita ligjore. Kjo bëhet në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Zyrën Rregullative për Ujë dhe Kanalizim, komunat, konsumatorët etj. Kompania zbaton tarifa të çmimeve që i vendosë Zyra Rregullative për Ujë dhe Kanalizim, si autoriteti i vetëm dhe kompetent për përcaktimin e tarifave.

Kompania, do të shikojë gjithashtu, që ujerat e zeza t'i përpunojë në të ardhmen nëpërmjet një impianti për trajtimin e ujërave të zeza.

**Objektivat e së ardhmes**

Kompania KUR Radoniqi ka përcaktuar këto objektiva strategjike në periudhën e paraqitjes së Biznes-Planit 2012-2014, si më poshtë:

- Zvogëlimi i humbjeve të ujit në rrjet;
- Zgjerimi i sistemit të rrjetave të reja në vendbanime;
- Ndërrimi i rrjetit të ujësjesit;
- Përmirësimi i funksionit të sistemit;
- Përmirësimi i matjeve të ujit në sistem dhe të konsumatorëve.



## Sfidat e së ardhmes

Meqenëse, ndikimet që vijnë nga jashtë, përkatësisht nga rrethina afariste, ndikojnë në implikimet e veprimtarisë së kompanisë, janë analizuar dhe identifikuar disa nga rreziqet e mundshme që janë dhënë në vazhdim:

- Kërcënimet financiare nga kriza financiare globale e shprehur përmes zvogëlimit të remitencave që ndikon në uljen e inkasimit;
- Moslejimi i ngritjes së tarifave në përputhje me shpenzimet nga Rregullatori;
- Rritja e tarifave të shpenzimeve të rrymës;
- Rritja e nivelit të furnizimit të rajoneve me pompa;
- Ndryshimet e mundshme klimatike, siç është ngrohja globale që po ndikon në masë të madhe në zvogëlimin e resurseve ujore në përgjithësi;
- Rritja e keqpërdorimeve të konsumit të ujit të pijes;
- Avaritë në pajisjet dhe stabilimentet e rëndësisë së lartë dhe dëmtimet mekanike;
- Ndërprerjet e tejkëqitura të furnizimit me shërbime si pasojë e fuqisë mbinatyrore;
- Ndikimet ekstreme të motit dhe katastrofave natyrore (erërat, zjarri, vërshimet, tërmetet);
- Ndikimi i ndotjeve të papritura (hedhja e kemikaleve mbi dhe në kaptazhe <sup>11</sup>, ose në resurset ujore, neglizhenca në proceset e përpunimit të ujit, etj.).

## Ngjarjet kryesore - 2012

Aktivitetet kryesore të kësaj kompanie kanë qenë krijimi i kushteve që kompania t'i realizojë synimet e parapara sipas Planit të Biznesit.

Çështjet e dinamikës së operativës kanë qenë aktivitetet e dorës së parë, krahas aktiviteteve për çështjet financiare, të prokurimit, si dhe të racionalizimit të shpenzimeve në të gjithë sektorët e punës në KRU, me përkushtim të posaçëm për shfrytëzimin e grandeve që do të ndikojnë në ngritjen e performancës teknike të infrasktrukturës për qasje më të mirë, si dhe përgatitjen e makinerisë së rëndë të ndërmarrjes për aktivitet të suksesshëm të operativës së ujësjellësit dhe kanalizimeve.

## Investimet dhe Projektet-2012

### Projektet e realizuara ne vitin 2012

Investimet nga mjetet e Qeverise se republikës se Kosoves:

- Ndërrimi i Gypave Primar per qytetin e Gjakoves,
- Rehabilitimi i Stacionit te Filtrimit (Automatika dhe Pneumatika e Filtrave);
- Instalimi / shtrirje e rrjetit te ujësjellësit per Lagjen e Epërme te Fshatit Berkoc,

Ndërsa, me investime vetanake është bërë implementimi i projekteve:

- Me rastin e kryerjes së punimeve në rregullimin e rrugëve Tomë Gjoka, Lidhja e Prizrenit, si dhe Abdurrahman Buza nga ana e Komunës – Gjakovë, KRU Radoniqi ka bërë ndërrimin e gypave të ujësjellësit;
- Ndërrimin e ujëmatëseve kryesorë dhe individualë;
- Pajisje elektro – mekanike;
- Renovimi i materialit në katin përdhësë të objektit të Drejtorisë. Është modifikuar hapësira për ofrimin e shërbimeve për konsumatorë, me standarde të mjaftueshme që konsumatorëve t'u mundësohet qasje e lehtë në realizimin e kërkesave të tyre dhe kryerjen e obligimeve ndaj kompanisë;
- Renovimi i eksterierit të objektit të Drejtorisë së kompanisë. Është punuar fasada e jashtme, rrethoja dhe trotualet me pllaka të granitit;
- Renovimi i një objekti në ish-kazemat ushtarake (përballë Drejtorisë së Kompanisë) për vendosjen e personelit të Drejtorisë së Pylltarisë, sipas Marrëveshjes me KK – Gjakovë, si dhe është rregulluar hapësira e përshtatshme për autoparkun e Kompanisë;
- Është në ndërtim e sipër objekti i ri i administratës për njësinë punuese në Rahovec;

<sup>11</sup> Kaptazha është objekti i ndërtuar mbi lumin Lumbardh i cili një pjesë të ujit të lumit e ridrejton në drejtim të liqenit të Radoniqit.

Ky objekt po ashtu e ka edhe funksionin e rregullimit të sasisë së rrejdhes së ujit në kanal.



- Renovimi i objektit të djegur në Xërxë;
- Ndërtimi i dy shtëpizave të rojave në rezervuarin Qerim dhe në Digë;
- Pajisje kompjuterike për zyrë dhe punë në terren;
- Është realizuar blerja e makinerisë së re: 4 vetura terreni, 2 kamionë dhe 1 ekskavator.

Plani i investimeve bazohet kryesisht nga të ardhurat vetanake dhe buxheti i Qeverisë, megjithatë ekziston një numër i projekteve të mëdha, të cilat kërkojnë financim të jashtëm edhe vlerësim të detajuar.

Arritjet kryesore pas këtyre investimeve do të jenë:

- Zvogëlimi i humbjeve të ujit në rrjetë;
- Zgjerimi i sistemit të rrjetave të reja në vendbanime;
- Ngritja e nivelit të sigurisë punuese të sistemit të furnizimit me ujë, domosdoshmëria e pajisjeve telemetrike, mjete të reja pune;
- Përmirësimi i matjeve të ujit në sistem dhe tek konsumatorët.

#### Indikatorët operativë – krahasimi me vitin paraprak

Indikatorët operativë	2012	2011
Prodhimi i ujit në (000)m <sup>3</sup>	15,073	20,377
Faturimi i ujit (%)	41	30
Inkasimi i ujit (%)	78	71
Uji i pafaturuar (%)	59	70
Testet e dështuara të ujit (%)	0	0.1
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	92	91
Numri i konsumatorëve	28,703	27,345

**Tabela 19. Performanca Operative e KRU Radoniqi**

Sipas tabelës, prodhimi i ujit për vitin 2012 ka pësuar rënie, duke e krahasuar me vitin 2011 prej 5 milionë m<sup>3</sup>. Ky zvogëlim i prodhimit të ujit krahasuar me vitin paraprak (2011), bazohet në rritjen e volumit të ujit të prodhuar si rezultat i zvogëlimit të humbjeve të ujit nga identifikimi i humbjeve teknike dhe komerciale të ujit dhe menjanimi i konsumatorëve paushall që kanë shpenzuar shumë ujë. Numri i konsumatorëve për vitin 2012 krahasuar me numrin e konsumatorëve për vitin 2011 është rritur për 1,358, por vlen të përmendet reduktimi i humbjeve prej 11%, rritja e faturimit, po ashtu për 11%, si dhe rritja e inkasimit nga faturimi për 7% nga viti paraprak.

Të gjitha këto janë arritur falë ndërrimit të menaxhmentit dhe angazhimit të menaxhmentit të ri në nivel të lartë.

#### Indikatorët financiarë– krahasimi me vitin paraprak

	2012 (000€)	2011 (000€)
<b>Të hyrat</b>	3,233	2,919
<b>Shpenzimet</b>	(2,108)	(1,884)
<b>Fitimi/Humbj operative</b>	1,125	1,035
<b>Zhvlerësimi dhe amortizimi</b>	(1,683)	(1,717)
<b>Borxhet e këqija</b>		0
<b>Fitimi/Humbja financiare</b>	(558)	(682)
<b>Paraja në fund të vitit</b>	543	200
<b>Asetet fikse</b>	28,697	30,053

**Tabela 20. Performanca Financiare e KRU Radoniqi**

Në vitin 2012 të hyrat kanë mbuluar 100% të kostos së operimit të mirëmbajtjes. Ndryshimi i të ardhurave për vitin 2012 krahasuar me të ardhurat e vitit 2011 janë rritur për 311 mijë euro, ndërsa kompania kishte fitim operativ prej 1.1 milion euro, por për shkak të shpenzimeve të vlerësimit viti mbyllet me humbje financiare që janë më të vogla se viti paraprak për afro 130 mijë euro.

Përndryshe, kompania në fund të vitit 2012 kishte në llogarinë bankare 543 mijë euro që është më

---

shumë se viti paraprak për 150%.

### **Auditimi i Jashtëm**

Pas auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2012, kompania audituese vlerëson me opinion të kualifikuar – Sipas auditorit të jashtëm, pasqyrat financiare të kompanisë prezantoi në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të kompanisë me 31 Dhjetor 2012, si dhe performancën financiare të saj, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë së saj për vitin që përfundon në këtë datë, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

### **Funksionimi i Qeverisjes Korporative – Bordi i Drejtorëve**

Bordi i Drejtorëve të KRU Radoniqi ka mbajtur takime të shumta gjatë 2012, (11 takime), ku kanë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndryshme të ndërmarrjes, ndërsa Komisioni i Auditimit ka mbajtur 10 mbledhje pune. Njësia ka përcjellë punën e efektshmerisë së bordit, sidomos në funksion të funksionalizimit të qeverisjes korporative dhe këtë vlerësim e ka publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

### **Përmbushja e kërkesave ligjore**

Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të KRU Radoniqi dhe janë përpunuar në bazë të kërkesave që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike.

Plani i Biznesit është një plan i përgatitur me përpikëri. Ky plan ka shtjelluar çështjen e strukturës organizative, e zhvillimit të tregut të energjisë në vend dhe rajon, e kornizës ligjore dhe rregullative, e aspekteve sociale dhe mjedisore, e sfidave duke përfshirë përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet (analiza SWOT), e planeve të investimeve, si dhe parashikimet e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Raportet tremujore kanë pasur një format standard që fillon me përshkrimin e strukturës organizative, përshkrimin e indikatorëve kryesorë financiarë dhe operacionale duke i krahasuar me vitin paraprak 2011 dhe buxhetin përkatës të vitit 2012. Po ashtu, pjesë e raporteve ka qenë edhe përshkrimi i projekteve kapitale dhe zbatimi i tyre, çështjet ligjore dhe rregullative, pasqyrat financiare dhe analizat financiare dhe operacionale.

Raporti Vjetor është dorëzuar dhe punuar sipas Udhëzuesit të NJPMNP, duke përfshirë edhe një paraqitje të funksionimit të qeverisjes korporative në ndërmarrje.



Zyret Qendrore  
Rr. Gazmend Zajmi 5 30000 Pejë-Kosovë  
Telefoni: +381 (0)39 432 355  
www.hidrodrini.com

#### Misioni i HIDRODRINI –it është që të:

Misioni i përgjithshëm i K.U.R “Hidrodrini” sh.a, është që të sigurojë ujë të pijshëm, të bollshëm dhe pa ndërprerje për të gjithë konsumatorët e saj pa dallim race dhe religjioni. Burimet e ujit duhet të shfrytëzohen racionalisht, për të siguruar furnizimin të pakufizuar dhe sipas standardeve të kërkuara.

**Vizioni është:** Të ofrojë shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm për konsumatorët, sipas normativave dhe standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, si dhe ta rrisë vlerën e aseteve publike si pronë e shtetit të Kosovës.

#### Profili i ndërmarrjes

Emri i Kompanisë	KRU Hidrodrini, sh. a.
Numri i Regjistrimit	70433918
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Kryesuesi i Bordit	Shkelzen Hyseni
Kryeshefi Ekzekutiv	Agron Tigani
Auditor i Jashtëm	Etika

#### Fushë - veprimtaria

Kompania Rajonale për Ujë dhe Kanalizim ‘Hidro-Drini’ është themeluar si shoqëri aksionare dhe vleresohet se mbulon me ujë të pijes rreth 185.000 banorë, ndërsa shërbimet e ujërave të zeza 60,000 banorë. Kapaciteti momental prodhues të ujit brenda muajit sillet në 2.3 milionë m<sup>3</sup>.

Qendra e kompanisë është në Pejë. Në strukturën e vetë ka 5 njësi të biznesit në Pejë, Istog, Klinë dhe Junik. Këtu duhet veçuar rastin e Njësisë Operative të Deçanit, ku me vendim të Kuvendit Komunal ata janë shkëputur nga Kompania nga Qershori i vitit 2006; mirëpo me ndryshimin e ligjit mbi NP edhe kjo çështje është qartësuar dhe JO e Deçanit është inkorporuar në kuadër të KRU Hidro-Drinit-Pejë.

#### Objektivat e së ardhmes

Objektivat e kompanisë për të ardhmen janë si vijon:

- Evitimi në kohë dhe eliminimi i menjëhershëm të të gjitha rrjedhjeve vizuale në sistem, si dhe implementimi i zonave DMA për reduktimin e humbjeve teknike;
- Reduktimi i humbjeve teknike administrative, eliminimi i mangësive në sistemin e inkasimit (arkëtimit) përmes;
- Ndarjes së inkasuesesve në lexues të ujëmatësve dhe inkasues të faturave etj.

#### Sfidat e së ardhmes

Kjo kompani ka analizuar faktorët që do ndikojnë si rreziqe në të ardhmen e kompanisë:

- Vonesa në implementimin e GIS-it, MIS-it, plani i mirëmbajtjes së rrjetit, si dhe përshkrime të qarta të vendeve të punës dhe furnizimi 24h me ujë.
- Faktor tjetër relevant, që mund të ndikojnë në rrezikun e kompanisë është edhe ndikimi natyror, si dhe rënia e niveleve tek burimet.

#### Ngjarjet kryesore - 2012

Ndër ngjarjet kryesore që mund të cekën si ngjarje kryesore të kësaj kompanie është se në këtë vit ka - zvogëlim të humbjeve të ujit për 4%, në krahasim me vitin paraprak;

- gjatë vitit 2012 janë bërë gjithsej 1400 riparime në rrjetin e ujësjellësit;
- është mirëmbajtur kanalizimi në 151 rrugë, në gjithsej 9450m rrjet dhe;
- është finalizuar gati ndërtimi i fabrikës së ujit në Klinë.

### Investimet dhe Projektet - 2012

Investimet dhe Projektet për vitin 2012:

- Rrjeti i ri i rehabilitimit të ujësjellësit në lagjen "Sahat Kulla";
- Rrjeti i ri i rehabilitimit të ujësjellësit në lagjen "ZATRAT";
- Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në Pejë, Istog dhe Junik;
- Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në Gurakoc;
- Ndërtimi i stacionit të pompave të reja;
- Ndërtimi i rezervuarëve të rinj, V=3000m<sup>3</sup>;
- Gypi magjstral Lubov, lagjeja Gecaj-Banjicë

### Indikatorët operativë – krahasimi me vitin paraprak

Indikatorët operativë	2012	2011
Prodhimi i ujit në (000)m <sup>3</sup>	26,981	27,714
Faturimi i ujit (%)	34	30
Inkasimi i ujit (%)	57	62
Uji i pafaturuar (%)	66	70
Testet e dështuara të ujit (%)	1	7.8
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	94	86
Numri i konsumatorëve	30,745	34,719

*Tabela 21. Performanca Operative e KRU Hidrodrini*

Prodhimi i ujit në vitin 2012 ka pasur rënie nga vetë fakti i zëvendësimit të gypave të vjetëruar me gypa të rinj. Kompania ka një faturim më të madh për 4% nga viti paraprak dhe kjo është si rezultat i angazhimit më të madh të inkasantëve në leximin e ujëmatësve. Ndërsa, shkalla e arkëtimit është më e vogël për 5% në krahasim me vitin paraprak (2011).

Humbjet e ujit edhe pse me një ritëm të ngadalshëm, po zvogëlohen gradualisht, dhe për vitin 2012 kemi humbje të ujit 66%, apo që është mbi mesataren e sektorit të ujit për 5%. Pritet që pas përfundimit të investimeve të zotuar nga investitorët e jashtëm do të ketë edhe me tej rezultate në zvogëlimin e humbjeve. Numri i konsumatorëve ka rënë për 4 mij, si rezultat i reregjistrimit të konsumatorëve, me ç'rast janë çregjistruar konsumatorët fiktivë.

### Indikatorët financiarë– krahasimi me vitin paraprak

	2012 (000€)	2011 (000€)
<b>Të hyrat</b>	3,579	3,067
<b>Shpenzimet</b>	(1,634)	(1,576)
<b>Fitimi/Humbja operative</b>	1,945	1,491
<b>Zhvlerësimi dhe amortizimi</b>	(1,178)	(1,142)
<b>Borxhet e këqija</b>	(780)	(502)
<b>Fitimi/Humbja financiare</b>	(13)	(153)
<b>Paraja në fund të vitit</b>	515	417
<b>Asetet fikse</b>	18,473	14,893

*Tabela 22. Performanca Financiare e KRU Hidrodrini*

Të ardhurat totale kanë pasur një rritje krahasuar me vitin paraprak dhe kjo si rezultat i angazhimit më të madh të kompanisë.

Kostot nga operimi janë mbajtur në nivelin e planifikuar, por kemi një rritje krahasuar me vitin paraprak.

---

Zhvlerësimi dhe borxhet e këqija janë shpenzime që varen nga investimet kapitale dhe në qoftë se ka investime kapitale atëherë do të vjen duke u rritur dhe në qoftë se nuk ka investime kapitale ky shpenzim do të jetë më i vogël, sepse baza e llogaritjes së shpenzimit vjen duke u zvogëluar.

Kjo ndërmarrje ka përfunduar vitin me një humbje më të vogël se viti paraprak, si rezultat i rritjes së të hyrave. Ndërsa, falë investimeve sidomos nga KfW dhe Usaid, është rritur vlera e asetëve për afro 4.4 milionë euro.

### **Auditimi i Jashtëm**

Opinion i Auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare të 2012 ishte opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes – Sipas mendimit të Auditorit të Jashtëm, pasqyrat financiare të kësaj kompanie prezantojnë drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar më 31 Dhjetor 2012 dhe performancën financiare të saj, ndryshimet në ekuitete dhe rrjedhën e parasë së saj, që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

### **Vlerësimi i Qeverisjes Korporative – Bordi i Drejtorëve**

Bordi i Drejtorëve të KUR HIDRODRINI ka kompetencë të formojë komisione të tjera, duke u bazuar në nevojat që kompania paraqet. Bordi nuk e ka parë të arsyeshme dhe të nevojshme të formojë ndonjë komision. Gjatë vitit 2012, Bordi i Drejtorëve ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta dhe mbledhje të jashtëzakonshme, ndërsa Komisioni i Auditimit ka mbajtur, po ashtu 12 mbledhje të rregullta dhe 2 mbledhje të jashtëzakonshme. Gjatë këtyre mbledhjeve janë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndërmarrjes. Edhe pse kompania është në humbje financiare, të cilat fatmirësisht nga viti në vit po vijnë duke u zvogëluar dhe ka humbje të mëdha të ujit, bordi ishte efektiv në vendimmarrje dhe monitorim të implementimit të Planit të Biznesit.

### **Përmbushja e kërkesave ligjore**


Raportet tremujore, vjetore dhe Plani i Biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të KRU Hidrodrini-it dhe janë përpunuar në bazë të kërkesave që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike.

Plani i Biznesit është një plan i përgatitur me përpikëri. Ky plan ka shtjelluar çështjen e strukturës organizative, e zhvillimit të tregut të energjisë në vend dhe rajon, e kornizës ligjore dhe rregullative, e aspekteve sociale dhe mjedisore, e sfidave duke përfshirë përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet (analiza SWOT), e planeve të investimeve, si dhe parashikimet e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Raportet tremujore kanë pasur një format standard që fillon me përshkrimin e strukturës organizative, përshkrimin e indikatorëve kryesorë financiarë dhe operacionalë duke i krahasuar me vitin paraprak 2011 dhe buxhetin përkatës të vitit 2012. Po ashtu, pjesë e raporteve ka qenë edhe përshkrimi i projekteve kapitale dhe zbatimi i tyre, çështjet ligjore dhe rregullative, pasqyrat financiare dhe analizat financiare dhe operationale.

Raporti Vjetor është dorëzuar dhe punuar sipas Udhëzuesit të NJPMNP, duke përfshirë edhe një paraqitje të funksionimit të qeverisjes korporative në ndërmarrje.

#### 4.10 Kompania Rajonale e Ujësjellësit Hidromorava sh.a.

	<b>Misioni</b> Misioni i KRU 'Hidromorava' sh.a. është: furnizimi me ujë të pijshëm, largimi i ujërave të ndotura, mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm dhe rrjetit të ujërave të ndotura. Të gjithë konsumatorët do të kenë trajtim dhe qasje në shërbim: pa diskriminim racor, religjioz, kombëtar dhe gjinor.
	<b>Vizioni</b> Të ofrojë shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm për konsumatorët e Regjionit të Gjilanit sipas normativave dhe standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, si dhe ta rrisë vlerën e asetëve publike, si pronë e shtetit të Kosovës në rajon.

#### Profili i ndërmarrjes

Emri i Kompanisë	KRU Hidromorava sh.a.
Numri i Regjistrimit	70433937
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Kryesuesi i Bordit	Avdyl Hasani
Kryeshefi Ekzekutiv	Myrvete Hoti
Auditor i Jashtëm	"H&N" Sh.P.K

#### Fushë - veprimtaria

Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit 'Hidromorava' sh.a., është Ndërmarrje Publike që ofron shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe mbledhje të ujërave të zeza në pjesën juglindore të Kosovës, përkatësisht në komunat e Gjilanit, Vitisë dhe Kamenicës.

Prodhimi, shitja e ujit të pijshëm dhe mbledhja e ujërave të zeza janë aktivitetet kryesore të ndërmarrjes.

Vlerat kryesore të kompanisë janë përkushtimi për ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj konsumatorëve, arritja e vetëqëndrueshmërisë financiare dhe të qenit transparent ndaj akterëve relevantë të sektorit të ujit në Kosovë.

#### Objektivat e së ardhmes

Objektivat kryesore të kompanisë për periudhën 2013-2016 janë si në vijim:

- Furnizimin me ujë të gjithë konsumatorëve, përfshirë edhe ata në pikat e larta;
- Përmirësimin e kualitetit të ujit të pijshëm në pajtim me standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.
- Arritjen e vetëqëndrueshmërisë financiare, duke ngritur shkallën e inkasimit;
- Promovimin e relacioneve të mira me konsumatorë;
- Adoptimin e politikave tarifore të ZRRUK-it për arritjen e të ardhurave të mjaftueshme mbulimin e shpenzimeve operative dhe investimet e domosdoshme;
- Sigurimin e shfrytëzimit racional të burimeve të ujit;
- Zvogëlimin e ujit të pafaturuar dhe zvogëlimin e shpenzimeve për njësi prodhim;
- Inkorporimin e ujësjellësve ruralë në kuadër të Hidro-Moravës;
- Inkorporimin e sistemeve të ujësjellësve të komunave të reja të regjionit në kuadër të Hidro-Moravës.

#### Sfidat e së ardhmes

Sfidat e së ardhmes për Bordin dhe Menaxhmentin e kompanisë janë:

- Borxhet e larta të konsumatorëve, të cilat vazhdojnë të rriten për çdo vit;



- Humbjet e ujit është sfidë tjetër e madhe për kompaninë;
- Identifikimi i kyçjeve ilegale dhe regjistrimi i konsumatorëve të rinj;
- Marrja në menaxhim të sistemeve të Ujësjellësve ruralë dhe sistemeve të ujësjellësve të komunave të reja;
- Bashkëpunimi i kompanisë me pushtetin lokal, atij qendror dhe realizimi i projekteve me donatorë;
- Mirëmbajtja cilësore e rrjetit;
- Detektimi i rrjedhjeve në rrjet;
- Sanimi në kohë i defekteve dhe rregullimi i infrastrukturës

### Ngjarjet kryesore - 2012

Ngjarjet kryesore që kanë ndodhur gjatë vitit 2012 janë si në vijim:

- Kyçja dhe marrja nën menaxhim të sistemeve të ujësjellësve të fshatrave Mireshe dhe Llovcë, si dhe janë në proces edhe përfshirja e ujësjellësve të komunave të reja të regjionit të Gjilanit. (Kllokot, Partesh, Ranilluk, Novobërdë).
- Në Komunën e Gjilanit kanë filluar përgaditjet për realizimin e projektit të financuar nga Qeveria Zvicerane i rezervuarit të ujit me kapacitet prej 3000 m<sup>3</sup> ujë. Ky rezervuar do t'u mundësojë furnizimin më të rregullt me ujë qytetarëve të Gjilanit.
- Ndërtimi i objektit të ri të administratës ka përfunduar, është bërë inaugurimi i tij dhe tani zyrat qendrore të kompanisë janë vendosur në të, me çka janë krijuar mundësi të punës dhe administrimit. Projekti i objektit të administratës është financuar nga pushteti qendror.

### Investimet dhe Projektet - 2012

Gjatë vitit 2012 janë bërë investime të konsiderueshme në rrjetin e ujësjellësit në Gjilan dhe në dy njësitë operative Kamenicë dhe Viti, si nga ana e kompanisë ashtu edhe nga ana e komunave dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës. Investimi më serioz këtë vit ishte projekti:

- Ndrimi i gypit të ujësjellësit në rrugën "Mulla Idrizi" në Gjilan, i cili ka përfunduar me sukses. Projekti ka qenë i financuar nga MZHE. Në kuadër të përmirësimit të furnizimit të qytetarëve me ujë, kompania ka bërë disa investime në rrjetin e ujësjellësit, sidomos në zgjerimin e zonës së shërbimit dhe në rritjen e presioneve në rrjetin e ujësjellësit.
- Investimet e Komunës së Gjilanit në ndërtimin e kolektorëve kryesorë të lumit Mirusha dhe Baja.

### Indikatorët operativë – krahasimi me vitin paraprak

Indikatorët operativë	2012	2011
Prodhimi i ujit në (000)m <sup>3</sup>	7,610	7,181
Faturimi i ujit (%)	39	41
Inkasimi i ujit (%)	74	78
Uji i pafaturuar (%)	61	59
Testet e dështuara të ujit (%)	1,1	1,9
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	85	81
Numri i konsumatorëve	21,574	19,110

**Tabela 23. Performanca Operative e KRU Hidromorava**

Nga tabela del se arritjet për vitin 2012 kanë qenë: Prodhimi i ujit më i madh për 6% në krahasim me vitin paraprak 2011, që nga menaxhmenti shpjegohet me arsyet se në këtë rritje të prodhimit të ujit ka ndikuar numri i lartë i konsumatorëve pa ujëmatës dhe defektet e shpeshta në rrjetin e ujësjellësit.

Ndërsa, arsyet kryesore të humbjeve të ujit janë: Rrjeti i amortizuar i gypave, keqpërdorimet në rrjet, kyçjet e dyfishta në rrjet dhe kyçjet ilegale etj.

Inkasimi në vitin 2012 ka qenë më i ulët për 4%, në krahasim me vitin 2011. Në këtë përqindje të ulët të inkasimit ka ndikuar fakti se në këtë vit shumë konsumatorë janë legalizuar pa dëshirën e tyre dhe të njëjtit nuk kanë participuar në pagesa për legalizime. Tarifat e legalizimeve i janë

ngarkuar në fatura, e të cilat i paguajnë në periudhat pasuese.

#### **Indikatorët financiarë– krahasimi me vitin paraprak**

	<b>2012 (000€)</b>	<b>2011 (000€)</b>
<b>Të hyrat</b>	1,882	1,716
<b>Shpenzimet</b>	(1,221)	(1,113)
<b>Fitimi/Humbja operative</b>	661	603
<b>Zhvlerësimi dhe amortizimi</b>	(514)	(674)
<b>Borxhet e këqija</b>	(180)	(281)
<b>Fitimi/Humbja financiare</b>	(33)	(352)
<b>Paraja në fund të vitit</b>	157	147
<b>Assetet fiks</b>	8,783	8,306

*Tabela 24. Performanca financiare e KRU Hidromorava*

Tabela tregon se kompania ka zvogëluar humbjet financiare nga viti paraprak prej 352 mijë eurë në 33 mijë euro, edhe pse është treguar se kompania ka fitim operativ dhe nuk vjen në pikëpyetje vazhdimësia e aktivitetit të saj, megjithatë shihet se përkundër angazhimit të bordit dhe menaxhmentit, kompania ka probleme financiare.

#### **Auditimi i Jashtëm**

Auditimi i Jashtëm i pasqyrave financiare 2012 për KRU Hidromorava sh.a. është bërë nga kompania audituese “H&N” Sh.P.K”. Pas auditimit, kjo kompani ka dhënë një opinion të pa kualifikuar me theksim të çështjes për kompaninë.

Sipas saj, pasqyrat financiare të kompanisë paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të kompanisë me 31 Dhjetor 2012 dhe performancën e saj financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë së saj për vitin që ka përfunduar, në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

#### **Funksionimi i Qeverisjes Korporative - Bordi i Drejtorëve**

Bordi i Drejtorëve ka mbajtur takime të shumta gjatë vitit 2012, (10 takime), ku kanë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndryshme të ndërmarrjes, ndërsa Komisioni i Auditimit ka mbajtur 8 mbledhje pune. Njësia ka përcjellë punën e Bordit dhe ka konstatuar se Bordi ka qenë në nivel të përgjegjësive dhe ka pasur efekt pozitiv në performancën e kompanisë.

Andaj, edhe NJPMNP ka bërë vlerësimin e efektshmerisë së tij në performancën e kompanisë dhe raporti i njëjtë gjendet i publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

#### **Përmbushja e kërkesave ligjore**

Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të KRU ‘Hidromoravës’.


Plani i Biznesit është përgatitur me kohë për vitin 2012, me përmbajtje të detajuar duke identifikuar synimet, si dhe treguesit kyç që do arrijnë të realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raportet tremujore janë shqyrtuar paraprakisht nga komisioni i auditimit dhe janë aprovuar me kohë nga Bordi i Drejtorëve.

Raporti Vjetor 2012 është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë. Ky raport ka përdorur formën narrative dhe tabelat sipas Udhëzuesit që ua ka dërguar NJPMNP, për të paraqitur të dhënat operative dhe financiare.



#### 4.11 Kompania Rajonale e Ujësjellësit Hidroregjioni Jugor sh.a.

	<p><b>Misioni</b> Misioni i KRU 'Hidroregjioni Jugor' sh.a. është: furnizimi me ujë të pijshëm, largimi i ujërave të ndotura, mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm dhe rrjetit të ujërave të ndotura. Të gjithë konsumatorët do të kenë trajtim dhe qasje në shërbim: pa diskriminim racor, religjioz, kombëtarë, dhe gjinorë.</p> <p><b>Vizioni</b> Të ofrojë shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm për konsumatorët, sipas normativave dhe standardeve të Organizatës Botërore të shëndetësisë, si dhe ta rrisë vlerën e aseteve publike si pronë e shtetit të Kosovës në rajon.</p>
---	---

#### Profili i ndërmarrjes

Emri i Kompanisë	KRU. Hidroregjioni Jugor sh.a.
Numri i Regjistrimit	70433702
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Kryesuesi i Bordit	Naser Bajraktari
Kryeshefi Ekzekutiv	Besim Baraliu
Auditor i Jashtëm	Kanuni i Auditorit Istog

#### Fushë - veprimtaria

Që nga Korriku i vitit 2007 KRU 'Hidroregjioni Jugor' funksionon si shoqëri aksionare. Kjo kompani shërbimet e veta i ofron në pjesën jugore të Kosovës, duke përfshirë këto komuna:

- Prizren;
- Suharekë;
- Dragash;
- Malishevë; dhe
- Mamushë.

Furnizimi me ujë bëhet prej burimeve nëntokësore vetanake. Në nivel të kompanisë furnizohen edhe 39 fshatra që janë të kyçura në rrjetin e Kompanisë Regjionale Prizren, Suharekë, Malishevë. Kapaciteti prodhues sillet rreth 750 l/sec. - Kapaciteti ndryshon varësisht nga kapaciteti i burimeve. Furnizimi bëhet 40% me pompa, 60% me gravitet. Numri i popullatës në të cilën Kompania e Ujësjellësit Regjional Prizren i kryen shërbimet e veta vlerësohet të jetë rreth 200.000 banorë.

#### Objektivat e së ardhmes

Objektivat e KRU. Hidroregjioni Jugor për vitet në vijim janë:

- Mirëmbajtja e stabilimenteve Elektro-makinerike,
- Mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza me qëllim të zvogëlimit të humbjeve në rrjet dhe evitimin e prishjeve me kohë,
- Aktivitetet në përfundimin e projekteve për instalimin e ujëmatësave,
- Përpjekjet që çdo konsumatori t'i matet 100% sasia e ujit të shpenzuar dhe t'i bëhet faturimi në bazë të sasisë së ujit të shpenzuar;
- Pasurimi i Sistemit Gjeografik të Informimit me të dhëna të reja;
- Përpjekjet maksimale në identifikimin e klientëve të rinj;
- Angazhimi në mbledhjen e borgjeve të vjetëra, si dhe inkasimi i faturave rrjedhëse;
- Identifikimi dhe rritja e numrit të konsumatorëve përfshirë këtu edhe lidhjet ilegale;
- Vazhdimi i informimit të konsumatorëve dhe bashkëpunimi me organet komunale në mënyrë që shfrytëzimi i ujit të bëhet në suaza normale.

## Sfidat e së ardhmes

Sfidat për të ardhmen e KRU. Hidroregjioni Jugor janë:

- Rritja e zonës së mbëlueshmërisë me shërbime;
- Rritja e investimeve në zonat e reja të shërbimit;
- Menaxhimi i burimeve ekzistuese;
- Zvogëlimi i humbjeve të ujit;
- Ruajtja dhe monitorimi i cilësisë së ujit të pijes;
- Furnizim i rregullt;
- Rritja e shkallës së inkasimit;
- Sfidë tjetër e Bordit dhe menaxhmentit të kompanisë ka qenë edhe borxhet e larta të konsumatorëve, si dhe borxhet e rasteve sociale.

## Ngjarjet kryesore - 2012

Ngjarjet kryesore për vitin raportues mund të paraqiten në disa pika:

- Shtimi i Burimeve të reja;
- Është rritur numri i konsumatorëve të rinjë;
- Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale;
- Paisja e konsumatorëve me ujëmatës deri në shkallën 93%;
- Rritja e bashkëpunimit me Kuvendet Komunale;
- Mbulueshmëria e zonave rurale, apo marrja në menaxhim e ujësjellësve nëpër fshatrat e regjionit;
- Përfundimi i projekteve me donatorë.

## Investimet dhe Projektet– 2012

Projektet e implementuara 2012 për KRU. Hidroregjioni Jugor janë:

- Ndërtimi i objekteve administrative në Njësitë Suharekë dhe Malishevë. Investim nga MZHE;
- Largimi i ujërave të zeza në Kosovën Jugëperendimore. Investim nga KfW;
- Ndërtimi i gypave transportues te lokacioni “40 burimet” dhe hulumtimi i ujit në këtë lokacion. Investim nga KfW;
- Përmirësimi i infrastrukturës hardverike të teknologjisë informative. Investim nga USAID;
- Ndërtimi i gypit magjstral prej ‘Pusi i Atit’ deri tek rezervuari në Shirokë. Investim nga USAID;
- Rehabilitimi i rrjetit në fshatin Kobaj. Investim nga USAID;
- Ndërtimi i pusëve dhe vendosja e ujëmatësve zonalë Prizren, Dragash, Malishevë dhe Suharekë. Investim nga USAID;
- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Gjinovc dhe pesë fshatra të tjera. Investim nga Zyra Zviceriane – CDI; si dhe
- Investimet me mjete vetanake nga Komuna e Prizrenit, Suharekës dhe Malishevës;

## Indikatorët operativë – krahasimi me vitin paraprak

Indikatorët operativë	2012	2011
Prodhimi i ujit në(000) m <sup>3</sup>	19,614	20,439
Faturimi i ujit (%)	39	37
Inkasimi i ujit (%)	72	72
Uji i pafaturuar (%)	61	63
Testet e dështuara të ujit (%)	4.4	5.3
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	93	82
Numri i konsumatorëve	36,226	33,490

Tabela 25. Performanca Operative e KRU Hidroregjionit Jugor

Gjatë vitit 2012 është prodhuar më pak ujë sesa në të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Kjo rënie e prodhimit të ujit është si rezultat i rënies së nivelit të burimeve të vjetra. Faturimi në vitin 2012 ka

pasur një ngritje prej 2%, në krahasim me vitin 2011. Inkasimi ka qenë i njëjte - 72 %, ndërsa te uji i pafaturuar ka pasë një rënie prej 2%. Ky zvogëlim i ujit të pafaturuar është arritur si rezultat i rritjes së aktiviteteve kryesore për zvogëlimin e humbjeve të ujit, që nënkupton parandalimin e keqpërdorimeve dhe sanimin në kohë të defekteve në terësi.

#### Indikatorët financiarë – krahasimi me vitin paraprak

	2012 (000€)	2011 (000€)
<b>Të hyrat</b>	4,069	3,579
<b>Shpenzimet</b>	(2,770)	(2,428)
<b>Fitimi/Humbja operative</b>	1,299	1,151
<b>Zhvlerësimi dhe amortizimi</b>	(923)	(1,021)
<b>Borxhet e këqija</b>	(724)	(626)
<b>Fitimi/Humbja financiare</b>	(348)	(496)
<b>Paraja në fund të vitit</b>	60	8
<b>Asetet fikse</b>	16,467	14,060

*Tabela 26. Performanca Financiare e KRU Hidroregjionit Jugor*

Fitimi/Humbja financiare, edhe pse këtë vit qëndron pak më mirë se në vitin 2011, prapë kompania po afaron me humbje, si rezultat i zhvlerësimit dhe rritjes së borxheve të këqija. Rritja e kostove operative vjen edhe për shkak të rritjes së aktiviteteve të ekipeve të mirëmbajtjes, e veçanërisht atyre të kontrollit edhe jashtë orarit të punës, gjithmonë në synim të evidentimit dhe eliminimit të keqpërdorimeve të ujit të pijes.

Vërehet qartë se humbja financiare është zvogëluar për 150 mijë euro, sikurse është rritur numri i konsumatorëve për 2400 konsumatorë të rinj.

#### Auditori i Jashtëm

Auditimi i Jashtëm i Pasqyrave Financiare 2012 për KRU Hidroregjionin Jugor sh.a. është bërë nga kompania audituese “Kanuni i Auditorit Istog”. Kjo kompani audituese, pas auditimit të pasqyrave financiare, ka dhënë një opinion të kualifikuar për kompaninë. Sipas tyre, pasqyrat financiare të kompanisë paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të kompanisë me 31 Dhjetor 2012 dhe performancën e saj financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë së saj për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

#### Funksionimi i Qeverisjes Korporative - Bordi i Drejtorëve

Bordi i Drejtorëve ka mbajtur takime të shumta gjatë vitit 2012, (10 takime), ku kanë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndryshme të ndërmarrjes, ndërsa Komisioni i Auditimit ka mbajtur 7 mbledhje pune. Njësisia ka përcjellë punën e bordit dhe ka konstatuar se bordi ka qenë në nivel të përgjegjësive dhe ka pasur efekt pozitiv në performancën e kompanisë. Duke u bazuar në nevojat që kjo ndërmarrje ka paraqitur, Bordi i Drejtorëve ka formuar dhe disa komisione të tjera, të cilat kanë pasur aktivitete që vlen për t’u theksuar. Këto komisione janë: Komiteti për Hulumtime dhe Teknologji, Komiteti për Financa, dhe Komiteti për Staf dhe Shpërblime, andaj NJPMNP ka bërë vlerësimin e efektshmërisë së punës së bordit dhe e ka publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

#### Përmbushja e kërkesave ligjore


Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të KRU ‘Hidroregjionit Jugor’.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë për vitin 2012, me përmbajtje të detajuar, duke i identifikuar synimet, si dhe treguesit kyç që do arrijnë të realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raportet tremujore janë shqyrtuar paraprakisht nga komisioni i auditimit dhe janë aprovuar me kohë nga Bordi i Drejtorëve.

Raporti Vjetor 2012 është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë. Ky raport ka përdorur formën narrative dhe tabelat sipas udhëzuesit që ua ka dërguar NJPMNP, për t'i paraqitur të dhënat operative dhe financiare.

#### 4.12 Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtina sh.a.

	<p><b>Misioni</b> Konsumatori është në qendër të vëmendjes, që do të ketë trajtim dhe qasje të barabartë në shërbim: Pa diskriminim racor, religjioz, kombëtar dhe gjinor. Duke përmbushur këtë “mision” do të bëhet i mundur sigurimi i vetqëndrushmërisë me qëllimin e fundit që të sigurojë shërbime cilësore të ujit të pijshëm në pajtim me standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.</p> <p><b>Vizioni</b> Krijimi i shërbimeve sa më cilësore dhe të pandërprera të furnizimit me ujë të pijshëm dhe shërbime të kanalizimit, me çmime sa më të favorshme dhe më ujë cilësor dhe të shëndetshëm për popullatën, si dhe rritjen e vlerës së aseteve publike si pronë e shtetit të Kosovës.</p>
---	---

Profili i ndërmarrjes	
Emri i Kompanisë	KRU. Prishtina sh.a.
Numri i Regjistrimit	70433736
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Kryesuesi i Bordit	Ejup Hashani
Kryeshefi Ekzekutiv	Gjelosh Vataj
Auditor i Jashtëm	AUDIT&CONTO

#### Fushë - veprimtaria

Kompania e Ujësjellësit Rajonal “Prishtina”, është ndërmarrja më e madhe e ujit të pijshëm në Kosovë ku shërbimet e veta i ofron në pjesën qendrore të Kosovës, duke i përfshirë këto komuna: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Shtime, Lipjan, Drenas, Podujevë dhe Graçanicë.

Numri i popullatës së shërbyer në zonën që operon KUR “Prishtina” sh.a. vlerësohet rreth 450.000 banorë. Kapaciteti momental prodhues (i mundshëm nën supozimin e ekzistimit të rezervave të mjaftueshme të burimeve të ujit në liqenet akumuluese) sillet rreth  $Q=1400$  l/s ose minimalisht 43.000.000 deri 45.000.000 m<sup>3</sup> në vit.

KUR “Prishtina” sh.a. i posedon dy fabrika për trajtimin e ujit të alokuara në Albanik dhe në Badovc. Në këto fabrika uji fillestar merret nga liqenet artificiale akumuluese; Batllavë dhe Badovc.

#### Objektivat e së ardhmes

Në fokus të angazhimeve të KRU. Prishtinës për vitet në vijim do të jetë:

- Rritja e shkallës së arkëtimit në total dhe atë: në vitin 2013 përafërsisht në shkallën mesatare 78%, në vitin 2014 në shkallën mesatare rreth 79%, në vitin 2015 në shkallën mesatare rreth 80%, për të arritur në shkallën optimale mesatare rreth 84% në fund të vitit 2016.
- Humbjet teknike dhe komerciale të ujit, përkatësisht uji i pafaturuar do të ketë tendencë të rënies në këto shkallë: 47% në vitin 2013, 44% në vitin 2014, 41% në vitin 2015 dhe në vitin 2016 përafërsisht humbjet teknike do të sillen rreth 38%.
- Brenda periudhës 2012-2016 do të bëhet projeksioni i bilancit të ujit të pijes dhe ujërave të ndotura, si dhe fillimi i zbatimit të Planit Strategjik Zhvillimor Afatgjatë 2015-2040 për regjionin që mbulon KUR “Prishtina” sh.a. Përpilimi i këtyre dy dokumenteve shumë të rëndësishme do të bëhet në bazë të partneritetit të vazhdueshëm me konsulencën që ka zgjedhur Banka Gjermane për Zhvillim.
- Në bashkëpunim me ministrinë dhe komunat do të arrihet edhe forcimi i aktiviteteve për mbrojtjen e burimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore që shfrytëzohen si burime të ujit të

pijes nga KUR "Prishtina" sh.a. marrë për bazë edhe rezultatet e arritura në periudhën paraqite.

### **Sfidat e së ardhmes**

Sfidat e së ardhmes për Bordin dhe Menaxhmentin e kompanisë janë:

- Borxhet e larta të konsumatorëve, të cilat vazhdojnë të rriten prej vitit në vit, borxhet më të larta të evidentuara deri në fundin e vitit 2012, janë ato të rasteve sociale dhe komuniteteve pakicë.
- Humbjet e ujit janë sfida e madhe për kompaninë, këto humbje janë teknike dhe komerciale. Ka pasur indikacione se humbjet teknike janë më të larta se ato komerciale. Kur është fjala për humbjet komerciale ato është shumë më lehtë të zbulohen dhe të zvoglohen. Kurse, humbjet teknike dëshirojnë një trajtim tjetër, sepse për këtë duhen investime, të cilat nuk varen edhe shumë nga kompania, por nga Komuna, Qeveria dhe donatorët. Ajo që është në kompetencë të kompanisë po bëhet në vazhdimësi dhe rezultati nga kjo është zvoglimi i humbjeve në shkallën 1%, pozitive në secilin vit që pason.

### **Ngjarjet kryesore - 2012**

Ngjarjet kryesore për vitin raportues mund të paraqiten në disa pika:

- Përpjekjet e vazhdueshme drejt rritjes e shkallës së faturimit;
- Sigurimi i financimit të fabrikës së re në Shkabaj përmes KfW, KE, Qeverisë dhe komunës së Prishtinës;
- Rritja e shkallës së inkasimit;
- Zvoglimi radikal i faturimit paushall;
- Shqyrtimi i ankesave të konsumatorëve dhe përgjigjja me shkrim;
- Eliminimi i faturimit fiktiv, ose zvoglimi në shkallë minimale të këtij lloji faturimi;
- Zbatimi i ligjeve dhe standardeve minimale të shërbimeve konform ZRRUK;
- Zvogëlimi në maksimum i punëve jashtë orarit dhe pagesës së kësaj pune;
- Investimet në infrastrukturë dhe rehabilitim të rrjetit të ujit dhe kanalizimit;
- Aplikimi i programeve softuerike për kontabilitet dhe GIS;
- Zbatimi i Planit të investimeve vetanake dhe atyre nga kreditë;
- Reduktimi i humbjeve dhe strategjia e zvoglimit të humbjeve të ujit.

### **Investimet dhe Projektet- 2012**

Projektet e Implementuara 2012 për KRU. Prishtina sh.a. janë:

- Fabrika e ujit në Shkabaj, si bashkëfinancim mes KfW, KE, Qeverisë së Kosovës dhe Komunës së Prishtinës (në fazën fillestare);
- Investimet në ndërrimin e gypave të ujit me diametër 1000mm, financuar nga Komisioni Evropian janë në vlerë prej: 1,518,749.93€;
- Rehabilitimi i sistemit, investime në rrjetin e ri në fshatra, zëvendësimi i gypit transmetues në Drenas dhe fshatra të Komunës në vlerë prej: 1,038,736.00 €
- Rehabilitim i sistemit të ujit në Lipjan, ndërtimi i sistemit të ri të ujit në fshatrat e Lipjanit dhe ndërrim i gypave transmetues në vlerë prej: 1,841,914.00 €.
- Ndërrimi i rrjetit të gypave të ujës-jellësit në Prishtinë, projekt i financuar nga KfW;
- Studimi i fizibilitetit për burime të reja për regjionin e Prishtinës, financuar nga Komisioni Evropian.

**Indikatorët operativë – krahasimi me vitin paraprak**

Indikatorët operativë	2012	2011
Prodhimi i ujit në (000)m <sup>3</sup>	45,064	45,940
Faturimi i ujit (%)	47	46
Inkasimi i ujit (%)	75	70
Uji i pafaturuar (%)	53	54
Testet e dështuara të ujit (%)	2.2	1.9
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	96	84
Numri i konsumatorëve	106,945	99,216

*Tabela 27. Performanca Operative e KRU Prishtina*

Nga tabela shihen treguesit progresivë në krahasim me vitin paraprak tek prodhimi i ujit, faturimi i ujit, humbja e ujit dhe tek rritja e numrit të konsumatorëve. Ndërsa, tek kualiteti i ujit kemi një rënie, por prapë mund të themi që është në kuadër të limiteve të lejueshme për testet e dështuara të ujit, e cila është deri në 3%.

**Indikatorët financiarë – krahasimi me vitin paraprak**

	2012 (000€)	2011 (000€)
<b>Të hyrat</b>	13,514	12,941
<b>Shpenzimet</b>	(8,055)	(7,661)
<b>Fitimi/Humbja operative</b>	5,459	5,280
<b>Zhvlerësimi dhe amortizimi</b>	(3,574)	(3,960)
<b>Borxhet e këqija</b>	(1,712)	(1,644)
<b>Fitimi/Humbja financiare</b>	173	(324)
<b>Paraja në fund të vitit</b>	1,732	1,614
<b>Asetet fikse</b>	55,984	54,546

*Tabela 28. Performanca Financiare e KRU Prishtina*

Nëse e analizojmë nivelin e treguesve kryesor të performancës financiare për vitin 2012, krahasuar me vitin 2011, vërehet se kemi përmirsim dhe ndryshime pozitive gati të të gjithë treguesve. Të hyrat operative janë rritë afërsisht për 4% në krahasim me vitin e kaluar. Rezultati financiar në fund të vitit për

KRU “Prishtina” sh.a. është rezultat financiar pozitiv apo fitim, ky është një tregues i rendësishëm dhe vlerësohet nga palët e interesit dhe Aksionari i kompanisë, që është Qeveria e Republikës së Kosovës.

**Auditimi i Jashtëm**

Auditimi i Jashtëm i pasqyrave financiare 2012 për KRU. Prishtina sh.a. është bërë nga kompania audituese AUDIT & CONTO. Kjo kompani audituese pas auditimit të pasqyrave financiare ka dhënë një opinion të kualifikuar me theksim të çështjeve për kompaninë. Sipas tyre, pasqyrat financiare të kompanisë paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të kompanisë me 31 Dhjetor 2012 dhe performancën e saj financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë së saj për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

**Funksionimi i Qeverisjes Korporative - Bordi i Drejtorëve**

Bordi i Drejtorëve ka mbajtur takime të shumta gjatë vitit 2012, (10 takime), ku kanë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndryshme të ndërmarrjes. Pothuajse para çdo mbledhjeje të Bordit janë mbajtur dhe mbledhje të Komisionit të Auditimit, përkatësisht 10 mbledhje.



Duke u bazuar në nevojat që kjo ndërmarrje ka paraqitur, Bordi i Drejtorëve ka formuar edhe disa komisione të tjera, të cilat nuk kanë pasur ndonjë aktivitet që vlen për t'u theksuar. Këto komisione janë: Komisioni për Investime Kapitale; Komisioni për Financa; Komisioni për Staf dhe Shpërblime; Komisioni për Hulumtime dhe Teknologji; dhe Komisioni për Menaxhimin e Rrezikut. NJPMNP disa herë me shkrim ka kërkuar rishikimin e këtyre komiteteve joefektive dhe të përkohshme, por për këtë asnjëherë në 2012 nuk ka pranuar përgjigje.

Njësia ka përcjellë punën e bordit dhe ka bërë vlerësim e efektshmërisë së tij. Për këtë shih vlerësimin e NJPMNP të publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

### **Përmbushja e kërkesave ligjore**

Raportet tremujore, vjetore dhe Plani i Biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të KRU 'Prishtina'.


Plani i Biznesit është përgatitur me kohë dhe ka paraqitur nivelin korporativ gjatë 2012. Aty janë identifikuar synimet, si dhe treguesit kyç që do arrijnë t'i realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raportet tremujore janë shqyrtuar paraprakisht nga komisioni i auditimit dhe janë aprovuar me kohë nga bordi i drejtorëve. Menaxhmenti ka përfshirë elemente të ndryshme në përpilimin e këtyre raporteve, siç janë: strukturën organizative, aktivitetet e ndryshme, projektet e përfunduara, ose të pezulluara, performancën financiare dhe operative, duke e krahasuar me tremujorin përkatës të vitit të kaluar.

Raporti Vjetor 2012 është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë. Ky raport ka përdorur formën narrative dhe tabelat sipas udhëzuesit që ka dërguar NJPMNP, për të paraqitur të dhënat operative dhe financiare.



#### 4.13 Kompania Rajonale e Ujësjetllësit Mitrovica sh.a.

	<p><b>Misioni</b>          Konsumatori është në qendër të vëmendjes, që do të ketë trajtim dhe qasje të barabartë në shërbim: Pa diskriminim racor, religjioz, kombëtar dhe gjinor. Duke përmbushur këtë “mision” do të bëhet i mundur sigurimi i vetqëndrueshmërisë me qëllimin e fundit që të sigurojë shërbime cilësore të ujit të pijshëm në pajtim me standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.</p> <p><b>Vizioni</b>          Krijimi i shërbimeve sa më cilësore dhe të pandërprera të furnizimit me ujë të pijshëm dhe shërbime të kanalizimit në Regjionin e Mitrovicës, me çmime sa më të favorshme dhe me ujë cilësorë dhe të shëndetshëm për popullatën, si dhe rritjen e vlerës së aseteve publike si pronë e shtetit të Kosovës</p>
---	--

Profili i ndërmarrjes	
Emri i Kompanisë	KRU. Mitrovica sh.a.
Numri i Regjistrimit	70433740
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Kryesuesi i Bordit	Fehmi Kajtazi
Kryeshefi Ekzekutiv	Faruk Hajrizi
Auditor i Jashtëm	Audit & Conto

#### Fushë - veprimtaria

Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Mitrovica” sh.a. ofron shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe mirëmbajtjen e kanalizimeve të ujërave të zeza në pjesën veriore të Kosovës dhe mbulon këto komuna: Mitrovicën, Vushtrrinë, Skënderaj dhe Mitrovicën matanë lumit Ibër. Popullata e shërbyer vlerësohet të jetë rreth 300.000 banorë.

KRU “Mitrovica” operon me impiantin për trajtimin e ujit të pijshëm në periferi të qytetit, me kapacitet prodhues rreth 520 l/s, ndërsa nga viti 2011 ka në funksionim edhe impiantin e parë të kapacitetit të madh për trajtimin e ujërave të zeza në Skënderaj.

Afro 39% nga uji i prodhuar distribuohet matanë Ibrit, pa u inkasuar nga shfrytëzuesit, por që Qeveria e Kosovës e mbulon me subvencione në % të mesatares së inkasuar në regjion.

#### Objektivat e së ardhmes

Në fokus të angazhimeve të KRU. Mitrovica për vitet në vijim do të jenë:

- Rritjen e kontinuitetit të furnizimit me ujë të pijshëm në 24 orë;
- Zvogëlimin e sasisë së ujit të pafaturuar në 45%;
- Rritjen e propocionit të konsumatorëve me ujëmatësa në 95%;
- Rritjen e shkallës së arkëtimit;
- Zvogëlimin e shpenzimeve për njësi prodhimi
- Ngritjen e normës së mbulesës së punës në rritjen e efikasitetit të punës së stafit.

#### Sfidat e së ardhmes

Sfidat e së ardhmes për Bordin dhe Menaxhmentin e kompanisë janë:

- Ruajtja dhe monitorimi i cilësisë së ujit të pijes;
- Furnizim i rregullt i konsumatorëve me ujë 24 orë;
- Përmbushja e objektivave financiare të kompanisë, siç janë rritja e faturimit, inkasimit, zvogëlimi i ujit të pafaturuar etj.;

- Sfidë tjetër e kompanisë janë edhe vendbanimet e minoriteteve.

Kompania ka bërë përpjekje të vazhdueshme që të nisë arkëtimin në pjesë të caktuar të këtyre konsumatorëve, duke kërkuar ndihmë nga strukturat komunale dhe ato Qeveritare. Borxhi i pjesës veriore ndaj KRU. Mitrovica është shumë i madh, i cili po ndikon dukshëm në afarizmin e suksesshëm të kësaj kompanie.

### Ngjarjet kryesore - 2012

Ngjarjet kryesore për vitin 2012 mund të paraqiten në disa pika:

- Vazhdimi i punëve në ndërtimin e fabrikës së re për trajtimin e ujit në Shipol të Mitrovicës, me kapacitet prej 700 l/s, donacion i Komisionit Evropjan;
- Ndërtimi i fabrikës për trajtimin e ujit në Vushtrri me kapacitet prej 350 l/s, donacion nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që në një të ardhme shumë të afërt do të plotësohen të gjitha nevojat për ujë të pijshëm në regjion;
- Ka vazhduar implementimi i projektit për zvogëlimin e humbjeve që financohet nga Qeveria e Luksemburgut.

### Investimet dhe Projektet – 2012

Investimet dhe Projektet për KRU. Mitrovica gjatë vitin 2012 kanë qenë:

- Rritja e kapaciteteve përpunuese të ujit në Shipol të Mitrovicë, i cili financohet nga Komisioni Evropjan;
- Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe zvogëlimi i humbjeve të ujit të financuar nga Qeveria e Luksemburgut. Aktualisht kompania “SETEC” ka bërë finalizimin e projekteve për fazën e parë, shumica e punëve janë në përfundim e sipër, ndërsa projektet e fazës së dytë do të implementohen gjatë viti 2013.

### Indikatorët operativë – krahasimi me vitin paraprak

Indikatorët operativë	2012	2011
Prodhimi i ujit në (000) m <sup>3</sup>	17,610	17,770
Faturimi i ujit (%)	48	48
Inkasimi i ujit (%)	50	57
Uji i pafaturuar (%)	52	52
Testet e dështuara të ujit (%)	3	4.3
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	57	51
Numri i konsumatorëve	26,095	24,972

**Tabela 29. Performanca Operative e KRU Mitrovica**

Tabela tregon se në vitin, 2012 krahasuar me 2011, KRU ‘Mitrovica’, sh.a., ka treguar performancë pothuajse të njëjtë, për sa i përket progresit dhe regresit në treguesit kyç.

Ndryshimi në sasinë e prodhuar të ujit ka ardhur si pasojë e intensifikimit të prodhimit dhe mospengesave gjatë procesit të prodhimit dhe shtrirjes së rrjetit të ri të ujësjellësit.

Shkalla e inkasimit gjatë vitit 2012 ka shënuar rënie për 7%, krahasuar me vitin 2011, përderisa faturimi pothuajse ka mbetur në pozitën e njëjtë.

Uji i pafaturuar në vitin 2012 nuk ka pasur ndryshime në krahasim me vitin paraprak 2011, d.m.th ka mbetur në kuotën e njëjtë prej 52%.

Kualiteti i ujit të pijes gjatë vitit 2012, në krahasim me 2011, i cili është furnizuar nga KRU ‘Mitrovica’ lë vend për përmirësim, sidomos tek njësitë operative të Vushtrrisë dhe Skenderajt.

Shikuar në tërësi, pikat më të dobëta të operimit janë: niveli shumë i ulët i inkasimit vetëm 50%, apo për 20% nën mesataren e sektorit, apo 7% më pak se viti paraprak, si dhe % shumë e vogël e konsumatorëve me ujëmatës.

**Indikatorët financiarë– krahasimi me vitin paraprak**

	<b>2012 (000€)</b>	<b>2011 (000€)</b>
<b>Të hyrat</b>	3,875	3,775
<b>Shpenzimet</b>	(2,069)	(1,874)
<b>Fitimi/Humbja operative</b>	1,806	1,901
<b>Zhvlerësimi dhe amortizimi</b>	(1,213)	(1,839)
<b>Borxhet e këqija</b>	0	0
<b>Fitimi/Humbja financiare</b>	593	62
<b>Paraja në fund të vitit</b>	32	43
<b>Asetet fikse</b>	18,597	19,782

*Tabela 30. Performanca Financiare e KRU Mitrovica*

Fitimi financiar për vitin 2012 është 593 mijë euro, ky fitim ka ardhur si rezultat i marrjes së subvencioneve nga Qeveria në vlerë prej: 691,152.66 €. Kjo pjesë e mjeteve që është ndarë nga Qeveria e Republikës së Kosovës është destinuar për mbulimin e faturave të papaguara nga komuniteti minoritar në pjesën veriore. Edhe zhvlerësimi i aseteve ka ndikuar që asetet fikse në vitin 2012 të jenë më të vogla se sa në të njëjten periudhë të vitit paraprak 2011.

**Auditimi i Jashtëm**

Auditimi i Jashtëm i Pasqyrave Financiare 2012 për KRU. Mitrovica sh.a. është bërë nga kompania audituese AUDIT&CONTO. Kjo kompani, pas auditimit të pasqyrave financiare, ka dhënë një opinion të kualifikuar për kompaninë e Mitrovicës. Sipas tyre, pasqyrat financiare të kompanisë paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të kompanisë me 31 Dhjetor 2012 dhe performancën e saj financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë së saj për vitin që ka përfunduar, në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

**Funksionimi i Qeverisjes Korporative - Bordi i Drejtorëve**

Bordi i Drejtorëve ka mbajtur takime të shumta gjatë viti 2012, (12 takime), ku kanë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndryshme të ndërmarrjes, ndërsa Komisioni i Auditimit ka mbajtur 10 mbledhje pune. Duke u bazuar në nevojat që kjo ndërmarrje ka paraqitur, Bordi i Drejtorëve ka formuar dhe disa komisione të tjera, të cilat nuk kanë pasur ndonjë aktivitet që vlen për t'u theksuar. Këto komisione janë: Komisioni për Kontrollin e Rrjetit dhe Zvogëlimit të Humbjeve Teknike dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Distribuimit të Ujit.

Njësia ka përcjellë punën e bordit dhe ka konstatuar se bordi është njoftuar për shumë çështje të ndryshme që janë paraqitur në raportet e Auditorit të Jashtëm dhe nuk ka pasur ndonjë vendimmarrje energjike. Andaj, edhe Njësia ka bërë vlerësim e efektshmërisë së punës së tij dhe e ka publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

**Përmbushja e kërkesave ligjore**


Raportet tremujore, vjetore dhe plani i biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të KRU 'Mitrovica'.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë për vitin 2012, por nuk ka ndonjë përmbajtje të detajuar, pa identifikuar synimet, si dhe treguesit kyç që do arrijnë ta realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raportet tremujore janë shqyrtuar paraprakisht nga komisioni i auditimit dhe janë aprovuar me kohë nga Bordi i Drejtorëve.

Raporti Vjetor 2012 është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë. Ky raport ka përdorur formën narrative dhe tabelat, sipas udhëzuesit që ua ka dërguar NJPMNP, për t'i paraqitur të dhënat operative dhe financiare.

#### 4.14 Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër - Lepenc sh.a.

	<p><b>Misioni</b> Të ofrojë shërbime të furnizimit të bujqësisë dhe industrisë me ujë, me qëllim të mundësisë së operimit të termocentraleve, shkritoreve, ujësjellësve, ujitjes së tokave, si dhe shfrytëzimi i resurseve akumuluese ujore për gjëllim gjenerimi me energji elektrike.</p> <p><b>Vizioni</b> Sigurimi i shërbimeve cilësore të furnizimit me ujë industrial, shërbime të ujitjes së kulturave bujqësore dhe gjenerim të energjisë përmes Hydrocentralit të Ujmanit për konsumatorët e saj, si dhe rritja e vlerës së aseteve publike të Hidrosistemit Ibër-Lepenc, si pasuri publike e shtetit të Kosovës.</p>
---	---

Profili i ndërmarrjes	
Emri i Kompanisë	NH. Ibër - Lepenc sh.a.
Numri i Regjistrimit	70465157
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Kryesuesi i Bordit	Nazmi Zenelaj
Kryeshefi Ekzekutiv	Hajdar Beqa
Auditor i Jashtëm	BDO Kosova L.L.C.

#### Fushë - veprimtaria

Është ndërmarrje publike ekonomike, e cila merret me shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e sistemit shumë funksional për furnizim me ujë. Kjo kompani ka dy njësi punuese:

- Njësia afariste “Uji dhe centrali elektrik”;
- Njësia afariste “Ujitja”.

Infrastruktura e ndërmarrjes shtrihet në pjesën veriore dhe qendrore të Kosovës në këto komuna: Zubin Potok, Mitrovicë, Vushtrri, Kastriot, Fushë Kosovë, Prishtinë dhe Drenas.

HS “Ibër-Lepenc” sh.a. është shoqëri aksionare dhe si ndërmarrje publike hidroekonomike merret me shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e sistemit shumë funksional për furnizim me ujë industrial, ujitjen e tokave bujqësore, si dhe gjenerimin e energjisë elektrike.

Penda në Ujman – mundëson akumulimin e 375 milionë m<sup>3</sup> ujë, sasia e të cilit përdoret për:

- Prodhimin e energjisë elektrike në HC Ujman 2 x 17.5 MW - 82GWh/vit;
- Furnizimin e industrisë me ujë të papërpunuar:
  - KEK-u;
  - Ferronikeli.
- Furnizimin e ujësjellësve regionalë me ujë të papërpunuar:
  - Ujësijellësi regjional i Mitrovicës;
  - Ujësijellësi regjional i Prishtinës (për Drenas).
- Furnizimin e bujqësisë me ujë për ujitje.

Infrastruktura e kësaj ndërmarrjeje:

Objektet e ndërmarrjes shtrihen në territoret e 8 komunave dhe atë: Zubin Potok, Mitrovicë, Vushtrri, Obiliq, Prishtinë, Fushë Kosovë, Drenas dhe Graçanicë.

Penda Ujman me lartësinë h=107.5 m

Akumulimi Ujman 375 milionë m<sup>3</sup>

Hidrocentrali Ujman 2 x 17.5 MW

Penda Pridvoricë me lartësinë h=10 m

Akumulimi Pridvoricë 480,000 m<sup>3</sup>  
Kanale kryesore 146 km  
Kanali kryesor "Pridvoricë – Obiliq" 50 km kapaciteti 22.2 m<sup>3</sup>/sec.  
Stacione Pompake për ujitje 14  
Objekte Ndarëse 4  
Rrjeti nëntokësor për ujitje 766 km  
Rreth 120 km largpërçues.

### **Objektivat e së ardhmes**

Objektivi dhe synimi i ndërmarrjes është mirëmbajtja dhe operimi i infrastrukturës ekzistuese, modernizimi i sistemit, rehabilitimi dhe zgjerimi i kapaciteteve. Qëllimi i kompanisë është edhe rritja e vlerës së aseteve, maksimalizimi i të hyrave me një shfrytëzim sa më efikas të aseteve dhe zgjerimi i shërbimeve të ujitjes së tokave bujqësore.

Objektiva shtesë në të ardhmen për furnizim me ujë industrial nga Penda e UJMAN-it, priten nga:

- KEK – TC "Kosova B+" 380 l/sec plus 380 l/sec;
- Zgjerimi i KUR "Prishtina" fabrika në Shkabaj (dy faza) 700+500 l/sec;
- Zgjerimi i KUR "Mitrovica" me 700 l/sec;
- Ujësjiellësi i ri në Vushtrri me 350 l/sec;
- Zgjerimi i sipërfaqeve për ujitje.

### **Sfidat e së ardhmes**

Sfidat për të ardhmen e HS "Ibër-Lepenc" janë:

- Situata hidrologjike, kushtet klimatike të pafavorshme (mungesa e të reshurave dhe thatësia e gjatë);
- Kyçjet ilegale të fermerëve në sistemin e ujitjes;
- Zvogëlimi i humbjeve nga kyçjet ilegale;
- Dëmtimi i gypave të fazonerisë gjatë ndërtimit të rrugëve magjistrale;
- Derdhja e ujërave të zeza në kanalet e ujitjes;
- Ndërtimet mbi sistemin e ujitjes.

### **Ngjarjet kryesore - 2012**

Ngjarje më rëndësi gjatë vitit 2012 është realizimi i disa projekteve për investime kapitale me rëndësi të veçantë:

- Rehabilitimin e kanalit kryesor;
- Zgjerimin dhe aftësimin e rrjetit së ujitjes, të cilat përveç se kanë rritur vlerën e aseteve të ndërmarrjes, kanë ndikuar në efektshmërinë e furnizimit me ujë si në sasi, ashtu edhe në cilësi, duke zvogëluar edhe humbjet e ujitjes në kanal kryesor.

### **Investimet dhe Projektet- 2012**

Gjatë vitit 2012, Njësia Afariste "Ujitja" ka investuar në realizimin e këtyre projekteve:

- Rindërtimi i kanalit Besi-Graqankë;
- Rehabilitimi i kanalit të hapur nga dalja e sifonit Rudinë deri në SP Gllobar;
- Rehabilitimi i kanalit të hapur Hamidi – Drenicë: Segmenti 1. dhe 2.;
- Rehabilitimi i kanalit të hapur O.N Vasilevë – hyrja e Sifonit Korroticë – 2020 m;
- Rehabilitimi i kanalit të hapur sifoni Poklek – hyrja e Sifonit Rudinë – 710 m;
- Rehabilitimi i nevojshëm i rrjetit të ujitjes në fushën e Pantinës (gypa dhe fazoneri);
- Rehabilitimi i objektit në N.J.P. në Shkabaj, së bashku me objektin e rojës, pusi me hidrofor, dhe ndriçimi i oborrit, ndërtimi i parkingut për automjetet e punëtorëve;
- Rindërtimi i kanalit kryesor Pridvoricë – Obiliq (lot 1 dhe lot 2);
- Asfaltimi i oborrit në Njësine Punuese në Komoran;
- Ndërtimi i 60 pusëve në Njësine Punuese në Komoran dhe Shkabaj;
- Mirëmbajtja e sistemit të ujitjes.

**Indikatorët operativë – krahasimi me vitin paraprak**

Indikatorët operativë	2012	2011
Uji i furnizuar (m <sup>3</sup> )	37,374	34,973
Ujitja e tokave bujqësore (ha)	1,860	1,647
Energjia e prodhuar dhe e shitur (MWh)	65,784	75,432

*Tabela 31. Performanca Operative e NH Ibër-Lepenc*

Tabela tregon se ka rënie të gjenerimit të energjisë, pasi gjenerimi i energjisë elektrike në masë të madhe është i kushtëzuar nga kushtet hidrologjike, niveli i akumulimit në liqen, si dhe nga kërkesat e KEK-ut. Nisur nga kjo, gjenerimi i energjisë elektrike në vitin 2012 ka qene më i ulët për 9,648 MWh. Furnizimi me ujë industrial është kryesisht i ndikuar nga kërkesat e klientëve për sasinë e ujit dhe ka një rritje prej afro 6% nga viti paraprak.

Megjithëse, ndërmarrja çdo vit e shton numrin e sasive të sipërfaqeve që mund të ujitën, ujitja varet kryesisht nga interesimi i fermerëve për ujitje të tokave bujqësore dhe kështu është rritur sipërfaqja e tokës bujqësore të ujitura në vitin 2012 për 213 ha në krahasim me vitin paraprak.

**Indikatorët financiarë– krahasimi me vitin paraprak**

	2012 (000€)	2011 (000€)
<b>Të hyrat</b>	3,808	3,810
<b>Shpenzimet</b>	(3,387)	(3,251)
<b>Fitimi/Humbja operative</b>	421	559
<b>Zhvlerësimi dhe amortizimi</b>	(4,591)	(4,549)
<b>Borxhet e këqija</b>	0	0
<b>Fitimi/Humbja financiare</b>	(4,170)	(3,990)
<b>Paraja në fund të vitit</b>	546	1,962
<b>Asetet fikse</b>	137,973	141,902

*Tabela 32. Performanca Financiare e NH Ibër-Lepenc*

Gjithashtu, nga tabela shihet se për shkak të kushteve hidrologjike dhe kërkesave të KEK-ut, në vitin 2012 janë realizuar të hyra të njëjta në krahasim me vitin paraprak 2011, ndërsa kjo kompani për shkak të vlerës së aseteve, ka edhe shpenzime të mëdha të zhvlerësimit dhe përfundimisht del në humbje financiare. Edhe paraja në fund të vitit 2012 është më e vogël sesa në vitin paraprak 2011, për arsye se kompania ka depozituar në një nga bankat komerciale rreth 1,000.000 € me qëllim që nga ky depozitim të nxjerrë interes. NH. Ibër-Lepenc është kompani financiarisht e qëndrueshme që nuk subvencionohet nga shteti dhe është në fitim operativ, tregues ky që na bën me dije se nuk vjen në pikëpyetje vazhdimësia e funksionimit dhe krijimit të shërbimeve publike.

**Auditimi i Jashtëm**

Auditimi i Jashtëm i Pasqyrave Financiare 2012 për NH. Ibër-Lepenc sh.a. është bërë nga kompania audituese “BDO Kosova L.L.C.”. Kjo kompani audituese, pas auditimit të pasqyrave financiare, ka dhënë një opinion të pakualifikuar për kompaninë. Sipas tyre, pasqyrat financiare të kompanisë paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të kompanisë me 31 Dhjetor 2012 dhe performancën e saj financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë së saj për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.



## **Funksionimi i Qeverisjes Korporative - Bordi i Drejtorëve**

Bordi i Drejtorëve ka mbajtur takime të shumta gjatë vitit 2012, (12 takime), ku kanë diskutuar dhe aprovuar çështje me rëndësi të aktiviteteve të ndryshme të ndërmarrjes. Pothuajse, para çdo mbledhje të Bordit janë mbajtur dhe mbledhje të Komisionit të Auditimit, përkatësisht 12 mbledhje. Duke u bazuar në nevojat që kjo ndërmarrje ka paraqitur, Bordi i Drejtorëve ka formuar dhe disa komisione të tjera, të cilat kanë mbajtur mbledhje sa herë që është parë e nevojshme. Këto komisione janë: Komisioni për Financa, Komisioni për Hulumtime, Zhvillime dhe Investime, Komisioni për Staf dhe Shpërblime, Komisioni për Menaxhim Risku, Komisioni për Bashkëpunim me KEK-un, dhe Komisioni për Investime Kapitale dhe të Ardhura.

NJPMNP disa herë me shkrim ka kërkuar rishikimin e këtyre komiteteve joefektive, të përkohshme, por për këtë asnjëherë në 2012 nuk ka pranuar përgjigje.

Njësia ka përcjellë punën e bordit dhe ka bërë vlerësimin e efektshmërisë së punës së tij, i cili është publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

## **Përmbushja e kërkesave ligjore**

Raportet tremujore, vjetore dhe Plani i Biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të Ibër-Lepencit.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë dhe ka paraqitur nivelin korporativ gjatë 2012. Aty janë identifikuar synimet, si dhe treguesit kyç që do arrijnë ta realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raportet tremujore janë shqyrtuar paraprakisht nga Komisioni i Auditimit dhe janë aprovuar me kohë nga Bordi i Drejtorëve. Menaxhmenti ka përfshirë elemente të ndryshme në përpilimin e këtyre raporteve, siç janë: strukturën organizative, aktivitetet e ndryshme, projektet e përfunduara, ose të pezulluara, performancën financiare dhe operative, duke e krahasuar me tremujorin përkatës të vitit të kaluar.

Raporti Vjetor 2012 është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë. Ky raport ka përdorur formën narrative dhe tabelat, sipas udhëzuesit që ua ka dërguar NJPMNP, për t'i paraqitur të dhënat operative dhe financiare.

#### 4.15 Kompania e Ujitjes RADONIQI – DUKAGJINI, Sh. A.



##### **Misioni i RADONIQI – DUKAGJINI –it ka të bëjë:**

Të ofrojë shërbime të furnizimit me ujë, me qëllim të mundësisë së ujitjes së tokave, si dhe shfrytëzimi i resurseve akumuluese ujore me qëllim të shtimit të prodhimit të bujqësore; përmes kultivimit të kulturave intensive me produktivitet të lartë bujqësor.

##### **Vizioni është:**

Sigurimi i shërbimeve cilësore të ujitjes së kulturave bujqësore, si dhe rritja e vlerës së aseteve publike të Kompanisë së Ujitjes Radoniqi – Dukagjini, si pasuri publike e shtetit të Kosovës.

#### **Profili i ndërmarrjes**

Emri i Kompanisë	KU Radoniqi - Dukagjini, Sh. A.
Numri i Regjistrimit	70465161
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Kryesuesi i Bordit	Canë Delija
Kryeshefi Ekzekutiv	Jahja Kadriu
Auditor i Jashtëm	Audit & Conto

#### **Fushë - veprimtaria**

KU “Radoniqi – Dukagjini”, sh.a- Gjakovë, është ndërmarrje publike qendrore, ku aksionar i vetëm i kësaj kompanie është Republika e Kosovës me 100% të aksioneve.

Kjo kompani është e vendosur në Gjakovë dhe ka tri njësi punuese, të vendosura në fshatin Lugbunar (komuna e Gjakovës), në Xërxë (komuna e Rahovecit) dhe në Prizren.

Sistemi i ujitjes që posedon kjo kompani është i shtrirë në pjesën më pjellore të rrafshit të Dukagjinit. KRU “Radoniqi – Dukagjini” sh.a, është përgjegjëse për ujitjen e tokave bujqësore (si aktivitet primar), në komunat e Gjakovës, Rahovecit dhe të Prizrenit. Sasitë e planifikuara të ujit për sezonin e ujitjes varen nga sipërfaqet të cilat janë ujitur, llojin e kulturave, numrin e ujitjes, reshjeve, të cilat kanë dominuar gjatë sezonit vegjetativ.

#### **Objektivat e së ardhmes**

Objektivat e së ardhmes janë:

- Zgjerimi i zonës së shërbimeve;
- Shtimi i numrit të klientëve;
- Angazhimi në ngritjen e kualitetit dhe efikasitetit të shërbimeve në vazhdimësi;
- Realizimi i kërkesave të klientëve;
- Angazhimi në ngritjen e shkallës së inkasimit;
- Investimet e nevojshme, qoftë nëpërmjet donacionit, apo të të hyrave vetanake.

#### **Sfidat e së ardhmes**

Sfidat e së ardhmes për KRU Radoniqi – Dukagjini:

1. Nevoja për investime kapitale;
2. Nevoja për përmirësimin e infrastrukturës ujitëse;
3. Kushtëzimi i dhënies së subvencioneve nga MBPZHR për fermerët me përmbushjen e obligimeve financiare që kanë ndaj kompanisë;
4. Rritja e efikasitetit të gjykatave në realizimin e padive gjyqësore;
5. Zvogëlimi i kërkesës për ujitje si rezultat i motit me shi;
6. Ndërtimet e egra brenda perimetrit të sistemit të ujitjes, zvogëlimi i sipërfaqeve bujqësore në sistem dhe dëmtimi i rrjetit të ujitjes.



## Ngjarjet kryesore - 2012

Ndër ngjarjet kryesore mund të veçojmë:

1. Shfrytëzimi maksimal i ujit të ujitjes gjatë vegetacionit;
2. Kultivimi i kulturave profitabile-perime-kulture, serra;
3. Numri i vogël i ankesave të fermerëve;
4. Shkalla e lartë e kënaqësisë së konsumatorëve.

## Investimet dhe Projektet - 2012

Projektet e realizuara në vitin 2012

KU "Radoniqi – Dukagjini" sh.a., gjatë vitit 2012 ka investuar në këto projekte:

- Sanimi i rrëshqitjeve të dheut;
- Furnizimi me lidhëse Shtraub;
- Rehabilitimi i rrjetit për ujitje.

## Indikatorët operativë – krahasimi me vitin paraprak

Indikatorët operativë	2012	2011
Uji i furnizuar në (000)m <sup>3</sup>	34,559	36,926
Ujitja e tokave bujqësore (ha)	5,176	5,216
Faturimi (%)	51	52
Inkasimi (%)	53	55

Tabela 33. Performanca Operative e KRU "Radoniqi- Dukagjini"

Lidhur me sipërfaqen e ujitur – të faturuar 2011 dhe 2012, ndryshimi është 40 ha, ngase, në vitin 2012 është ngarkuar më pak për 40 ha, për arsye se:

Spektori shoqëror në KBR "Rogova" dhe KBI "Ereniku", kryen regjistrime për çdo vit dhe ngarkohen të gjitha kulturat, prandaj përveç grurit, këtu bëhet fjalë për Njësinë Operative "Radoniqi", me 24 ha me pak dhe Njësinë Operative "Dukagjini", ku varet prej kulturave, të cilat ngarkohen në këtë njësi. Duhet cekur se gruri nuk ngarkohet, ndërsa për pagesë ngarkohen vetëm kulturat të cilat ujitën, këtu është fjala për 16 ha.

Prandaj, kultura e grurit në këto zona ndikon në zvogëlimin, apo rritjen e sipërfaqeve për ngarkesë. Këta faktorë kanë ndikuar që sipërfaqja të zvogëlohet për vitin 2012 për 40 ha.

## Indikatorët financiarë– krahasimi me vitin paraprak

	2012 (000€)	2011 (000€)
Të hyrat	891	887
Shpenzimet	(374)	(356)
Fitimi/Humbja operative	517	531
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(195)	(261)
Borxhet e këqija	(311)	(268)
Fitimi/Humbja financiare	11	2
Paraja në fund të vitit	140	152
Asetet fikse	3,430	3,624

Tabela 34. Performanca Financiare e KRU "Radoniqi- Dukagjini"

Tabela e lartëshënuar tregon se KRU "Radoniqi-Dukagjini", sh. a. vitin 2012 e ka përmbjllur me një progres simbolik, progres ky i cili falë punës së BD dhe menaxhmentit të kompanisë, ka shënuar edhe këtë vit fitim financiar dhe ky është një tregues shpresëdhënës për të ardhmen.

## Auditimi i Jashtëm

Bazat për mendimin e kualifikuar – Sipas mendimit të auditorit të jashtëm, pasqyrat financiare të kësaj kompanie prezantojnë në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar me 31 Dhjetor 2012, dhe performancën financiare të saj, ndryshimet në ekuitete dhe rrjedhën e parasë së saj, që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

### **Funksionimi i Qeverisjes Korporative – Bordi i Drejtorëve**

Bordin e Drejtorëve e ka emëruar Qeveria e Kosovës dhe detyrë prioritare e tij është ushtrimi i mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe rigoroze të veprimtarisë së zyrtarëve të ndërmarrjes. Bordi i Drejtorëve gjatë periudhës vjetore 2012 ka mbajtur 11 mbledhje, ndërsa Komisioni i Auditimit ka mbajtur 11 takime. Po ashtu, ky organ ka formuar Komisionin për Lobim dhe Definim të Aseteve, i cili ka mbajtur gjithsej 8 takime.

NJPMNP ka bërë vlerësimin e efektshmërisë së punës së Bordit të Drejtorëve, i cili me punën e tij ka ndikuar drejtpërdrejt që kompania vitin 2012 ta përmbyllë me fitim financiar. Për këtë, vlerësimi i Njësisë mbi efektshmërinë e punës së bordit është i publikuar në ueb faqe të MZHE-së.

### **Përmbushja e kërkesave ligjore**

Raportet tremujore, vjetore dhe Plani i Biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të KRU “Radoniqi- Dukagjini” - it dhe janë përpunuar në bazë të kërkesave që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike.

Plani i Biznesit është një plan i përgatitur me përpikëri. Ky plan ka shtjelluar çështjen e strukturës organizative, e zhvillimit të tregut të energjisë në vend dhe rajon, e kornizës ligjore dhe rregullative, e aspekteve sociale dhe mjedisore, e sfidave duke përfshirë përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet (analiza SWOT), e planeve të investimeve, si dhe parashikimet e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Raportet tremujore kanë pasur një format standard që fillon me përshkrimin e strukturës organizative, përshkrimin e indikatorëve kryesorë financiarë dhe operacionalë, duke i krahasuar me vitin paraprak 2011 dhe buxhetin përkatës të vitit 2012. Po ashtu, pjesë e raporteve ka qenë edhe përshkrimi i projekteve kapitale dhe zbatimi i tyre, çështjet ligjore dhe rregullative, pasqyrat financiare dhe analizat financiare dhe operacionale.

Raporti Vjetor është dorëzuar dhe punuar sipas Udhëzuesit të NJPMNP, duke përfshirë edhe një paraqitje të funksionimit të qeverisjes korporative në ndërmarrje.

#### 4.16 Kompania e Ujitjes DRINI I BARDHË Sh. A.



##### **MISIONI I DRINI I BARDHË ka të bëjë:**

Të ofrojë shërbime të furnizimit me ujë, me qëllim të mundësisë së ujitjes së tokave, si dhe shfrytëzimi i resurseve akumuluese ujore me qëllim të shtimit të prodhimit të kulturave bujqësore; përmes kultivimit të kulturave intensive me produktivitet të lartë bujqësor.

##### **Vizioni është:**

Sigurimi i shërbimeve cilësore të ujitjes së kulturave bujqësore, si dhe rritja e vlerës së aseteve publike të Kompanisë së Drinit të Bardhë – Pejë, si pasuri publike e shtetit të Kosovës.

#### **Profili i ndërmarrjes**

Emri i Kompanisë	KU Drini i Bardhë, sh. a.
Numri i Regjistrimit	70465032
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Kryesuesi i Bordit	Ali Sefaj
Kryeshefi Ekzekutiv	Milazim Shatri
Auditor i Jashtëm	Baker Tilly Kosovo

#### **Fushë - veprimtaria**

KU “Drini i Bardhë” është ndërmarrje publike qendrore, ku aksionare e vetme e kësaj kompanie është Republika e Kosovës me 100% të aksioneve. Kjo kompani është e vendosur në Pejë dhe ka tri njësi punuese të vendosura:

- Njësia punuese – Pejë;
- Njësia punuese – Gurrakoc;
- Njësia punuese – Deçan.

KU “Drini i Bardhë”, sh. a. është përgjegjëse për ujitjen e tokave bujqësore në komunat e Pejës, Istogut dhe Deçanit.

#### **Objektivat e së ardhmes**

Objektivat e kësaj kompanie janë të fokusuar kryesisht në këto fusha:

- Shërbime të kënaqshme për konsumatorët;
- Stabilitet financiar afatgjatë;
- Mirëmbajtje të sistemit të ujitjes në përputhje me nevojat e konsumatorëve.

#### **Sfidat e së ardhmes**

Në të ardhmen e kompanisë ndikojnë shkaqet natyrore dhe shoqërore. Po qe se ka thatësi të madhe ka mungesë uji, ndërsa nëse ka të reshura të mëdha uji nuk kërkohet. Nga ana tjetër, kompania shpenzon shumë për përgatitjen e kanaleve për sezonin e ujitjes. Ndërsa, faktori shoqëror e bën ndikimin e vet me mosekzekutimin e lëndëve nga gjykata, bashkëpunimin jo në nivelin e dëshiruar në mes të organeve kompetente dhe fermerëve.

#### **Ngjarjet kryesore - 2012**

Kjo kompani ka veprimtari kryesore ujitjen e tokave bujqësore. Ky vit dallohet me temperatura të larta dhe pa të rreshura gjatë sezonës. Pavaresisht kësaj, ky vit dallohet me furnizim të mjaftueshëm me ujë për ujitjen e kulturave bujqësore. Natyrisht, se thatësia e madhe ka ndikuar në kërkesën më të madhe të fermerëve për ujitje. Si ngjarje tjetër me rëndësi e këtij viti theksohet edhe investimi kapital në projektin “ndërtimi i kanalit të ujitjes Prigod – Llukavc i Begut”, në komunën e Istogut.

## Investimet dhe Projektet - 2012

### Projektet e realizuara në vitin 2012

Investimet e bëra gjatë vitit 2012:

- Kanali Prigod – Llukafc, i financuar nga MZHE; dhe
- Mirëmbajtja e kanaleve të Deçanit, të financuara nga Komuna e Deçanit.

### Indikatorët operativë – krahasimi me vitin paraprak

Indikatorët operativë	2012	2011
Uji i furnizuar (m <sup>3</sup> )	7,350,000	27,126,000
Ujitja e tokave bujqësore (ha)	955	918
Faturimi (%)	66	77
Inkasimi (%)	34	23

*Tabela 35. Performanca Operative e KU Drini i Bardhë*

Nga kjo rezulton një ngritje e lehtë e sipërfaqeve të ujitura prej 37 ha. Koha e thatë pa të reshura dhe temperatura të larta kanë rritur sipërfaqet për ujitje.

Kompania Regjionale e Ujitjes “Drini i Bardhë” dihet se ka akoma kanale të dheut dhe objekte të vjetra me ç’rast kemi humbje mbi 50%.

Gjatë vitit 2011 kemi pasur ujë të mjaftueshëm në kanale dhe kalkulimi është bërë pa ndonjë instrument matës, të cilin nuk e posedon kompania në fjalë, prandaj edhe llogaritja është bërë në bazë të kanaleve me shirita, llogari e cila nuk del shumë e saktë.

Gjatë vitit 2012 kjo kompani ka pasur zvogëlim drastik të hyrjes së ujit në kanale, gjë që tregon se ka qenë vit ekstrem dhe gjatë muajit Gusht ka pasur gati ndërprerje totale. Për këtë ka rezultuar zvogëlim i ujit në raport me vitin 2011.

Nëse shprehet në m<sup>3</sup>, në të dy vitet shpenzohet uji në sasi shumë më të mëdha, shkak humbjet që i cekëm.

### Indikatorët financiarë– krahasimi me vitin paraprak

	2012 (000€)	2011 (000€)
<b>Të hyrat</b>	303	227
<b>Shpenzimet</b>	(159)	(180)
<b>Fitimi/Humbja operative</b>	144	47
<b>Zhvlerësimi dhe amortizimi</b>	(178)	(64)
<b>Borxhet e këqija</b>	0	0
<b>Fitimi/Humbja financiare</b>	(34)	(17)
<b>Paraja në fund të vitit</b>	4	16
<b>Asetet fikse</b>	4,068	1,597

*Tabela 36. Performanca Financiare e KU ‘Drini i Bardhë’*

Kjo tabelë tregon se kompania ka afaruar me humbje financiare edhe gjatë këtij viti, çka do të thotë se ajo gjendet në krizë financiare, pasi me të hyrat e inkasuara prej vetëm 34% nga faturimi, kompania nuk mund t’i mbulojë as shpenzimet operative të saj.

Sa i perket rritjes së aseteve kjo ka ndodhur për shkak të investimeve të projekteve që janë bërë nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

### Auditimi i Jashtëm

Opinionimi me rezervë – Sipas pasqyrave financiare, pjesa më e madhe e zhvleresimit total të ngarkuar dhe të njohur në humbjen dhe fitimin aktual të kompanisë lidhet me zërat e pronës, impianteve dhe paisjeve që janë bartur nga viti i mëparshëm nga kompania, me vlerën e tyre të vlerësuar nga vlerësues të pavarur dhe profesionalë.

## **Funksionimi i Qeverisjes Korporative- Bordi i Drejtorëve**

Bordi i kësaj ndërmarrje ka mbajtur 9 mbledhje gjatë 2012, ndërsa Komisioni i Auditimit ka mbajtur 8 takime gjatë po të njëjtës periudhë. Pothuajse shumica e vendimeve të miratuara nga bordi nuk kanë qenë të frytshme dhe të ekzekutueshme. Nuk është vërejtur efektshmëria e punës së tij në performancën e kompanisë, pasi që e njëjta edhe më tej është në humbje financiare.

## **Përmbushja e kërkesave ligjore**

Raportet tremujore, vjetore dhe Plani i Biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të KRU 'Drini i Bardhë' dhe janë përpunuar në bazë të kërkesave që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike.

Plani i Biznesit është një plan i përgatitur me përpikëri. Ky plan ka shtjelluar çështjen e strukturës organizative, e zhvillimit të tregut të energjisë në vend dhe rajon, e kornizës ligjore dhe rregullative, e aspekteve sociale dhe mjedisore, e sfidave duke përfshirë përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet (analiza SWOT), e planeve të investimeve, si dhe parashikimet e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Raportet tremujore kanë pasur një format standard që fillon me përshkrimin e strukturës organizative, përshkrimin e indikatorëve kryesorë financiarë dhe operacionalë, duke i krahasuar me vitin paraprak 2011 dhe buxhetin përkatës të vitit 2012. Po ashtu, pjesë e raporteve ka qenë edhe përshkrimi i projekteve kapitale dhe zbatimi i tyre, çështjet ligjore dhe rregullative, pasqyrat financiare dhe analizat financiare dhe operacionale.

Raporti Vjetor është dorëzuar dhe punuar sipas Udhëzuesit të NJPMNP, duke përfshirë edhe një paraqitje të funksionimit të qeverisjes korporative në ndërmarrje.

#### 4.17 Kompania për Menaxhimin e Deponive, Sh.A. (KMDK)



##### Misioni

Deponimin e mbeturinave të ngurta komunale në deponitë sanitare regjionale në mënyrë sa më efektive, në pajtim me standardet gjenerale dhe praktikat e mira evropiane, të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve në deponimin e mbeturinave të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të arsyeshme për grumbulluesit e mbeturinave në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

##### Vizioni

Shërbime cilësore, të sigurta, dhe efikente në deponimin e mbeturinave sipas standardeve mjedisore dhe ruajtjes së ambientit për qytetarët e Kosovës.

##### Profili i ndërmarrjes

Emri i Kompanisë	Kompania për Menaxhimin e Deponive, sh.a. (KMDK)
Numri i Regjistrimit	70324870
Pronësia	Republika e Kosovës (100%)
Kapitali Aksionar	25,000 €
Kryesuesi i Bordit	Asllan Vitaku
Kryeshefi Ekzekutiv	Abdullah Haxhiu
Auditor i Jashtëm	Audit & Conto, Sh.p.k

##### Fushë – veprimtaria

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK sh.a.) është kompania e vetme si autoritet përgjegjës i legalizuar, e licencuar për menaxhimin e deponive sanitare regjionale të mbeturinave komunale në Republikën e Kosovës, e korporatizuar dhe plotësisht e regjistruar si shoqëri aksionare, sipas Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare nr. 03/ L-123.

Duke marrë parasysh natyrën e shërbimeve për deponimin e mbeturinave të ngurta komunale, roli i KMDK sh.a. është esencial në parandalimin e ndotjes së ambientit, keqpërdorimin potencial të këtij shërbimi, si dhe në stimulimin e efikasitetit ekonomike dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për konsumatorët e këtyre shërbimeve. Këtë rol KMDK sh.a. e ushtron duke shfrytëzuar ligjet dhe mekanizmat rregullatorë që i ka në dispozicion.

Kompania për Menaxhimin e Deponive Sanitare të Kosovës shërbimet e veta i ofron në këto qytete qendrore të Kosovës:

- Deponia Sanitare e Prishtinës;
- Deponia Sanitare e Podujevës;
- Deponia Sanitare e Prizrenit;
- Deponia Sanitare e Gjilanit;
- Stacionin e transferim në Ferizaj

KMDK ballafaqohet me probleme në funksionalitet, nga fakti se nuk ka mundësi të trajtimit të mbeturinave sipas standardeve. Kjo vjen si mungesë e potencialeve financiare për investime në makineri të re, pasi operatorët për grumbullimin e mbeturinave që janë kompani regjionale të mbeturinave me pronësi 100% të komunave, kanë obligime financiare për deponimin e mbeturinave në vlerë prej mbi 2.5 milionë euro.

##### Objektivat e së ardhmes

Në fokus të angazhimeve të KMDK për vitin e ardhshëm do të jetë:

- Rregullimi i lagunës së ujërave të zeza të DS në Prishtinë dhe vendosja e qëndrueshmërisë në këtë deponi;

- Ngritja e profilit të KMDK, si aktor kyç në zhvillimin e sektorit të deponive sanitare regjionale në Kosovë;
- Ngritja e nivelit të pajtueshmërisë së KMDK me KRM-të e licencuara për ofrimin e shërbimeve sipas standardeve të përcaktuara me kornizën ligjore;
- Konsolidimi i mekanizmave për futjen e partneritetit Publiko-privat në industrinë e përpunimit të mbeturinave, si dhe riciklimin e tyre;
- Prioriteti i kompanisë është edhe kryerja e obligimeve (borxheve) ndaj ish operatorëve dhe ZRRUM.

Shfrytëzimi i mjeteve financiare nga të hyrat vetanake dhe grandet e ndara nga Qeveria për investime kapitale nëpër DS konform afateve dhe respektimin e kornizave ligjore.

### Sfidat e së ardhmes

Sfidë e KMDK për vitin e ardhshëm do të jetë paqëndrueshmëria e deponisë sanitare në Mirash, situatë kjo e krijuar që nga viti 2009, kur DS është menaxhuar nga OE Alpenbau.

Është kërkesë edhe e ekspertëve të IFC-Bankës Botërore të vitit 2010, të cilët kanë rekomanduar aktivitetet që duhet ndërmarrë në trajtimin e ujërave të zeza dhe sjelljen e DS në situatë të qëndrueshme dhe funksionalitet.

### Ngjarjet kryesore -2012

Ngjarjet kryesore të vitit:

- Arritja e marrëveshjeve me tri KRM për programimin e borxheve, me dy prej tyre kanë përfunduar kontestet me ujdi gjyqësore (KRM Higjiena dhe KRM Ekoregjioni), dhe me një ndërmarrje marrëveshje jashtëgjyqësore (KRM Qabrati);
- Investimi në infrastrukturë nëpër deponitë sanitare regjionale;
- Investimi në makinerinë e rëndë, kryesisht në riparimin tyre;
- Investimi në trajtimin e ujërave të zeza;
- Inicimi i padive ndaj KRM dhe disa OE privatë për obligimet që kanë ndaj KMDK.

Aktivitetet kryesore të kompanisë janë zhvilluar nëpër deponitë regjionale në trajtimin e një fluksi të madh të mbeturinave (hedhja, kompaktimi, si dhe mbulimi i tyre), edhe përkundër vështirësive financiare, për shkak të mospagimit të faturave nga KRM.

### Investimet dhe Projektet- 2012

Në vitin 2012, Kompania për Menaxhimin e Deponive është ndihmuar me mjete financiare nga Buxheti i Kosovës në mbulimin e investimeve kapitale në një projekt.

- Rregullimi i infrastrukturës nëpër deponitë regjionale të ujërave të zeza të KMDK-së.

### Indikatorët operativë – krahasimi me vitin paraprak

Indikatorët operativë	Deponimi i mbeturinave (ton)	Shkalla e inkasimit (%)
2012	195,729	84
2011	205,835	62

**Tabela 37. Performanca Operative e KMDK**

Gjatë vitit 2012 KMDK ka pasur ulje të faturimit, në krahasim me vitin 2011 dhe ulje të sasisë së mbeturinave. Rënia e faturimit është si rezultat i masave administrative të ndërmarra ndaj KRM-ve, pasi të njëjtët nuk i kanë kryer obligimet financiare, andaj për një periudhë kohore nuk kanë dërguar mbeturina në deponi, ky është edhe faktori kryesor i uljes së sasisë së mbeturinave në krahasim me vitin 2011, faktor tjetër i uljes së sasisë së mbeturinave është riciklimi i mbeturinave qoftë në mënyrë të organizuar, apo individuale.

Progres është rritja e % së inkasimit nga KRM, kryesisht të shlyera nga mbyllja e deponisë, përderisa t'i paguajnë obligimet, kur dihet se të gjitha KRM i kanë borxh KMDK-së shumën prej 2.5 milionë euro.



## Indikatorët financiarë– krahasimi me vitin paraprak

	2012 (000€)	2011 (000€)
<b>Të hyrat</b>	1,293	1,187
<b>Shpenzimet</b>	(936)	(730)
<b>Fitimi/Humbja operative</b>	357	457
<b>Zhvlerësimi dhe amortizimi</b>	(978)	(1,021)
<b>Borxhet e këqija</b>	-	(347)
<b>Fitimi/Humbja financiare</b>	(621)	(911)
<b>Paraja në fund të vitit</b>	20	10
<b>Asetet fikse</b>	5,400	6,319

*Tabela 38. Performanca Financiare e KMDK*

Siç shihet në tabelën e mësipërme, kemi një rritje tek të hyrat, ndërsa një rënie tek shpenzimet e tërësishme, në krahasim me vitin paraprak 2011, gjë që ka sjellë deri në rezultatin përfundimtar – humbje financiare prej (621) mijë euro, apo një humbje më e vogël për 290 mijë euro nga viti paraprak. Indikator i uljes së shpenzimeve janë lejjimet e borxheve të këqija dhe të dyshimta. Po ashtu, edhe llogaritë e pagueshme kanë pasur ulje në krahasim me vitin 2011 – si indikator është shlyerja e obligimeve ndaj operatorëve ekonomikë.

### Auditimi i Jashtëm

Auditimi i Jashtëm për KMDK është bërë nga Audit & Conto. Kjo kompani, pas auditimit të pasqyrave financiare, ka dhënë një opinion të kualifikuar. Sipas tyre, pasqyrat financiare të kompanisë prezantojnë në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të kompanisë me 31 Dhjetor 2012, si dhe performancën financiare të saj, me ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë së saj për vitin që përfundon në këtë datë, në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

### Funksionimi i Qeverisjes Korporative – Bordi i Drejtorëve

Konform kompetencave, Bordi ka mbajtur 13 mbledhje gjatë vitit 2012, ndërsa komisioni i auditimit ka mbajtur 4 mbledhje gjatë këtij viti. Komiteti për Përafrimin e Standardeve të Deponive Sanitare, gjatë vitit 2012 ka mbajtur 1 mbledhje. Komiteti për Energjinë gjatë vitit 2012 ka mbajtur 4 mbledhje. Bordi nuk ka qenë efektiv në vendimmarrje, apo shpesh jo të gjitha vendimet e tyre kanë qenë në përputhshmëri me ligjin, sidomos kur kjo ka të bëjë me vendimet për bonuse të paarsyetuara, dhe përkundër kërkesës së NJPMNP për rishikimin e të njëjtave, bordi ishte i vendosur në mosbindje, kjo gjë do të kihet parasysh në vlerësimin e tyre që publikohet në ueb faqe.

### Përmbushja e kërkesave ligjore

Raportet tremujore, vjetore dhe Plani i Biznesit janë disa nga raportimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike. Këto raporte janë aprovuar në afat të caktuar nga Bordi i Drejtorëve të Kompanisë së Menaxhimit të Deponive të Kosovës – KMDK.

Plani i Biznesit është përgatitur me kohë dhe ka paraqitur nivelin korporativ gjatë vitit 2012. Aty janë identifikuar synimet, si dhe treguesit kyç që do arrijnë të realizojnë, apo përmirësojnë performancën financiare dhe operative të kompanisë.

Raportet tremujore janë shqyrtuar paraprakisht nga Komisioni i Auditimit dhe janë aprovuar me kohë nga Bordi i Drejtorëve. Është miratuar dhe dorëzuar me kohë edhe Raporti i Auditorit të Jashtëm. KMDK në vitin 2012 ka përmbushur kërkesën ligjore nga neni 16 i Ligjit mbi NP-të, i cili e ka hartuar raportin e kënaqësisë së konsumatorit dhe të njëjtin e ka aprovuar me kohë.

Raporti Vjetor 2012 është përgatitur nga menaxhmenti dhe aprovuar nga bordi me kohë. Ky raport ka përdorur formën narrative dhe tabelat, sipas udhëzuesit që ua ka dërguar NJPMNP, për t'i paraqitur të dhënat operative dhe financiare të ndërmarrjes.



---

## Përmbledhje dhe Rekomandime

Nga të gjitha të dhënat e pasqyruara në këtë raport të performancës së ndërmarrjeve publike të zhvilluara gjatë vitit 2012 dhe duke i krahasuar me periudhën paraprake, mund të raportojmë një avancim në performancë operative, gjithashtu edhe financiare të Ndërmarrjeve Publike Qendrore.

Ndër treguesit më të mirë të rezultateve të arritura të përmirësimit të performancës së shërbimeve publike, sipas sektorëve, është progresi në sektorin e energjisë, si për nga indikatorët operativë: gjenerimi i energjisë, zvogëlimi simbolik i humbjeve të energjisë, reduktimi i ndërprerjeve në transmision dhe ngritjes së inkasimit të energjisë. Po ashtu, përparim ka edhe tek performanca financiare me rritjen e fitimit financiar të KOSTT-it.

Progresi është evident edhe në sektorin e ujitjes dhe furnizimit me ujë të pijshëm, duke shtuar sipërfaqen e ujitur të tokave bujqësore për 250 ha, apo rritja e numrit të konsumatorëve për furnizim me ujë të pijshëm për 10.413 konsumatorë të rinj, zvogëlim të humbjeve të ujit për 1%, rritje të faturimit të ujit të pijes për 1%, rritje të inkasimit nga faturimi i ujit për 3%, si dhe rritja e proporcionit të konsumatorëve me ujëmatës për 10%.

Shikuar nga prizmi i menaxhimit të parasë publike dhe rregullsisë së proceseve financiare në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe bazuar në Opinionet e Auditorëve të Jashtëm, kemi një progres të matur në krahasim me vitin paraprak, ngase prej shtatëmbëdhjetë pasqyrave financiare të audituara, me vlerësimin më të lartë si të pakualifikuara, disa nga to edhe me theksim të çështjes janë dhjetë NP, gjashtë nga to si të kualifikuara, ndërsa një të Auditori i ka dhënë një kualifikim me rezervë.

Performanca financiare e NP-ve në vitin 2012, po ashtu kishte progres, ngase tri kompani kanë rritur ndjeshëm fitimet financiare, një nga to ka kthyer humbjen në fitim dhe gjashtë nga to kanë zvogëluar ndjeshëm humbjet nga viti paraprak, por ka vend për një menaxhim më të mirë, ngase tri kompani fitimin e vitit të kaluar e kanë kthyer në humbje, tri kompani kanë rritur humbjet dhe një kompani, ajo me e madhja, ka zvogëluar fitimet.

Nëse shikojmë performacën e NP-ve, përmes trendeve të rritjes së vlerës së aseteve, ani pse vlera e aseteve merret nga librat kontabël dhe vlerësimi i fundit i bërë nga ish AKM, që nuk është shumë i kënaqshëm, vërejmë se nga raportet e auditorëve të jashtëm rezulton si vijon: Se shtatë nga NP-të kanë rritur vlerën e aseteve, duke falënderuar investimet në asete nga mjetet qeveritare, donatorëve, apo mjetet vetanake, dy nga NP kanë zvogëluar vlerën e aseteve si rezultat i transformimeve të aseteve nga një NP në një NP tjetër, nga ristrukturimi i tyre, një NP, siç është Ibër-Lepenci, ka ulur vlerën e aseteve nga zhvlerësimi i tyre vjetor dhe të tjerat kryesisht kanë mbajtur gjendjen e vitit paraprak.

Natyrisht se krahas rritjes së nevojave për shërbime publike që rrjedhin nga proceset e rritjes së popullsisë dhe rritjes së zhvillimit ekonomik, kërkohet një progres edhe më i madh dhe ka vend për më shumë përparime në zvogëlimin e humbjeve të energjisë, reduktimin e humbjeve të ujit të pijshëm, zvogëlimin e shpenzimeve të borxheve të këqija, rritjen e inkasimit nga shërbimet e kryera, dhe këto sigurisht se do të ndodhin krahas konsolidimit të shtetit, funksionalizimit të gjykatave, investimeve në rrjet të ujësjellësit etj.

Funksionimi i Qeverisjes Korporative, edhe pse si koncept i ri në Kosovë, me borde të drejtorëve, të cilëve u është vazhduar mandati deri në përzgjedhjen e bordeve të reja, ani pse disa nga to me borde jo të kompletuara, si pasojë e shkarkimeve dhe dorëheqjeve të drejtorëve, ishte i vështirësuar, andaj kërkohet një nivel më i lartë i funksionimit të tyre.

Ndryshim-plotësimi i Ligjit mbi NP-të nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në gjysmën e vitit 2012 nuk ka mundur të përfshijë dinamikën e shpejtë të ndryshimeve të kërkuara me qëllim të një mirëmenaxhimi dhe një llogaridhënie më të lartë, sidomos të të autorizuarve të aksionarit-bordit, ndaj vetë Aksionarit, i cili ua ka besuar detyrat – fiduciare.

Për shkak të paqartësive të paraqitura në raportet mes menaxhmentit të lartë dhe Bordit të Drejtoreve të NP-ve, mandej një monitorimi më rigoroz nga Aksionari, përcaktimit më objektiv të kënaqësisë së konsumatorëve dhe përcaktimit të kriterëve mbi nivelin e efektshmërisë së punës së bordeve, në relacion me caqet e planifikuara, është e domosdoshme që qysh në vitin 2014, në kuadër të strategjisë

---

Duke u bazuar në analizat e raportit mbi performancën e Ndërmarrjeve Publike që kanë qenë të mbështetura nga vlerësimet e rregullatorëve të shërbimeve, si dhe nga raportet e auditorëve të jashtëm, si dhe sfidave që paraqiten gjatë operimeve të NP-ve me qëllim të krijimit të shërbimeve publike, NJPMNP rekomandon këto masa që do të ndikonin në përmirësimin dhe avancimin e performancës së NP-ve:

- Avancimi i mëtejshëm i Qeverisjes Korporative në përputhje me parimet e OECD dhe ngritjes së përgjegjësisë për menaxhim me asete publike, përmes emërimit të bordeve të reja të drejtorëve;
- Plotësim –Ndryshimi i Ligjit mbi NP, gjegjësisht hartimit të një ligji të ri të NP;
- Trajtimi me prioritet nga gjykatat kompetente të lëndëve nga Ndërmarrjet Publike mbi inkasimin e mjeteve për shërbimet publike;
- Investime edhe më tutje në rrjetin e vjetruar të ujësjellësve, me qëllim të zvogëlimit të humbjeve teknike të ujit- rrjedhjeve të ujit;
- Investime edhe më tutje në infrastrukturën hekurudhore, si përmbushje e standardeve evropiane dhe krijim i mundësive për investitorë të rinj – operatorë të rinj hekurudhorë;
- Ngritja e komunikimit të NP me institucionet lokale mbi rritjen e kualitetit të shërbimeve publike për qytetarët.
- Trajtimi nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale i rasteve sociale-konsumatorëve socialë të shërbimeve publike për ujë të pijshëm, grumbullim të mbeturinave dhe ujitje të tokave bujqësore;
- Rivlerësimi i përgjithshëm i aseteve të NP nga autoritetet e licencuara për vlerësim prone, e financua nga Aksionari, si titullar i këtyre aseteve.

---

**Referencat:**

- Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”, (2013). “Raporti Vjetor për vitin 2012 i ANP – Adem Jashari”;
- Audit & Conto. (Maj, 2013). “Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur - 31 Dhjetor 2012, KRU Mitrovica”;
- Kanuni i Auditorit. (Prill, 2013). “Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur - 31 Dhjetor 2012, KRU Hidroregjioni – Jugor”;
- Audit & Conto. (Prill, 2013). “Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur - 31 Dhjetor 2012, Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës”;
- Audit & Conto. (Prill, 2013). “Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur - 31 Dhjetor 2012, KRU Prishtina”;
- Autoriteti Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare, (Qershor, 2013). “Raporti Vjetor për vitin 2012”;
- BDO Kosova LLC. (Mars, 2013). “Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare – Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut”;
- BDO Kosova LLC. (Prill, 2013). “Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare – Ibër-Lepenc”;
- BDO Kosova LLC. (Prill, 2013). “Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare – Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës”;
- BDO Kosova LLC. (Qershor, 2013). “Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare – Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës”;
- BDO Kosova L.L.C. (Qershor, 2013). “Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare – Posta e Kosovës”;
- Baker Tilly Kosova. (Maj, 2013). “Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur- Drini i Bardhë”;
- Audir&Conto. (Prill, 2012). “Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare – Radoniqi-Dukagjini”;
- Drini i Bardhë. (2013). “Raporti Vjetor 2012”;
- Ernst & Young Certified Auditors Sh.p.k. (Korrik, 2012). “Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur- Korporata Energjetike e Kosovës”;
- Ibër-Lepenc. (2013). “Raporti i punës për vitin 2012”;
- Posta e Kosovës, (2013)- “Raporti vjetor për vitin 2012”;
- Infrakos. (2013). “Raporti Vjetor 2012”;
- Kanuni i Auditorit. (Maj, 2013). “Raporti i Auditorëve të Pavarur për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2012 – KRU Radoniqi”;
- Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës, (2013). “Raporti Vjetor 2011”;
- Korporata Energjetike e Kosovës, (2013). “Raporti mbi Performancën për vitin 2012”;
- KRU Prishtina. (2013). “Raporti Vjetor 2012”;
- KRU Mitrovica. (2013). “Raporti Vjetor 2012”;
- KRU Hidrodrini. (2013). “Raporti Vjetor 2012”;
- KRU Hidroregjioni-Jugor. (2013). “Raporti Vjetor 2012”;
- KRU Hidromorava. (2013). “Raporti Vjetor 2012”;
- KRU Radoniqi. (2013). “Raporti Vjetor 2012”;
- Operator i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës, (2013). “Raport Vjetor 2012”;
- Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, (2013). “Raporti Vjetor 2012”;
- Radoniqi-Dukagjini. (2013). “Raporti Vjetor 2012”;
- Trainkos. (2013). “Raporti Vjetor 2012”;
- H&N,Sh.P.K. (Maj, 2013). “Raporti Final i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare prej 01 Janar deri më 31 Dhjetor të vitit 2012 – KRU Hidromorava”;
- Etika. - “Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për periudhën 01/09/2012 – 31/12/2011, Infrakos”;
-

---

Eco&Conto. “Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për periudhën 01/09/2012 – 31/12/2012, Trainkos”;

ETIKA. (Prill, 2013). “Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2012 - KRU Hidrodrini”;

Zyra e Regullatorit për Energji, (2012). “Raporti Vjetor 2012”;

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim, (Korrik, 2013). “Raporti Vjetor i Performancës së KRU 2012”.

---